



RAPORT MBI MONITORIMIN E PROCESEVE GJYQËSORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Nga Teoria në Praktikë

Vlerësimi i Efektivitetit të Reagimit të Gjyqësorit
ndaj Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit Serioz

Periudha e Rishikimit, Qershor 2021 - Mars 2024



Funded by
the European Union

Ky publikim është prodhuar në kuadrin e projektit ekstrasubxhetor **"Projekti Rajonal i Monitorimit të Gjykrimeve - Luftimi i Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Ballkanin Perëndimor"** të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Financuar nga Bashkimi Evropian.

Ky publikim është mundësuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e OSBE-së dhe nuk i reflekton domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Për Bashkimin Evropian, emërtimi i Kosovës është pa paragjykim ndaj qëndrimeve rreth statusit të saj dhe është në linjë me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi, pikëpamjet, opinionet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura këtu janë të autorëve dhe kontribuesve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të OSBE-së dhe shteteve të saj pjesëmarrëse. Megjithëse OSBE-ja ka investuar kujdesin maksimal në zhvillimin e këtij publikimi, ajo nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacionit, udhëzimeve dhe këshillave të dhëna, as për shtypje të gabuara. Për këto arsye, nuk mund të bëhet asnjë pretendim kundër OSBE-së në lidhje me pasojat e mundshme që mund të lindin nga informacioni ose konkluzionet e përfshira në këtë publikim.



REGIONAL TRIAL MONITORING PROJECT
COMBATING ORGANIZED CRIME AND CORRUPTION
IN THE WESTERN BALKANS

AUTORËT:

Eirini Patsea (koordinatore e projektit)

Radu Cotici, Meagan Smith Hrle, Emir Kamenica, Kakhramondzhon Sanginov, Franz Petutschnig (udhëheqësit e ekipeve të misioneve në terren)

Ekspertët ligjorë që kontribuan:

Francesco de Sanctis, Blerta Ahmeti, Ornela Bela, Sabina Bosovic, Azra Gavrankapetanovic Omerika, Arita Gerxhaliu Rama, Andri Gjini, Adela Gjoshi, Sejla Haracic-Cajlakovic, Blerta Iberdemaj, Dina Kardovic, Etleva Kelmendi Shabani, Hana Komic, Ljubica Mishevaska, Ksenija Misovic, Alisa Nikezic, Alida Radoncic, Senada Rexha, Nadica Serafimovska, Aleksandar Vanchoski, Elona Xhepa

osce.org/westernbalkanstrialmonitoring

Qendra për Parandalimin e Konfliktit, Sekretariati i OSBE-së

Wallnerstrasse 6

A-1010 Vienë, Austri

pm-cpc@osce.org

osce.org/cpc

Përmbajtja

Hyrje

Parathënie.....	5
I. Përmbledhje ekzekutive.....	6
II. Historiku i projektit.....	7
III. Prirjet Rajonale	14
IV. Hapat e mëtejshëm.....	18

Juridiksionet

V. Shqipëria.....	20
VI. Bosnja dhe Hercegovina.....	43
VII. Kosova*	69
VIII. Mali i Zi.....	102
IX. Maqedonia e Veriut.....	133

*Të gjitha referencat ndaj Kosovës, qoftë territorit, institucioneve ose popullsisë së saj, duhet të kuptohen në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Lista e shkurtesave

ADK	Akademia e Drejtësisë e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BeH	Bosnja dhe Hercegovina
BP	Ballkani Perëndimor
CEPEJ	Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës për Efikasitetin e Drejtësisë
CMIS	Sistemi i Menaxhimit dhe Informacionit të Çështjeve (Kosovë)
DG NEAR	Drejtoria e Përgjithshme të BE-së për Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë (Shqipëri)
FBeH	Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJKKO	Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GJPTH	Shkup Gjykata Penale Themelore Shkup
IPA	Instrumenti i Para-Anëtarësimit
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kodi Penal
KKGJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor (Shqipëri)
KL GJP	Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë (BeH)
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë (Shqipëri)
KOK	Krimi i Organizuar dhe Korrupsioni
KP	Kodi Penal
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MD	Ministria e Drejtësisë
MPF	Marrëveshje për Pranimin e Fajësisë
MPFN	Marrëveshjet e Pranimit të Fajësisë si të Negociuara
MPH	Masa të Posaçme të Hetimit
NNJ	Ndihma e Ndërsjellë Juridike
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PPTH	Prokuroria Publike Themelore (Maqedonia e Veriut)
PRIS	Sistemi për Menaxhimin e Çështjeve (Mali i Zi)
PSK	Prokuroria Speciale e Kosovës
PSSH	Prokuroria Supreme e Shtetit (Mali i Zi)
RS	Republika Serbe
RRB BeH	Rrethi Brčko i BeH
SPAK	Prokuroria e Posaçme (Shqipëri)
SPO	Prokuroria Speciale (Mali i Zi)
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar

Parathënie

Projektet e kësaj natyre nuk konsistojnë vetëm në identifikimin e sfidave, por edhe në krijimin e mënyrave për t'i tejkaluar ato. Ky Raport Monitorimi i Çështjeve Gjyqësore në Ballkanin Perëndimor shënon një arritje të rëndësishme në rrugëtimin e mundësuar nga mbështetja e BE-së, si donatorja kryesore e projektit, për të ndihmuar në ndërtimin e sistemeve të drejtësisë penale me rezistencë dhe qëndrueshmëri më të fortë, që mund t'i përgjigjen më efektivisht çështjeve serioze të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ky raport nxjerr në pah problemet sistemike me të cilat përballen sistemet gjyqësore në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Pengesat mund të duken sfiduese, qoftë në mungesën e burimeve apo të llogaridhënies. Në vend të inventarizimit të thjeshtë të problemeve, raporti ofron një rrugëzgjidhje për adresimin e tyre përmes një analize të bazuar në prova si dhe rekomandimeve konkrete.

Duke promovuar transparencën, përforcuar kapacitetet dhe inkurajuar ndryshimin, ne mund të thyejmë ciklin që minon besimin e publikut dhe sundimin e ligjit. Ndërsa rruga përpara do të jetë sfiduese, pengesat nuk janë të pakapërcyeshme. Përparësitë e paraqitura në këtë raport japin një kornizë të konsoliduar progresi, që ka filluar tashmë në të gjitha juridiksionet.

Ne do të donim të shprehnim mirënjohjen tonë të thellë për partnerët tanë në Drejtorinë e

Përgjithshme të BE-së për Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit (DG NEAR) dhe Delegacionet e BE-së në terren për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre në këtë nismë të rëndësishme. Ne jemi gjithashtu mirënjohës për grupet e interesit nga këshillat gjyqësorë dhe të prokurorive, gjykatat, prokuroritë dhe ministritë e drejtësisë në të gjitha juridiksionet. Ata janë konsultuar për gjetjet e këtij raporti, duke dhënë një kontekst të rëndësishëm dhe duke na ndihmuar të verifikojmë analizën tonë; ata kanë pranuar një shumicë të konsiderueshme të rekomandimeve të raportit, duke përfshirë një pjesë të tyre në kornizat e tyre të reformave.

Vetëm përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe angazhimit të përbashkët mund të shpresojmë të rrëzojmë barrierat ndaj drejtësisë. Ky raport është një hap i rëndësishëm në një përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të OSBE-së, së bashku me partnerët ndërkombëtarë dhe lokalë, për të mbështetur pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit.

Ne kemi një mundësi për të transformuar sistemet e drejtësisë penale, për të ndërtuar rezistencën shoqërore ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe për ta bërë drejtësinë e barabartë dhe të arritshme realitet për të gjithë qytetarët.

Ne qëndrojmë vendosmërisht me të gjithë ata që janë të angazhuar në këtë punë thelbësore.




Catherine FEARON

Drejtoresh e Qendrës së OSBE-së për Parandalimin e Konfliktit dhe Zëvendëskryetare e Sekretariatit të OSBE-së



Amb. Brian AGGELER

Kryetar Misioni, Misioni i OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë



Amb. Dominique WAAG

Kryetare Misioni, Misioni i OSBE-së në Mal të Zi



Amb. Michel TARRAN

Kryetar Prezenca, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri



Amb. Michael DAVENPORT

Kryetar Misioni, Misioni i OSBE-së në Kosovë



Amb. Kilian WAHL

Kryetar Misioni, Misioni i OSBE-së në Shkup

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Trajtimi efektiv i çështjeve serioze të krimit të organizuar dhe korrupsionit (KOK) është jetik për përmirësimin e sundimit të ligjit. Zbatimi i konsoliduar i një agjende reformash të qëndrueshme në sistemin e drejtësisë dhe udhëheqja vendimtare në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë është i nevojshëm për të vendosur një historik të besueshëm në të gjithë Ballkanin Perëndimor (BP) dhe për të përbushur objektivat kyçe strategjike të juridiksioneve përkatëse.

Komuniteti ndërkombëtar, përfshirë Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ka bërë thirrje për të përmirësuar performancën në çështjet KOK dhe ka identifikuar fushat që kanë nevojë për reformë urgjente. Pavarësisht angazhimit të gjyqësorit dhe një retorike të caktuar politike në mbështetje të gjyqësorit, përgjigjja gjyqësore ndaj çështjeve KOK në BP kërkon përmirësim, veçanërisht pasi besimi i publikut te gjyqësori vazhdon të jetë në rënie, pjesërisht si pasojë e rezultateve të pamjaftueshme në çështjet KOK.

Ky Raport rajonal, i hartuar nga “Projekti Rajonal i Monitorimit të Çështjeve Gjyqësore - Lufta kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Ballkanin Perëndimor” i OSBE-së ([Projekti¹](https://www.osce.org/WesternBalkansTrialMonitoring)), paraqet gjetje dhe rekomandime kyçe për adresimin e çështjeve të identifikuara gjatë monitorimit të çështjeve gjyqësore nga korriku 2021 në mars 2024. Ai është gjithashtu produkt i konsultimeve me zyrtarë gjyqësorë i raporteve të veçanta sipas juridiksionit të tyre, të ndara me bashkëpunëtorët përkatës në nëntor 2023.

Raporti thekson metodologjinë e monitorimit të Projektit dhe të dhënat e mbledhura në kapitullin II; paraqet trendet e përbashkëta në të gjitha juridiksionet për efektivitetin e përgjigjes gjyqësore ndaj çështjeve KOK dhe hapat e mëtejshëm në kapitujt III & IV; dhe trajton çështjet e çdo juridiksioni dhe bën rekomandime në kapitujt V deri në IX.

¹ <https://www.osce.org/WesternBalkansTrialMonitoring>

II. HISTORIKU I PROJEKTIT

Objektivat e projektit

Projekti, i financuar nga Komisioni Evropian (KE) dhe i zbatuar nga OSBE-ja në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut,² synon të mbështesë një përgjigje gjyqësore më efektive ndaj çështjeve KOK në Ballkanin Perëndimor, ku çështjet KOK në nivelin e lartë përfaqësojnë një kërcënim ndaj qëndrueshmërisë dhe mirëqenies afatgjatë. Projekti mbështet këto juridiksione në trajtimin e çështjeve

serioze KOK duke punuar që të përmirësojë pavarësinë, cilësinë dhe efikasitetin e këtyre sistemeve gjyqësore. Prej korrikut të vitit 2021, Projekti ka vënë në zbatim monitorimin e çështjeve gjyqësore si një mjet diagnostikues i shumanshëm dhe sistematik për çështjet përkatëse, që synon si produkt kryesor krijimin e një kuadri për reforma të bazuar në prova. Tabela më poshtë paraqet teorinë e Projektit për ndryshim.

IMPAKTI	Besimi i publikut në sistemin gjyqësor		Nivele të ulura të rasteve serioze të krimit të organizuar dhe korrupsionit		
VIZIONI	Një sistem i qëndrueshëm i drejtësisë penale që mund t'i përgjigjet në mënyrë efikase dhe efektive rasteve serioze të krimit të organizuar dhe korrupsionit				
REZULTATET NË SEKTORIN E DREJTËSISË	DREJTËSI në proces		EFIKASITET në proces		EFEKTIVITET në proces
PRODUKTET NË SEKTORIN E DREJTËSISË	Transparencë dhe llogaridhënie e shtuar	Pavarësi e shtuar	Burime të shtuara	Kapacitete të shtuara	Shpejtësi më e madhe
HIPOTEZA BAZË	Qartësia e roleve dhe përgjegjësi ndërmjet institucioneve të sektorit të drejtësisë për hartimin e politikave, zbatimin kuptimplotë të tyre, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm				
REZULTATET E MONITORIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE	Të ofrohet një kuadër i bazuar në prova për reformën e ardhshme, që përmbush nevojat reale				

Tabela 1 - Teoria për Ndryshim e Projektit Rajonal të Monitorimit të Çështjeve

² Serbia do t'i bashkohet projektit nga korriku 2024. Ky Raport nuk përmban asnjë gjetje në lidhje me Serbinë.

Metodologjia dhe fusha e zbatimit të mbledhjes së të dhënave

Metodologjia

Metodologjia e Projektit, e hartuar dhe e përshtatur për projektin nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR) në bazë të Manualit të saj të Monitorimit të Çështjeve Gjyqësore dhe përvojës së gjerë të operacioneve në terren të OSBE-së për monitorimin e çështjeve KOK, përfshin monitorimin e procesit nga konfirmimi i kërkesës për gjykim deri në vendimin e formës së prerë. Çështjet përzgjidhen në bazë të tri kriterëve kyçe të cilat reflektojnë: 1) rëndësinë e veprës penale, 2) statusin e të akuzuarit dhe 3) nëse çështja tërheq vëmendje të konsiderueshme mediatike. Çështjet kategorizohen nga të ulëta në të larta +, ku çështjeve të larta dhe të larta+ u jepet përparësi për monitorim.³

Projekti monitoron seancat dhe analizon aktet gjyqësore, kryesisht kërkesat për gjykim dhe vendimet, në çështjet që i përmbushin këto kriterë të



përzgjedhjes. Në mënyrë që të hartohet një analizë që është e dobishme në kuadër të politikave lokale dhe e krahasueshme me të gjitha juridiksionet, Projekti ka miratuar me konsensus një përkufizim konkret për “efektivitetin” në përgjigjen gjyqësore ndaj çështjeve serioze KOK. Meqenëse nuk ka asnjë përkufizim të pranuar në mënyrë universale të efektivitetit gjyqësor si një e tërë, ose në fusha të synuara si sektori i drejtësisë penale, Projekti përdor përkufizimin e vet të punës për efektivitetin, që orienton të gjithë metodologjinë e tij për mbledhjen e të dhënave dhe analizën.

Përkufizimi gjatë punës së Projektit për efektivitetin është si më poshtë:

Efektiviteti mat nëse institucionet në fjalë po i përmbushin ose jo objektivat që **shoqëria ka vendosur për to.**

³ E lartë +, sipas Metodologjisë, rezervohet për rastet kur të paktën njëri nga të pandehurit e përfshirë është zyrtar i rangut të lartë ose është i zgjedhur në poste publike të profilit të lartë. Për shembull, krerët e shteteve ose qeverive, ministra dhe zëvendës ose ndihmësministra; deputetë të parlamentit ose organeve të ngjashme legjislative; anëtarët e organeve drejtuese të partive politike; kryetarët e bashkive të kryeqytetit dhe qyteteve të tjera kryesore në secilin vend përfitues të IPA-s; ose zyrtarët më të lartë të njësive federale.

Efektiviteti duhet konsideruar së pari dhe mbi të gjitha në lidhje me arsyen e ekzistencës së institucioneve përkatëse që kanë mandat uljen e krimit dhe krijimin e sigurisë juridike.

Në fakt, Metodologjia e Projektit parashikon që “duhet bërë dallimi ndërmjet objektivit të përgjithshëm të sistemit të drejtësisë penale, që është të japë drejtësi duke dënuar fajtorët ndërkohë që mbron të pafajshmit, dhe objektivave të veçantë të institucioneve të ndryshme që përbëjnë sistemin”.

Në këtë kuptim, Metodologjia përfshin përmasat si themelore edhe procedurale të përgjigjeve gjyqësore ndaj çështjeve KOK, duke adresuar të drejtat për një proces të rregullt ligjor, llogaridhënien dhe pavarësinë. Vlerësimi i Metodologjisë shkon përtej procedurave në sallën e gjyqit, duke marrë parasysh faktorë të jashtëm si mbulimi mediatik, korniza dhe performanca institucionale. Në këto rrethana, dhe në bazë të objektivave të Projektit, Metodologjia identifikon katër dimensionë kyçe për të vlerësuar përgjigjen gjyqësore ndaj çështjeve KOK:

i. drejtësia

ii. efikasiteti

iii. kapaciteti/ performanca

iv. Përdorimi strategjik i mjeteve gjyqësore

i. Administrimi **i drejtë** i drejtësisë, si një themel i demokracisë, parashikohet si e drejtë e njeriut sipas nenit 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, referuar shpesh si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe ligjeve kombëtare që mbrojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor. Si rrjedhim, Projekti vlerëson të drejtën për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, për një seancë publike, për t’u prezumuar i pafajshëm, për barazinë e armëve, dhe për zbatim të njëtrajtshëm dhe të parashikueshëm si të ligjeve procedurale edhe atyre themelore penale.

Për më tepër, Projekti merr një qasje më të gjerë kundrejt drejtësisë duke parashikuar çështjet e lidhura me sigurinë juridike, llogaridhënien dhe transparencën në punën e gjyqësorit.

ii. Sistemet gjyqësore duhet të japin drejtësi në mënyrë **efikase**, dhe si pjesë e kriterit të përgjithshëm për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Efikasiteti përforcon besimin e publikut, sigurinë juridike dhe të drejtat për proces të rregullt ligjor.⁴ Projekti vlerëson efikasitetin duke shqyrtuar afatet kohore të procedurave dhe shpërndarjen efektive të burimeve.

⁴ Këshilli i Evropës, Gjyqtarët: Pavarësia, Eficenca dhe Përgjegjësitë: Rekomandim CM/Rec(2010)12 dhe Memorandumi Shpjegues (Strasburg: Këshilli i Evropës, 17 nëntor 2010), paragrafi 30.

iii. Projekti synon të vlerësojë profesionalizmin, seriozitetin dhe kompetencën e zyrtarëve, duke u përqendruar te **kapaciteti** i tyre për të ndjekur dhe gjykuar çështjet në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe të shpejtë.⁵ **Kapaciteti** vlerësohet jo vetëm sa i përket performancës së gjykatës, por edhe, në lidhje me cilësinë e akteve gjyqësore, duke theksuar arsyetimin koherent dhe bindës si një garanci kundër arbitraritetit. Arsyetimi i mangët, i paqartë ose jobindës mund të sinjalizojë mungesë kompetence, probleme të kuadrit ligjor, mangësi në programet e trajnimit të akademive gjyqësore ose konsiderata joligjore nga ana e gjyqtarit ose prokurorit.

iv. Projekti vlerëson përdorimin e procedurave kyçe dhe **mjeteve** në trajtimin e çështjeve KOK, duke u përqendruar në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive. Hetimet financiare luajnë rol qendror, përveç masave për të ngrirë pasuritë gjatë hetimeve, duke synuar drejtpërdrejt akumulimin e pasurisë – nxitësi kyç i rasteve KOK.⁶

Meqenëse monitorimi i çështjeve gjyqësore shërben si *mjet diagnostikues* për të identifikuar simptomat e mangësive sistematike, Projekti gjithashtu kryen një seri vlerësimesh plotësuese të nevojave dhe analizon për të kuptuar shkaqet rrënjësore të sfidave të identifikuara. Këto aktivitete, me synim mbështetjen më të thellë të gjetjeve,

përqendrohen te mbledhja e të dhënave përmes konsultimeve të strukturuar me grupe interesi të sistemit të drejtësisë, specifikisht në mbledhje dypalëshe dhe diskutime në tryezë të rrumbullakët me shumë grupe interesi.

Fusha e zbatimit të metodologjisë

Për shkak të fokusit të Projektit për të identifikuar çështjet sistematike, të gjitha produktet analitike – duke përfshirë këtë Raport – përcaktojnë *prirjet* në çështjet e monitoruara pa diskutuar ose identifikuar çështje individuale. Për këtë arsye, të gjitha detajet që mund të çojnë në identifikimin e çështjeve janë hequr nga ky Raport.

Gjithashtu, sipas Metodologjisë së tij, Projekti monitoron dhe analizon çështjet pas pranimit të kërkesës për gjykim. Kjo do të thotë që Projekti nuk ka qasje as nuk analizon në mënyrë sistematike të dhënat nga fazat e hetimit ose seancës paraprake. Duke pasur parasysh këto kufizime, analiza e elementeve të caktuara të trajtimit të çështjeve KOK, si hetimet financiare, bazohet në të dhënat që mund të kuptohen nga kërkesa për gjykim dhe procesi gjyqësor, si dhe nga konsultimet me grupet e interesit.

Për më tepër, monitorimi i çështjeve gjyqësore vlerëson në përgjithësi tërësinë e procesit, pra, deri në vendimin e formës së prerë, pasi mangësitë e identifikuara në një fazë të procesit mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme.

⁵ Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve, Udhëzime mbi rolin e Prokurorit (OKB, 7 Shtator 1990), paragrafët. 1 dhe 2; Këshilli i Evropës, Rekomandime mbi Gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë, paragrafët. 59 and 65.

⁶ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, neni 31, dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, neni 12, kërkojnë shfrytëzimin e mjeteve të ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.

Aktivitetet kryesore të monitorimit të çështjeve gjyqësore në periudhën e raportimit

Gjatë periudhës së raportimit, korrik 2021 deri në mars 2024, Projekti monitoroi gjithsej 264 çështje në të

gjithë rajonin dhe mesatarisht 52 çështje të nivelit të lartë dhe të mesëm për juridiksion.

SHQIPËRIA

- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

- Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës
- Gjykata Supreme e Republikës Serbe
- Gjykata e Qarkut në Banja Luka
- Gjykata Supreme e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës
- Gjykatat Kantonale në Bihaç, Mostar, Sarajevë, Shiroki Brijeg, Tuzla, Zenicë
- Gjykatat e Rrethit në Bihaç, Cazin, Graçanicë, Sarajevë

KOSOVA

- Gjykata Supreme e Kosovës
- Gjykata e Apelit e Kosovës
- Gjykatat Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan, Pejë

MALI I ZI

- Gjykata Themelore në Kotor
- Gjykata e Lartë në Podgoricë
- Gjykata e Apelit e Malit të Zi

MAQEDONIA E VERIUT

- Gjykata Themelore Penale Shkup
- Gjykata e Apelit Shkup
- Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Grafikët më poshtë paraqesin një pamje të përgjithshme të llojit të çështjeve

nën monitorim, si dhe të fazës procedurale.




Figura 1 - Numri i çështjeve të monitoruara nga korriku 2021 në mars 2024, të zbërthyera - krim i organizuar/korrupsion & kriteret e vlerësimit të metodologjisë




Figura 2 - Fazat procedurale të çështjeve të monitoruara, të zbërthyera sipas juridiksionit (korrik 2021 - mars 2024).

Gjetjet e Projektit reflektojnë të dhëna të mbledhura në seancat e çështjeve dhe gjatë shqyrtimit të akteve gjyqësore

kyçe. Grafiku më poshtë ilustron burimet e mbledhjes së të dhënave për çështjet e përzgjedhura.




Figura 3 - Zbërthimi i aktiviteteve për monitorimin e çështjeve gjyqësore nga korriku 2021 në mars 2024.

Siç përmendet më sipër, Projekti identifikon çështje sistemike duke vlerësuar tërësinë e proceseve. Këto vlerësime synojnë të:

- Identifikojnë ndërlidhje ndërmjet dështimeve sistemike që demonstrohen në akte juridike kyçe dhe në faza të ndryshme të procedurës. Është e rëndësishme të përmendet që dështimet në një fazë të hershme mund të kenë efekt zinxhir.
- Përmirësojnë hartimin e propozimeve të posaçme dhe të qëndrueshme për reforma ose ndërhyrje.

Këto propozime duhet të adresojnë shkaqet rrënjësore të çdo problemi, që mund të gjenden në një fazë procedurale ose dokument të mëparshëm.

Megjithatë, në kohën e hartimit të këtij Raporti, vetëm një numër i kufizuar çështjesh të monitoruara nga Projekti janë mbyllur me vendim të formës së prerë. Ndërkohë, çështje të reja shtohen sipas burimeve të mundshme. Grafiku më lart (figura 2) ilustron numrin e çështjeve të përfunduara për juridiksion dhe jep disa vëzhgime fillestare për rezultatet e këtyre çështjeve.

III. PRIRJET RAJONALE

Sfidat gjithëpërfshirëse institucionale

Monitorimi i çështjeve gjyqësore nga Projekti identifikoi simptoma të sfidave sistemike në të gjitha juridiksionet në shkallë të ndryshme që tregojnë probleme që nga kapaciteti individual deri në mangësi në nivele institucionale, ligjvënëse dhe politikash.

Mbeten sfida në lidhje me drejtësinë, efikasitetin, efektivitetin dhe kapacitetin në trajtimin e çështjeve serioze dhe të ndërlikuara KOK. Problematika vazhdon në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e zyrtarëve dhe institucioneve gjyqësore sa u përket interesave të aktorëve si publikë edhe privatë; po ashtu edhe praktikën e parregullta në lidhje me transparencën dhe aksesin në informacion për çështjet me interes publik. Proceset janë deri diku joefikase, ndër të tjera për shkak të menaxhimit të dobët të çështjeve dhe një mungese disipline procedurale. Kërkesat për gjykim dhe vendimet mund të mos kenë cilësinë e duhur, dhe konfiskimi i pasurive nuk shfrytëzohet mjaftueshëm. Për më tepër, marrëveshjet për pranimin e fajësisë shpesh nuk përdoren strategjikisht dhe rrallëherë sigurojnë konfiskimin e fitimeve të paligjshme. Megjithatë, çdo juridiksion përballet me një nivel të ndryshëm të këtyre problemeve, që do të diskutohet më në detaj në kapitujt përkatës.

Në këtë pjesë, raporti përqendrohet te sfidat e përbashkëta institucionale që duket se sjellin të gjitha problemet e tjera të identifikuara në të dhënat e monitorimit të çështjeve gjyqësore, siç preket shkurtimisht më lart. Këto sfida të përbashkëta nuk ilustrohen domosdoshmërisht drejtpërdrejt te seancat ose aktet gjyqësore, por shfaqen nga konsultimet me grupet kyçe të interesit në sistemin e drejtësisë, si dhe nga kërkimet e thelluara të ekspertëve për arsyet e mundshme të shkaqeve rrënjësore të problemeve që ngrihen në të dhënat e monitorimit të çështjeve gjyqësore.

Këto reflektime për shkaqet rrënjësore shpesh lihen pa u përmendur për shkak të vështirësisë së pashmangshme të krijimit të të dhënave konkrete të verifikueshme që nuk lënë vend për interpretim. Nga ana tjetër, meqenëse progresi duket në letër por mbetet i paqartë në praktikë, është e rëndësishme që shkaqet rrënjësore të parashtrohen për të zgjeruar fushën e diskutimit dhe për të stimuluar vlerësimin e posaçëm të tyre. Adresimi i këtyre sfidave do të kërkojë një vizion afatgjatë nga të gjitha grupet përkatëse të interesit.

i. Marrja përsipër e proceseve reformuese

Pavarësisht proceseve të konsiderueshme të reformave gjyqësore dhe nismave për të përmirësuar trajtimin e çështjeve KOK, efektiviteti duket se pengohet nga angazhimi i pamjaftueshëm i grupeve përkatëse të interesit në sistemin e drejtësisë. Ndërsa përhapja e udhëzuesve, propozimeve të politikave dhe përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve është inkurajuese, zbatimi

dhe vendimmarrja e koordinuar janë themelore për të shmangur ngatërresat ose paqëndrueshmërinë. Zhvillimi i një vizioni të përbashkët për reformë, i drejtuar nga grupet përkatëse të interesit, si dhe me mekanizma të qartë mbikëqyrjeje dhe kanale të konsoliduara komunikimi, është kyç për të nxitur bashkëpunimin dhe llogaridhënien ndërmjet autoriteteve përgjegjëse.

ii. Burimet

Monitorimi i çështjeve gjyqësore dhe reagimet nga zyrtarët gjyqësorë konfirmojnë që institucionet gjyqësore përballen me sfida në burime materiale dhe njerëzore, veçanërisht sa u përket ekspertëve të specializuar për hetime financiare. Edhe në juridiksione me numër në dukje të mjaftueshëm gjyqtarësh dhe prokurorësh, shpërndarja e burimeve mund të jetë joefektive ose joefikase. Vonesat e gjata në emërimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve e përkeqësojnë këtë problem. Për më tepër, institucionet gjyqësore shpesh nuk kanë personel

ndihmës ligjor të mjaftueshëm. Adresimi i këtyre sfidave kërkon që ministritë e drejtësisë të përputhin zotimet e tyre politike me mbështetje financiare, si dhe të përshpejtojnë proceset e emërimit për këshillat gjyqësorë dhe të prokurorive, si dhe për gjyqtarët dhe prokurorët. Mungesa e burimeve bazë njerëzore dhe materiale gjithashtu ndikon negativisht në perceptimin e aktorëve të sistemit të drejtësisë në lidhje me vlerën dhe rëndësinë e punës së tyre, duke çuar në më shumë indiferencë dhe performancë të dobët.

iii. Kapaciteti dhe ekspertiza

Identifikimi i shkakut rrënjësor të performancës së dobët është sfidues. Problemet konsistojnë në burime të pamjaftueshme strukturore, duke përfshirë drejtimin dhe koordinimin joefektiv nga aktorët e lartë gjyqësorë si dhe një mungesë aftësish

ose vullneti për të shfrytëzuar aftësitë ekzistuese. Për shembull, në shumicën e kërkesave për gjykim në të gjitha juridiksionet, projekti gjeti mospërputhje ndërmjet përshkrimit faktik dhe cilësimit juridik, arsyetim të pamjaftueshëm, madje edhe

mospërshkrimin e dëmit ekonomik që pretendohet se është shkaktuar nga vepra; mangësi këto që shpesh çojnë në akuza të paprovuara dhe, si pasojë, pafajësi dhe konfiskime të kufizuara pasurish. Në të gjitha juridiksionet, ka gjithashtu probleme me arsyetimin e pamjaftueshëm në vendime, që çojnë rregullisht në rigjykime. Programet e ndërtimit të kapaciteteve të ofruara si nga institucionet lokale edhe nga komuniteti ndërkombëtar

janë të shumta me një shtrirje të gjerë lëndësh në të gjithë rajonin. Megjithatë, në shkallë të ndryshme, udhëzuesit, manualët e trajnimit dhe praktikët e vendosura që janë në dispozicion mbeten jo plotësisht të shfrytëzuara. Nevojitet ende një vlerësim i posaçëm nevojash për të zbuluar shkaqet reale të kapacitetit të dobët dhe nivelit të përshtatshëm të llojit të përgjigjes korrigjuese të nevojshme.

iv. Mekanizmat e llogaridhënies dhe të menaxhimit të performancës

Performanca dhe llogaridhënia individuale

Sistemet joefektive të menaxhimit të performancës për gjyqtarët dhe prokurorët, duke përfshirë kriteret e vlerësimit që favorizojnë sasinë mbi cilësinë, nuk nxisin performancën optimale. Përveç përmirësimit të vlerësimit të performancës individuale, nevojitet një angazhim i përbashkët për të promovuar dhe standardizuar praktikët më të mira, si dhe politika nxitëse për të zbatuar standarde që ekzistojnë në letër por nuk përkthehen në menaxhim të qenësishëm performance në praktikë

Performanca dhe llogaridhënia institucionale

Vlerësimi i performancës së përgjithshme gjyqësore kërkon përmirësim të konsiderueshëm, pasi

shumica e sistemeve gjyqësore përqendrohen më shumë në produkte sesa në matje rezultatesh. Për më tepër, mbledhja e fragmentuar dhe e parregullt e të dhënave pengon nxjerrjen e mësimave të dobishme.

Shumë sisteme gjyqësore nuk mbledhin të dhëna gjithëpërfshirëse në lidhje me çështje të rëndësishme KOK, duke lënë pa analizuar probleme dhe shqetësime kritike. Në fakt, të dhënat e publikuara nga institucionet gjyqësore nuk lejojnë identifikimin e prirjeve në administrimin e drejtësisë, duke ulur kapacitetin e vendimmarrësve për të marrë vendime të bazuara në prova dhe minimizuar ndikimin e këtyre të dhënave në ndërgjegjësimin dhe besimin e publikut.

Një qasje e orientuar nga të dhënat do të ndihmonte në këto aspekte.

Ashtu si në pjesën tjetër të Evropës, sistemet gjyqësore në BP kanë vështirësi në balancimin e dëshirës për të nxitur transparencë me të drejtën për privatësi dhe rregulloret e mbrojtjes së të dhënave.⁷ Pavarësisht kësaj, mungesa e mekanizmave të konsoliduar dhe të orientuar nga të dhënat për llogaridhënie minon efektivitetin gjyqësor dhe cenon besimin e publikut. Projekti do të vazhdojë të punojë për të identifikuar vlerat statistikore dhe

kornizat që mund të kapin performancën për të përmbushur "objektivat që shoqëria vendos për gjyqësorin" (siç parashikohet në Metodologjinë e Projektit).

Për më tepër, përpjekjet e qëndrueshme nga nisma si Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës për efikasitetin e drejtësisë (CEPEJ) kanë rol kyç në adresimin e këtij problemi, veçanërisht nga këndvështrimi i efikasitetit.

v. Përhapja e formalizmit

Në të gjithë rajonin, kultura e formalizmit i shtyn zyrtarët gjyqësorë të ndjekin rreptësisht kriteret minimale. Kjo theksohet veçanërisht aty ku kornizat rregullatore mungojnë ose janë të paqarta, ku zyrtarët gjyqësorë delegojnë si vertikalisht brenda hierarkisë dhe horizontalisht te kolegët e tyre. Gjetjet e Projektit tregojnë që kjo kulturë formalizmi ul nxitjen për

zbatimin si dhe marrjen përsipër të reformave; pengon cilësinë dhe efikasitetin e proceseve, duke çuar në pranimin e kërkesave për gjykim me mangësi teknike si dhe mosadresimin e përfaqësimit juridik të duhur ose të gabimeve procedurale nga të gjitha palët; dhe pengon ndarjen në kohë të informacionit me ekspertë dhe publikun e gjerë.

⁷ Grupi i Politikave të Projektit "Ndërtimi mbi Identifikuesin e Jurisprudencës Evropiane" Publikimi në internet i vendimeve të gjykatave në BE (Ndërtimi mbi Identifikuesin e Jurisprudencës Evropiane, 15 shkurt 2017), , <https://bo-ecl.eu/uploads/deliverableserrrdrrfff/Deliverable%20WS0-D1.pdf>

IV. HAPAT E MËTEJSHËM

Në të pesta juridiksionet, autoritetet dhe komuniteti ndërkombëtar kanë marrë përsipër aktivitete për të adresuar aspekte të caktuara të problemeve të identifikuara në këtë Raport. Këto përfshijnë strategji, plane veprimi, udhëzues dhe ndërtim kapacitetesh. Pavarësisht investimeve të konsiderueshme, arritja e progresit të qëndrueshëm do të kërkojë punë të mëtejshme.

Me këtë Raport, Projekti synon të promovojë rekomandimet e politikave të hartuara për të adresuar probleme sistemike në trajtimin e çështjeve KOK. Këto rekomandime duhen parë në kontekstin e gjerë të të gjithë sistemit të drejtësisë penale. Ashtu siç nuk ka një metodologji të pranuar në mënyrë universale për vlerësimin e efektivitetit, nuk mund të ketë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj reformave gjyqësore të nevojshme për të përmirësuar trajtimin e çështjeve KOK.

Legjislacioni dhe politikat e ndryshme institucionale, mund të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, objektivat dhe perceptimet shoqërore lokale të drejtësisë.

Grupet gjyqësore të interesit duhet të përqafojnë fleksibilitetin në hartimin e politikave, duke respektuar gjithashtu standardet e pranuar dhe duke marrë parasysh si ndërveprojnë zgjedhje të ndryshme politikash dhe planesh institucionale. Si rrjedhim, Projekti ka ndërmarrë një qasje të kujdesshme ndaj detyrës së ndërlikuar të hartimit të rekomandimeve të përshtatshme, konkrete dhe novatore.

Rekomandimet e Projektit kanë si qëllim parësor të mundësojnë vendimmarrjen, të nxitin marrjen përsipër dhe të rrisin besimin e publikut te gjyqësori. Nëse zbatohen në mënyrën e duhur, këto politika duhet të krijojnë një historik të

Historiku

Të krijohen parakushtet për një historik efektiv në lidhje me KOK, duke dhënë një udhëzim të qartë zbatimi, duke pasur parasysh burimet ekzistuese dhe kulturën juridike

Ndikimi

Të synohen ndryshime që kanë efekt të menjëhershëm ndërsa punohet për një ndikim të qëndrueshëm

Pranimi

Të adresohet rezistenca, duke marrë parasysh praktikën dhe kulturën aktuale të punës

pandërprerë, të sjellin ndikim të qëndrueshëm, të nxitin zgjidhje funksionale dhe të adresojnë rezistencën e mundshme.

Duke pranuar që në këtë fushë ekzistojnë aktualisht përpjekje të konsiderueshme, Projekti ka vënë një theks të veçantë në aktivitete që mund të përmirësojnë motivimin e grupeve të interesit për të vënë në zbatim mjetet që kanë aktualisht në dispozicion.

Rekomandimet aktuale bazohen në dokumentet jopublike të punës të vitit 2023 të Projektit (periudha e rishikimit korrik 2021 deri në qershor 2023), që janë ndarë drejtpërdrejt dhe në mirëbesim me grupet e interesit të sistemit të drejtësisë në nëntor 2023. Projekti u konsultua me këto grupe interesi për të vlerësuar qëndrimet e tyre ndaj rekomandimeve para përfshirjes së tyre në këtë Raport. Këto rekomandime u mbështetën gjithashtu

nga ministrat e drejtësisë në Forumin Ministerial BE-Ballkani Perëndimor për Çështjet Kombëtare dhe të Drejtësisë të vitit 2023.

Në mbështetjen e shumicës së këtyre rekomandimeve, grupet e interesit në sistemin e drejtësisë në të pesta juridiksionet aktualisht i kanë përfshirë disa prej tyre në kornizat e tyre të reformave. Duke njohur angazhimin e të gjitha grupeve të interesit për partneritete konstruktive dhe vizionare me OSBE-në dhe BE-në si donatore të Projektit, rekomandimet që janë zbatuar paraprakisht nga grupet e interesit reflektohen siç duhet në këtë Raport. Megjithatë, vënia në zbatim e këtyre përpjekjeve do të qëndrojë brenda qëllimit të këtij Projekti, dhe progresi do të raportohet në raportet e ardhshme.

V. Shqipëria

Hyrje

Vlerësimet e fundit të kryera nga Projekti në trajtimin e çështjeve KOK në Shqipëri zbuluan si progres ashtu edhe sfida të vazhdueshme.

Në përgjithësi, të drejtat e procesit të rregullt ligjor po ruhen në çështjet e monitoruara, por ngrihen shqetësime në lidhje me pezullimin e afateve të paraburgimit të të gjithë bashkëpandehurve nga ana e gjykatave, pavarësisht kontributit të tyre individual në vonesë. Ka mangësi transparence si pasojë e komunikimit jokonsistent me median dhe përditësimet e parregullta në faqen e internetit⁸, që mund të cënojë besimin e publikut. Mangësitë e identifikuar të kërkesat për gjykim dhe vendimet si dhe problemet e vazhdueshme si proceset e ngadalta të emërimit dhe mungesat në pozicione kyçe minojnë vazhdimisht efikasitetin dhe përbëjnë sfida shtesë për administrimin efektiv të drejtësisë, që kërkon profesionistë të motivuar me

aftësi të posaçme.

Pavarësisht këtyre sfidave, ka rritje të konsiderueshme të hetimeve në çështjet KOK të profilit të lartë, përfshirë çështjet e pastrimit të parave, duke treguar angazhimin e Prokurorisë së Posaçme (SPAK) për të luftuar çështjet KOK. Rregullat e sjelljes dhe etikës dhe udhëzuesit për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe gjyqtarëve janë vendosur tashmë. Ministria e Drejtësisë (MD) gjithashtu ka krijuar një rrjet koordinatorësh antikorrupsion për të shtuar përpjekjet kundër korrupsionit. Miratimi i udhëzuesit të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është gjithashtu një hap pozitiv në adresimin e problematikës së lidhur me transparencën. Efektet e të gjitha këtyre zhvillimeve duhet të shqyrtohen ngushtësisht për të vlerësuar progresin e prekshëm.

⁸ <https://www.gjp.gov.al/>

<https://gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/>

Drejtësia

1

Rekomandim

Të sigurohet që praktika gjyqësore për pezullimin e afateve të paraburgimit të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për të drejtat e procesit të rregullt ligjor. Për këtë qëllim:

- i. Në kuadrin afatshkurtër, Gjykata e Lartë duhet të nxjerrë një vendim unifikues që harmonizon praktikën dhe siguron pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare të procesit të rregullt ligjor.
- ii. Në kuadrin afatgjatë, Kuvendi duhet të miratojë ndryshime në nenin 265 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) për të shmangur paqartësitë ligjore në lidhje me pezullimin e afateve të paraburgimit për të bashkëpandehurit.

Paraburgimi shërben si një masë sigurimi e zakonshme në drejtësinë penale shqiptare, veçanërisht në çështjet që kanë raste KOK, ku 40 nga 48 çështje të monitoruara kishin të pandehur në paraburgim. Megjithatë, kjo praktikë ka pasoja për procesin e gjyqimit, pasi një ditë në paraburgim barazohet me një ditë e gjysmë në dënimin përfundimtar. Kjo shpesh përdoret si taktikë mbrojtjeje për të ulur dënimet por kontribuon në vonesa në gjykim.⁹ Për të shmangur situatat ku të pandehurit lirohen si pasojë e skadimit

të afateve të paraburgimit¹⁰, ndryshimet në KPP në vitin 2017 vunë në zbatim pezullimin e këtyre afateve nëse vonesat procedurale shkaktohen në mënyrë të pajustificuar nga i pandehuri dhe/ose avokati mbrojtës.

Megjithatë, Projekti identifikoi një problematikë me pezullimin e afateve të paraburgimit për të bashkëpandehurit që nuk shkaktonin shtyrje në 73 seanca, duke shtyrë afatet e paraburgimit në mënyrë të paarsyeshme.

⁹ Neni 57 i KP

¹⁰ Shih: Delijorgji kundër Shqipërisë, Nr. i Aplikimit 6858/11

Kjo mund të krijojë probleme në lidhje me të drejtën e lirisë sipas nenit 5 të KEDNJ-së, pasi të pandehurit vuajnë pasoja negative për vonesat e shkaktuara nga të pandehurit e tjerë, në kundërshtim me standardet e gjykimit të drejtë. Afati i paraburgimit pezullohet në rastet kur i pandehuri ose avokati i tij mbrojtës shkakton shtyrjen e seancës për shkak të “akteve ose kërkesave të padrejta” ose mosparaqitjes.¹¹ Megjithëse formulimi i ligjit nuk jep shkas për të nënkuptuar më shumë se një të pandehur, gjykatat vazhdojnë ta interpretojnë dispozitën në një mënyrë që duket se bie ndesh me të drejtën e lirisë.

Një analizë krahasuese me vendet evropiane, veçanërisht Italinë, gjeti dispozita të ngjashme në KPP-të e tyre. Megjithatë, KPP-ja italiane qartëson që pezullimi i afateve nuk zbatohet për personat e bashkëpandehur që kërkojnë gjykim të shkëputur. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) kritikoi trajtimin e paraburgimit nga Shqipëria, duke cituar vonesat e shkaktuara nga avokatët e të bashkëpandehurve si dëshmi e pakujdesisë.¹²

Duke nënvizuar këtë qëndrim, në një vendim kundër Shqipërisë, GJEDNJ-ja mori parasysh se gjykata e shkallës së parë, duke justifikuar paraburgimin e ankuesit, u ishte referuar vonesave në proces të shkaktuara nga avokati i të bashkëpandehurit të tij.

Në mungesë të masave për të adresuar këto vonesa, nuk mund të thuhet që sistemi kombëtar i drejtësisë penale e kishte trajtuar çështjen e ankuesit me “kujdes të veçantë”¹³.

Gjyqtarët dhe prokurorët e njohën këtë problem, duke ua atribuuar dispozitave të KPP-së dhe vendimeve jokohërente të Gjykatës së Lartë. Sugjerimet përfshinin nxjerrjen e vendimeve për ndarjen e çështjes, ose ndryshimin e KPP-së për të adresuar këtë problem dhe për ta vënë atë në pajtim me standardet ndërkombëtare të procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu, siç vërehet në Itali, Gjykata e Lartë mund të nxjerrë vendime unifikuese për të harmonizuar praktikën dhe për të siguruar pajtueshmëri me standardet e procesit të rregullt ligjor. Këto veprime do të korrigjonin paqartësinë në interpretimin e ligjit, do të garantonin të drejtat e të pandehurve, dhe do të ruanin parimet e procesit të rregullt ligjor në sistemin shqiptar të drejtësisë penale.

Së fundi, më 14 shtator 2023, Ministria e Drejtësisë ka paraqitur një projektakt të pjesshëm të pjesës së përgjithshme të një Kodi të ri Penal (KP) për konsultim publik, ku një ditë paraburgimi barazohet me një ditë dënimi në vendimin e formës së prerë. Projekti e shikon këtë si një hap para në adresimin e kësaj çështjeje.¹⁴

¹¹ Neni 265 i KPP.

¹² Neni 304 paragrafi 5 i KPP të Italisë

¹³ Çështja Mucaj kundër Shqipërisë, Vendim i datës 11 korrik 2023, § 23

¹⁴ Një Kod Penal i ri për Shqipërinë - Ministria e Drejtësisë (drejtesia.gov.al).

Të sigurohet përfaqësim ligjor efektiv në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Për këtë qëllim:

- i. MD-ja dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA) duhet të kryejnë një rishikim rregullator dhe buxhetor si dhe një analizë kosto/përfitim – përmes një grupi ndërinstitucional pune – për të lehtësuar një rritje të përshtatshme në tarifat e avokatëve të caktuar kryesisht. Duhet të vihet theksi në shpërblimin e avokatëve të caktuar kryesisht për të përfaqësuar të pandehurit para Gjykatave të Posaqme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO).
- ii. MD-ja dhe DHKA-ja duhet të hartojnë një listë të posaqme avokatësh kryesisht për të përfaqësuar të pandehurit para GJKKO-ve.
- iii. MD-ja dhe DHKA-ja duhet të punojnë për një propozim për një ndryshim në Ligjin për profesionin e avokatit¹⁵ dhe të miratojnë një procedurë të posaqme në Statutin e DHKA-së për monitorimin e punës së avokatëve mbrojtës kryesisht në çështjet e mbrojtjes së detyrueshme.
- iv. DHKA-ja duhet të përforcojë një procedurë transparente, të konsoliduar dhe me afate të përshtatshme për trajtimin e pretendimeve kundër avokatëve mbrojtës për të rritur llogaridhënien e tyre dhe për të përmirësuar efikasitetin e proceseve.

E drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga traktatet themelore për të drejtat e njeriut, përfshin mbrojtjen ligjore efektive. Të pandehurit kanë të drejtën për ndihmë juridike cilësore, qoftë e zgjedhur apo e dhënë falas nëse nuk mund ta përballojnë, duke siguruar

kështu procese të drejta penale.”¹⁶ Në Shqipëri, e drejta kushtetuese për mbrojtje ligjore efektive vështirësohet nga sfidat për dhënien e ndihmës nga avokatët mbrojtës të caktuar kryesisht. Projekti vëzhgoi mungesën e avokatëve të caktuar kryesisht gjatë seancave

¹⁵ Ligj nr. 55/2018, “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁶ Neni 6, paragrafi 3 (c) i KEDNJ-së parashikon që: “të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë”.

gjyqësore dhe përfaqësimin joefektiv, duke përfshirë refuzimet për të marrë çështje ose dorëheqjet. Në gati 48,1% të seancave joproductive (265 nga 552), mungesa e avokatëve mbrojtës u citua si arsyeja kyçe, duke çuar në procese të tejzgjatura.¹⁷ Për më tepër, Projekti vërejti që gjykatat kishin raportuar dhe informuar DHKA-në për sjellje të papërshtatshme nga avokatët mbrojtës sipas legjislacionit.¹⁸

Shqetësime gjithashtu u ngritën në lidhje me tarifat e ulëta të paguara ndaj avokatëve mbrojtës të caktuar kryesisht, duke kontribuar në problemet e lartpërmendura. Tarifat, që paguhen për proces gjyqësor, janë dukshëm të ulëta në krahasim me juridiksionet e tjera të BP-së, duke shkruajuar përfaqësimin cilësor. Tarifat aktuale, nga 36.000 lekë (afërsisht 330 euro) në 88.000 lekë (afërsisht 800 euro),¹⁹ mbulojnë procese që mund të zgjatin deri në tre vjet ose më shumë, duke çuar në probleme financiare për avokatët. Paketa e Instrumenteve të Vlerësimit të Drejtësisë Penale nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin thekson ndikimin e kompetencës, arsimit dhe shpërblimit

të duhur në cilësinë e përfaqësimit nga avokatët e caktuar kryesisht, që shpesh paguhen më pak se kolegët e tyre në sallën e gjyqit.²⁰

Rritja e tarifave të avokatëve të caktuar kryesisht kërkon ndryshime në Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë²¹ dhe Kryetarit të DHKA-së, duke siguruar një modalitet llogaritjeje të parashikueshëm të bazuar në kriteret e qarta dhe një politikë të drejtë shpërblimi. Proceset e përsheptuara dhe të strukturuar të shpërblimit për çdo hap procedural janë thelbësore. Tarifat e rritura motivojnë përfaqësim më të mirë, duke inkurajuar ndjekje të rregullt dhe përgatitje për seancat që kërkojnë mbrojtje efektive.

Megjithatë, Projekti merr parasysh që rritja e tarifave për avokatët e caktuar kryesisht në vetvete nuk do të adresojë problematikën në lidhje me cilësinë e përfaqësimit ligjor. DHKA-ja duhet të hartojë gjithashtu një listë të veçantë të avokatëve të caktuar kryesisht të pajisur me aftësi dhe përvojë të posaçme të nevojshme për rolin në çështjet e mbrojtjes së detyrueshme para GJKKO-ve.

¹⁷ Neni 31, paragrafët (b) dhe (ç) i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon që: "Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet," si dhe "të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme".

¹⁸ Neni 56 i KPP-së dhe dispozitat e Ligjit nr. 55/2018 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë".

¹⁹ Urdhri i Përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë nr. 1284/3 datë 16.03.2005 "Për Miratimin e Tarifave të Shpërblimit të Svokatëve për Dhënien e Ndihmës Juridike" parashikon dhe përcakton tarifat e avokatëve të caktuar kryesisht.

²⁰ Shih fq. 1 e Instrumentit të Vlerësimit të Drejtësisë Penale të UNODC-së "Aksesi në drejtësi: Mbrojtja ligjore dhe ndihma juridike"; https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/cjat_eng/4_Legal_Defence_and_Legal_Aid.pdf.

²¹ Urdhri i Përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë nr. 1284/3 datë 16.03.2005 "Për Miratimin e Tarifave të Shpërblimit të Svokatëve për Dhënien e Ndihmës Juridike".

Kjo listë duhet të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me MD-në dhe gjykatat. Për më tepër, Projekti gjithashtu merr parasysh që duhet të miratohet një dispozitë e veçantë ligjore që të detyrojë avokatët e caktuar kryesisht të përfshirë në çështjet e mbrojtjes së detyrueshme para GJKKO-ve t'i nënshtrohen një trajnimi të posaçëm. Gjithashtu, në bazë të nenit 244 (7) të Ligjit nr. 115/2016:

“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, DHKA-ja mund të lidhë një marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës (SHM) për të ofruar trajnim të rregullt, të posaçëm për avokatët e caktuar kryesisht.

Për më tepër, duhet të propozohen ndryshime në Ligjin nr. 55/2018 dhe

Statutin e DHKA-së për të futur një dispozitë dhe procedurë të veçantë për monitorimin e cilësisë së punës së avokatëve mbrojtës të caktuar kryesisht në çështjet para GJKKO-ve.

Kjo përfshin miratimin e rregulloreve të brendshme dhe akteve nënligjore që ende mungojnë për të vendosur një praktikë transparente dhe të konsoliduar për adresimin e shpejtë të pretendimeve për sjellje të papërshtatshme. Gjyqtarët i mbështesin në mënyrë unanime këto rekomandime, duke njohur natyrën e shumanshme të çështjeve si seancat joproductive dhe të drejtat e cenuara të mbrojtjes për shkak të mungesës dhe joprofesionalizmit të avokatëve të caktuar kryesisht.

3

Rekomandim

Të sigurohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) të fuqizojë transparencën dhe qasjen në informacion në çështjet KOK duke zbatuar udhëzuesit që rregullojnë marrëdhënien e GJKKO-ve me publikun dhe median. Për këtë qëllim:

i. KLGJ-ja duhet të sigurojë që të publikohen/përditësohen rregullisht informacione të sakta dhe në kohë për çështjet KOK në platformat përkatëse, duke përfshirë kalendarin e gjykatës për seancat publike.

ii. KLGJ-ja duhet të përmirësojë komunikimin e saj me shoqërinë civile dhe median duke siguruar që KLGJ-ja dhe GJKKO-të t'u përgjigjen kërkesave për informacion në mënyrë të shpejtë, të

rregullt dhe gjithëpërfshirëse. Ky përmirësim duhet të përfshijë mbajtjen e konferencave për shtyp në mënyrë të rregullt dhe/ose kur ka çështje KOK me interes të lartë publik.

iii. KLGJ-ja duhet të sigurojë që GJKKO-të të publikojnë rregullisht versione të shkurtuara të vendimeve – dhe versionin e plotë kur është e mundur – duke respektuar të drejtat e privatësisë

Zbatimi i duhur i detyrave të gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun përmes komunikimit të rregullt me publikun dhe median, përditësimi në kohë reale i zhvillimeve gjyqësore të rëndësishme dhe një qasje më e standardizuar për publikimin e vendimeve do të rritin transparencën, duke rritur si rrjedhim besimin e publikut te sistemi gjyqësor. Legjislacioni shqiptar²² parashikon që të gjitha vendimet gjyqësore duhet të publikohen sipas kriterëve ligjore përkatëse, si dhe duke marrë parasysh kufizimet përkatëse të të dhënave personale. Kuadri aktual ligjor gjithashtu parashikon rolin dhe përgjegjësitë e një gjyqtari të veçantë të caktuar për marrëdhëniet me publikun në çdo gjykatë, që duhet të jetë përgjegjës për komunikimin e institucionit me publikun dhe median, duke siguruar dhënien e

informacioneve të rregullta për zhvillime të rëndësishme gjyqësore dhe duke respektuar pajtueshmërinë e publikimit të vendimeve gjyqësore me dispozitat ligjore²³.

Megjithatë, Projekti ka vërejtur si problematikë mosinformimin, nga ana e gjykatave, të publikut dhe medias rreth aktivitetit të GJKKO-ve në lidhje me publikimin e vendimeve, komunikimin me median dhe dhënien e informacioneve të tjera të rëndësishme në çështje me interes publik, pavarësisht nëse kjo lidhet me punën e përgjithshme të gjykatave apo detaje për çështje të veçanta. Faqja e internetit e GJKKO-ve ka të publikuar dispozitivin e një numri të kufizuar vendimesh, duke përjashtuar çështje të gjykuara nga këto gjykata.

²² Neni 46, "Marrëdhëniet me Publikun", i Ligjit nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor".

²³ Neni 91, "Qasja në Drejtësi dhe Marrëdhëniet me Publikun", Ligji nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë".

Kjo mungesë e një strategjie komunikimi të qartë dhe gjithëpërfshirës me publikun u konfirmua gjatë konsultimeve me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile (OSHC), që theksuan se vendimet kanë informacione të reduktuara së tepërmi.

Megjithëse Shqipëria ka ratifikuar kohët e fundit Konventën e Tromsø (Konventa e Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentet Zyrtare)²⁴, nuk ka një praktikë të unifikuar se çfarë përbën të dhëna personale. Ka raste ku edhe emrat e gjyqtarit dhe prokurorit anonimizohen, duke penguar të drejtën e publikut për t'u informuar.

Si hap pozitiv në adresimin e kësaj çështjeje, KLGJ-ja ka miratuar një udhëzues²⁵ që adreson problematikën kryesore të vërejtur nga Projekti në këtë drejtim. Udhëzuesi rregullon marrëdhëniet ndërmjet gjykatave, publikut dhe medias dhe parashikon një rregullim të detajuar dhe të qartë të detyrave dhe përgjegjësi të gjyqtarit dhe punonjësve të tjerë të gjykatës për mbajtjen e marrëdhënieve me publikun.²⁶

Së fundi, Projekti rekomandon që KLGJ-ja t'i kushtojë përparësi zbatimit të udhëzuesit të lartpërmendur për të siguruar që të ketë një komunikim transparent dhe gjithëpërfshirës ndërmjet GJKKO-ve, publikut dhe medias.

²⁴ Në korrik 2022, Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare, CETS 205 - Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare (coe.int).

²⁵ Në datën 6 dhjetor 2023, KLGJ miratoi "Udhëzimet Standarde për Marrëdhëniet e Gjykatave me Publikun dhe Median", VENDIM-Nr.-716-Datë-06.12.2023-PËR-MIRATIMIN-E-UDHËZUESIT-STANDARD-TË- MARRËDHËNIEVE-TË-GJYKATAVE-ME-PUBLIKUN-DHE-MEDIAN-.pdf.

²⁶ Udhëzuesi parashikon çështjen e anonimizimit dhe publikimit të vendimeve nga gjykatat, duke hequr paqartësitë e vërejtura nga Projekti në projektudhëzuesin e parë. Më në veçanti, udhëzuesi parashikon që, për çështjet KOK të profilit të lartë të gjykuara nga GJKKO-të, vendimet gjyqësore nuk duhet të publikohen të anonimizuara për shkak të nivelit të lartë të interesit publik në këto çështje. Duke hequr paqartësitë përmes përcaktimit të rolit aktiv të gjykatave në dhënien e informacionit, udhëzuesi lehtëson një zbatim të barabartë të së drejtës së informacionit publik kur bëhet fjalë për çështje të nivelit të lartë që përbëjnë interes të veçantë publik.

Efikasiteti

4

Rekomandim

Autoritetet kombëtare duhet të përkufizojnë dhe t'u japin përparësi çështjeve KOK të nivelit të lartë. Për këtë qëllim:

i. KLGJ-ja dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), në bashkëpunim me MD-në, duhet të miratojnë rregullore për të përkufizuar çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar për qëllime statistikore dhe politikëbërëse.

ii. Për të njëjtat qëllime, KLGJ-ja dhe KLP-ja, në bashkëpunim me MD-në, duhet të miratojnë kritere shtesë për të dalluar çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar të nivelit të lartë nga çështjet “e zakonshme” të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

iii. Në bazë të këtij sistemi kategorizimi, MD-ja, KLGJ-ja dhe KLP-ja duhet të marrin parasysh sa më poshtë:

- Dhënia e përparësisë ndaj ndjekjes dhe gjykimit të çështjeve KOK të nivelit të lartë, duke përfshirë miratimin e planeve të punës nga prokuroritë dhe gjykatat për të trajtuar këto çështje.
- Projektimi i çështjeve KOK të nivelit të lartë për të shpërndarë burime të përshtatshme të prokurorisë dhe gjykatat e përfshira në trajtimin e tyre.
- Sigurimi që kriteret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të reflektojnë në mënyrë të përshtatshme sfidat e veçanta të pranishme kur trajtohen çështje KOK të nivelit të lartë.

Në Strategjinë për BP-në të vitit 2018, KE-ja theksoi se, rruga drejt zgjerimit, kërkon krijimin e “një historiku konkret dhe të qëndrueshëm përsa i përket

përballjes me korrupsionin, pastrimin e parave dhe krimin e organizuar” si një çështje urgjente.²⁷

²⁷ (Balkans_BorchureA5_V7.indd (europa.eu) fq.5).

Parakushti për krijimin e këtij historiku është vendosja e një sistemi kategorizimi të përshtatur mirë dhe të besueshëm për të identifikuar çështjet KOK dhe çështjet KOK të nivelit të lartë. Në fund të fundit, është e pranuar përgjithësisht se nuk mund të përmirësosh diçka që nuk mund ta matësh²⁸. Kategorizimi i çështjeve KOK dhe çështjeve KOK të nivelit të lartë, së paku, do t'u mundësojë institucioneve kombëtare të krijojnë statistika të qëndrueshme për trajtimin e këtyre çështjeve, dhe do të mundësonte një pikë reference të qartë për vlerësimin e progresit të tyre.

Projekti është i vetëdijshëm se autoritetet kombëtare shpesh përdorin kritere të bazuara në të drejtën penale për të identifikuar çështjet KOK dhe çështjet KOK të nivelit të lartë. Për shembull, si çështje korrupsioni identifikohen ato që përfshijnë krime të veçanta (si ryshfeti ose shpërdorimi i detyrës); si çështjet korrupsioni të nivelit të lartë identifikohen ato që janë në kompetencën lëndore të prokurorive të posaçme ose gjykatave të posaçme që merren me një grup më të ngushtë veprash korrupsioni.

Megjithatë, kjo nuk është e besueshme për qëllime statistikore dhe nuk shërben si bazë për politikëbërjen. Dispozitat e së drejtës penale duhet të

jenë të rrepta, objektive dhe me sa më pak hapësira për interpretim të jetë e mundur për të garantuar sigurinë juridike. Si pasojë, kriteret e bazuara në të drejtën penale janë të ngurta dhe nuk mund të kapin nuancat që përcaktojnë përfundimisht se çfarë është një çështje KOK e nivelit të lartë. Për shembull, një çështje korrupsioni kundër një zyrtari të lartë ka të ngjarë të jetë e nivelit më të lartë se një çështje e ngjashme kundër një zyrtari më të ulët. Megjithatë, ndryshimi nuk mund të zbulohet vetëm në bazë të zbatimit të dispozitave penale. Për këto arsye, rekomandohet që autoritetet kombëtare të miratojnë kritere të posaçme për përcaktimin e këtyre çështjeve pavarësisht nga kuadri ligjor penal dhe veçanërisht për qëllimet e politikëbërjes.

Sistemi i propozuar i kategorizimit, nëse hartohet siç duhet, mund të jetë një mjet thelbësor për hartimin dhe zbatimin e masave kyçe që synojnë përmirësimin e përgjigjeve gjyqësore ndaj çështjeve KOK, veçanërisht në lidhje me çështjet e nivelit të lartë. Përveç krijimit të të dhënave të besueshme sasiore në lidhje me trajtimin e këtyre çështjeve, ky sistem mund të përdoret gjithashtu për t'i dhënë përparësi ndjekjes dhe gjykimit të çështjeve KOK të nivelit të lartë nga prokuroritë dhe gjykatat.

²⁸(You Are What You Measure (forbes.com))

Për shembull, mund të parashikohen objektiva specifike në lidhje me trajtimin e këtyre çështjeve në planet vjetore të punës së gjykatave dhe prokurorive. Ky projektim i çështjeve të nivelit të lartë në prokuroritë dhe gjykatat e ndryshme në sistemin kombëtar mund të përdoret për të rishpërndarë burimet njerëzore dhe materiale në vendin dhe kohën ku nevojiten më shumë.

Së fundi, kriteret e vlerësimit të performancës për gjyqtarët dhe prokurorët duhet të reflektojnë punën dhe sfidat e shtuara që kërkojnë nga çështjet KOK, veçanërisht ato të nivelit të lartë. Shpërblimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve që punojnë me këto çështje me pikë vlerësimi shtesë,²⁹ për shembull, mund të jetë një mjet efektiv në nxitjen e një përgjigjeje gjyqësore më efikase dhe profesionale ndaj çështjeve KOK.

Nga ana tjetër, zhvillimi i kriterëve të tilla kërkon vëmendje dhe ekspertizë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në lidhje me kategorizimin e çështjeve KOK të nivelit të lartë. Kriteret në fjalë duhet të përfshijnë tiparet thelbësore të një

çështjeje të nivelit të lartë sa i përket seriozitetit dhe kompleksitetit, si dhe të jenë mjaftueshëm të qarta dhe të lehta për t'u zbatuar. Kriteret e përshtatshme mund të tregojnë ose ndjeshmërinë e çështjes – për shembull, duke kategorizuar çështjet në bazë të pushtetit dhe rëndësisë së të pandehurit – ose masën e veprimit, duke miratuar kriteret e bazuara në dëmin ose fitimin ekonomik që rezultojnë nga vepra penale, ose pasojat në jetën dhe mirëqenien e viktimave të saj.

Lloje të tjera kriteresh mund t'i referohen kompleksitetit të çështjes, për shembull, për sa i përket numrit të të pandehurve, sasisë së provave që do të nxirren, numrit të ekspertëve të nevojshëm, konfiskimit të pasurive, ose nevojës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike (NNJ) ose Mjete të Posaçme të Hetimit (MPH).

Të gjitha këto kriteret janë të rëndësishme dhe qasja më e mirë është miratimi i një kombinimi kriteresh që mund të ponderohen përmes një sistemi pikëzimi të mirëbalancuar.

²⁹Metodologjia e Pikëzimit për Vlerësimin e Gjyqtarëve është një mjet që përdoret nga KLGJ-ja për të matur punën vjetore të gjyqtarëve. Rezultati i vlerësimit mund të ndikojë ndjeshëm në promovimin e një gjyqtari.

Të rishikohet kompetenca lëndore e GJKKO-ve për të siguruar efikasitet në trajtimin e çështjeve KOK më serioze. Për këtë qëllim:

- i. Grupi ndërinstytucional i punës (GP) për miratimin e ndryshimeve në KP duhet të rishikojë dispozitat ekzistuese duke përjashtuar GJKKO-të nga gjykimi i kundërvajtjeve penale të kryera nga zyrtarët publikë (shpifje dhe fyerje).
- ii. Grupi ndërinstytucional i punës për miratimin e ndryshimeve në KPP duhet të propozojë ndryshime për të rritur pragun që përcakton kompetencën lëndore të SPAK-ut dhe GJKKO-ve për veprat e korrupsionit.

Reforma kushtetuese e vitit 2016 krijoi SPAK-un dhe GJKKO-të dhe përcaktoi kompetencën e tyre lëndore për të ndjekur dhe gjykuar, përkatësisht, të gjitha veprat penale KOK. Për më tepër, GJKKO-të janë kompetente për të gjykuar të gjitha akuzat penale kundër zyrtarëve të lartë publikë aktualisht në detyrë, ose nëse vepra penale është kryer gjatë kryerjes së detyrës.³⁰

Në vitin 2021, për të lehtësuar ngarkesën e punës nga veprat penale të nivelit të ulët, Kuvendi miratoi ndryshime në KP dhe KPP duke ngushtuar kompetencën lëndore të SPAK-ut vetëm me veprat penale me

një vlerë minimale të produkteve të veprës penale mbi shumën e 50.000 lekëve (afërsisht 450 euro) për korrupsionin aktiv (neni 244 i KP-së), ndikimin e paligjshëm ndaj zyrtarëve publikë (neni 245/1) dhe korrupsionin pasiv (neni 259); dhe mbi 800.000 lekë (rreth 6.800 euro) për veprën penale të shkeljes së parimit të barazisë në tenderët publikë (neni 258).

Prokuroritë dhe gjykatat e përgjithshme janë kompetente për ndjekjen dhe gjykimin e së njëjtave vepra penale, por me vlerë më të ulët të produkteve të veprës penale.

³⁰Nenet 135 (2) dhe 147/dh të Kushtetutës së Shqipërisë, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016

Projekti ka vëzhguar se çështjet e korrupsionit që përfshijnë vepra penale të nivelit të ulët, por që janë brenda pragut të prokurorive dhe gjykatave të posaçme (prokuroritë dhe gjykatat e përgjithshme janë kompetente për ndjekjen dhe gjykimin e veprave penale me vlerë më të vogël), kontribuojnë në ngarkesën e tepërt të çështjeve për SPAK-un dhe GJKKO-të, gjë që mund të ndikojë në kapacitetet e tyre për të proceduar çështje më serioze. Kështu, KPP-ja duhet të ndryshohet duke rritur pragun që përcakton kompetencën lëndore të SPAK-ut dhe dy GJKKO-ve.

Gjatë konsultimeve, gjyqtarët propozuan llogaritjen e shumës sipas një shumëfishimi të pagës minimale në fuqi. Raporti i saktë i shumëzimit duhet të përcaktohet pas konsultimeve me grupet përkatëse të interesit, ekspertë juridikë dhe financiarë dhe partnerë ndërkombëtarë.

Gjithashtu, gjykatat e posaçme trajtojnë³¹ një numër të madh çështjesh për “shpifje” (neni 120 i KP-së) dhe “fyerje” (neni 119) ndaj zyrtarëve të lartë. Gjatë konsultimeve me ekipin e projektit, gjyqtarët nga të dyja shkallët – GJKKO-të e Shkallës së Parë dhe Apelit – dhe prokurorët pranuan një ngarkesë pune të rënduar që kërkon përpjekje shtesë për t’u marrë me këto çështje më pak serioze, si dhe që heqja e akuzave penale private nga kompetenca e tyre lëndore kur të pandehurit janë zyrtarë të lartë publikë do të zvogëlojë ndjeshëm ngarkesën e punës.

Së fundmi, Drejtuesi i SPAK-ut njohu nevojën për të rritur vlerën e kompetencës lëndore gjatë mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Integritetit Evropian të Kuvendit të Shqipërisë.³²

³¹ Vendim Unifikues nr. 23/2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

³² [Dumani kërkon heqjen e ‘korrupsionit të vogël’ nga kompetenca e SPAK – Reporter.al](https://www.reporter.al/dumani-kerkon-heqjen-e-korrupsionit-te-vogel-nga-kompetenca-e-spak/)

KL GjJ-ja, në konsultim me gjyqtarët e GJKKO-ve, duhet të miratojë udhëzues për menaxhimin e seancave gjyqësore të çështjeve KOK të ndërlikuara, i cili ndër të tjera duhet të përfshijë rolin dhe funksionin e seancës paraprake. Udhëzuesi duhet të nxisë teknika efektive të menaxhimit të seancave gjyqësore, të tilla si mbajtja e seancave të njëpasnjëshme në çështjet KOK të ndërlikuara.

Udhëzuesi për menaxhimin e seancave gjyqësore dhe rregullat e menaxhimit të çështjeve do të siguronte angazhimin e palëve dhe përshejtimin e procesit dhe, së paku, do të adresonte:

- i. përcaktimin e kohës së nevojshme për gjykimin;
- ii. rënien dakord për një datë të paracaktuar për seancën;
- iii. numrin dhe qëllimin e dëshmitarëve që secila palë planifikon të thërrasë;
- iv. nëse do të ketë prova me ekspertë ose dëshmitarë dhe emrat, profesionet, titulli/pozicioni i çdo eksperti a dëshmitari;
- v. nëse secila palë do të përfaqësohet nga një avokat, disponueshmëria e tyre dhe të dhënat personale;
- vi. nëse ka dokumente që duhet të shkëmbehen ose të merren nga jashtë;
- vii. si do të paraqiten provat;
- viii. nëse ka ndonjë kërkesë të veçantë për paraqitjen e provave (për shembull, një dëshmitar jashtë qytetit që dëshiron të japë dëshmi me telefon ose video-telefonatë);

Rekomandim

- ix. angazhimin e një eksperti me marrëveshje të përbashkët;
- x. rënien dakord për të shkëmbyer informacion shtesë;
- xi. diskutimin për provat e kërkuara, duke përfshirë dëshmitarët dhe dokumentet duke i renditur ato dhe duke përcaktuar se si do të gjenden dhe do t'i paraqiten gjykatës në kohën e kërkuar;
- xii. përfshirjen e një historiku të kohëzgjatjeve të paraburgimit dhe një plan kohor të përgjithshëm të procedurave;
- xiii. shkëmbimin e informacionit të kontaktit për të informuar shpejt palët për anulimet e seancave - vetëm për arsye të justifikuara - në mënyrë që të shmanget prania e panevojshme e palëve dhe dëshmitarëve në gjykatë.

Projekti ka identifikuar kohëzgjatjen e tepërt të proceseve në çështjet KOK të nivelit të lartë dhe të mesëm si një problem sistematik për shkak të mungesës së menaxhimit efektiv të

çështjeve gjyqësore. Aktualisht duket se çështjet KOK të nivelit të lartë mund të zgjaten pa kufizim, pasi sistemi gjyqësor nuk ka vullnetin ose mundësinë për të marrë masat e duhura.

Mesatarja mujore e seancave të mbajtura




Figura 4 - Nr. mesatar i seancave në muaj

Kohëzgjatja mesatare e proceseve (në muaj)




Figura 5 - Kohëzgjatja mesatare e proceseve (në muaj)

Adresimi i këtij problemi jo vetëm kërkon aftësi më të mira menaxhuese nga gjyqtarët dhe prokurorët, por edhe një ndryshim rrënjësor në politikën institucionale. Kuadri ligjor aktual parashikon një sërë masash të gjyqimit paraprak si caktimi i një date seance, thirrja e dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe masa të tjera urgjente.³³

Megjithatë, këto masa, pavarësisht se janë pjesë përbërëse e procedurës së gjyqimit kryesor të parashikuar nga KPP-ja, nuk janë shteruese dhe gjithëpërfshirëse sa duhet për të adresuar nevojat e gjyqimit paraprak.

Për më tepër, gjyqtarët ankohen për përdorimin e taktikave të zvarritjes së procedurave gjyqësore nga avokatët mbrojtës, duke përfshirë shfrytëzimin e shpeshtë të problemeve shëndetësore, dorëheqjet e vazhdueshme për arsye të ndryshme, dhe kërkesat për shtyrje seancash për shkak të përplasjes së angazhimeve. Projekti vëzhgoi raste ku trupi gjykues veproji në mënyrë proaktive për të përmirësuar efikasitetin e gjyqeve. Në 15 nga 48

çështjet e monitoruara, trupi gjykues paracaktoi seanca të njëpasnjëshme ose mori masa si shpërndarja e aktit të ekspertimit para seancës për t'u mundësuar palëve të parapërgatiteshin.

Megjithatë, këto masa, ndonëse pozitive, ishin të rastësishme dhe nuk u zbatuan nga të gjithë gjyqtarët në mënyrë të unifikuar.

Mungesa e udhëzimeve dhe një procedure të njehsuar për fazën paraprake të gjyqimit po pengon zhvillimin e drejtë, efikas dhe të shpejtë të seancave gjyqësore, që në përfundim mund të prishë vetë qëllimin e procedurës.

Pavarësisht se problemet strukturore në aspektin e burimeve u pranuan edhe nga grupet e interesit gjatë konsultimeve, aktualisht ekzistojnë mjete procedurale që mund të përdoren për të adresuar çështjen. Gjyqtarët mbështetën propozimin për zbatimin e rregullave të planifikimit të gjyqit, megjithëse kishte pikëpamje të ndryshme se si duhet bërë kjo,

³³ Neni 333-338 i KPP-së

nëpërmjet ndryshimeve në KPP ose thjesht nëpërmjet udhëzimeve për menaxhimin e çështjeve.

Zbatimi i kësaj procedure në legjislacione të tjera, si në Mbretërinë e Bashkuar,³⁴ u mundëson gjykatave të identifikojnë më herët çfarëdo problemi, si për shembull nevojat e dëshmitarëve, dhe qartëson se çfarë duhet bërë, nga kush dhe kur. Një udhëzim i tillë do të ndihmonte në vendosjen e standardeve për përfaqësimin nga mbrojtja dhe do të siguronte një pikë referimi për të përcaktuar se kur mund të kërkohet ndërhyrja.

Zbatimi i udhëzimeve duhet të mbështetet përmes trajnimeve gjithëpërfshirëse për të përmirësuar nivelin e përfaqësimit. Veprime të dobishme në këtë drejtim përfshijnë

caktimin e hershëm të një orari për të siguruar progresin e çështjes; sigurimin që provat të paraqiten në mënyrën më të shkurtër dhe të qartë; shkurajimin e vonesave; trajtimin e sa më shumë aspekteve të çështjes të jetë e mundur dhe shmangien e seancave të panevojshme; inkurajimin e palëve të bashkëpunojnë për të siguruar avancimin e çështjes; dhe shfrytëzimin e teknologjisë. Projekti rekomandon që KLJG-ja të krijojë një grup pune, bashkë me përfaqësues të gjyqtarëve të GJKKO-së, për të miratuar udhëzues për menaxhimin e seancave gjyqësore dhe për t'i bërë ato pjesë përbërëse të rregullave të brendshme të gjykatës. Përveç sigurimit të një zbatimi të njehsuar nga të gjithë gjyqtarët, këto udhëzime do të ndihmojnë në ofrimin e procedurave më të shpejta, garantimin e të drejtave të të akuzuarve dhe rritjen e efikasitetit të gjykatës.

7

Rekomandim

KLJG-ja duhet të krijojë një listë gjyqtarësh të specializuar në çështje KOK, që mund të caktohen menjëherë në çështje të reja ose në vazhdim. Për këtë qëllim:

- i. KLJG-ja duhet të hartojë një rregullore të veçantë ku të përcaktohen kriteret dhe procedurat për funksionimin e sistemit të delegimit të gjyqtarëve që janë vetëm për GJKKO-të.
- ii. Gjyqtarët në skemën e delegimit, ose ata që janë transferuar ose emëruar përkohësisht për të shqyrtuar një çështje të veçantë në GJKKO (më poshtë “gjyqtarë të përkohshëm”), duhet të marrin trajnime të posaçme për veprat penale KOK, si dhe për praktikat e brendshme të GJKKO-ve nga SHM-ja.

³⁴ Rregullat e Procedurës Penale (MB), Pjesa 3 “Menaxhimi i Çështjeve”.

iii. Gjyqtarët në sistemin e delegimit të GJKKO-ve duhet të marrin pikë shtesë në vlerësimin e performancës së tyre nga KLGJ-ja në krahasim me gjyqtarët e sistemit të delegimit në gjykatat e zakonshme.

Projekti vuri në dukje problematikën në lidhje me efikasitetin e sistemit të delegimeve të KLGJ-së dhe performancën e gjyqtarëve të transferuar përkohësisht nga gjykata të tjera ose të caktuar në çështje të veçanta për të adresuar ngarkesën e punës, çështjet e prapambetura, ose nevoja të veçanta brenda sistemit gjyqësor. Veçanërisht, përveç çështjes së vonësive në caktimin e tyre, Projekti ka vëzhguar raste ku këta gjyqtarë të përkohshëm kanë shkaktuar vonesa dhe kanë ndikuar në efikasitetin e proceseve. Konkretisht, seancat (23 ose 2,35% të seancave të vëzhguara) shtyeshin përtej afatit ligjor prej 15 ditësh kalendarike për shkak të mbingarkesës së gjyqtarëve të përkohshëm, ndërsa dispozitat e KPP-së nuk lejojnë asnjë shtyrje të këtij afati. Projekti ka vëzhguar gjithashtu shtyrje të njëpasnjëshme të seancave për shkak të mungesës së një gjyqtari të përkohshëm si pasojë e angazhimeve urgjente në gjykata të tjera ose emërimit të tij në gjykata më të larta. Projekti vërejti gjyqe të stërzgjatura me shtyrje të shpeshta edhe në çështjet e gjykuara nga gjyqtarët e përkohshëm.

Çështjet KOK shpesh përfshijnë shumë të pandehur, një sërë hetimesh, dosje voluminoze të çështjeve, dëshmitarë të mbrojtur, të pandehur me historik të gjatë kriminal, transaksione financiare të ndërlikuara, komunikime të enkriptuara dhe çështje të ndihmës së ndërsjellë juridike. Është e një rëndësie të madhe që gjyqtarët e përkohshëm të kenë ekspertizën dhe aftësitë e nevojshme për të trajtuar çështjet KOK me të njëjtën aftësi si gjyqtarët e përhershëm. Një listë e veçantë gjyqtarësh të trajnuar për çështjet KOK do të sigurojë trajtimin e këtyre çështjeve më efektivisht duke shmangur mospërputhjet dhe pabarazinë e mundshme në administrimin e çështjes dhe dhënien e dënimit, si dhe një proces të përshtetshëm rekrutimi. Për më tepër, një listë e veçantë do t'i stimulojë gjyqtarët e përkohshëm duke u dhënë atyre më shumë pikë vlerësimi sesa gjyqtarët në skemën e delegimit të gjykatave të zakonshme, dhe përparësi në procesin e rekrutimit për pozicionet vakante në GJKKO.

Për më tepër, KLGJ-ja duhet të hartojë rregullore të veçanta që përcaktojnë

kriteret dhe procedurat që rregullojnë sistemin e delegimit për gjyqtarët e përkohshëm vetëm për çështje të veçanta në GJKKO, duke përfshirë stimuj për të qenë pjesë e kësaj liste. Këto rregullore të posaçme duhet të përmbajnë kriteret të veçanta

përzgjedhjeje përveç atyre të parashikuara në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë trajnimin e detyrueshëm për veprat e korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe njohjen me praktikën e brendshme të gjykatave të posaçme, ndër të tjera.

8

Rekomandim

Të rritet pragu minimal i gjobave të zbatueshme për avokatët si masë ndëshkuese ndaj mungesës së pajustificuar, siç parashikohet në nenin 350 (4) të KPP-së.

Projekti ka konstatuar vazhdimisht se një nga shkaqet kryesore të zvarritjeve procedurale që cenojnë efikasitetin e gjyqësorit është mungesa e pajustificuar e avokatëve. Megjithatë neni 350(4) i KPP-së i jep trupit gjykues mundësinë për t'i vendosur gjobë (nga 5.000 lekë (50 euro) në 100.000 lekë (1.000 euro) avokatit në fjalë nëse ai nuk paraqitet në seancë dhe nuk ka pengesa të arsyeshme, Projekti vëzhgoi se shumica e sanksioneve ishin më pranë pragut minimal të zbatueshëm (5.000 lekë ose afërsisht 50 euro). Ky nuk është ndëshkim i mjaftueshëm për këtë sjellje, veçanërisht kur merret parasysh mungesa e praktikës së njehsuar në vendosjen e gjobave dhe shumat e tyre.

Për krahasim, neni 34 i Kodit të Procedurës Civile ka sanksionuar një kufi minimal prej 50.000 lekësh (ose afërsisht 400 eurosh) në çështjet ku palët shpërdorjnë me vetëdije të drejtat e tyre në proces.

Gjatë konsultimeve me ekipin e projektit, gjyqtarët propozuan llogaritjen e masës së gjobave në bazë të një shumëfishimi të pagës minimale në fuqi, për të shmangur përditësimin e vazhdueshëm të dispozitave ligjore të zbatueshme. Raporti i saktë i shumëzimit duhet të përcaktohet pas konsultimeve me grupet përkatëse të interesit, ekspertë juridikë dhe financiarë dhe partnerë ndërkombëtarë.

GJKKO-ja e Shkallës së Parë, GJKKO-ja e Apelit dhe Prokuroria e Posaçme (SPAK) duhet të pajisen me ndihmës ligjorë shtesë, për të lehtësuar trajtimin e ngarkesës së madhe të çështjeve. Për këtë qëllim:

- i. KLGJ-ja duhet të zbatojë dispozitën ligjore për krijimin e njësisë ligjore, emërimin e ndihmësve ligjorë në GJKKO-në e Shkallës së Parë.
- ii. KLGJ-ja dhe KLP-ja duhet të rrisin numrin aktual të ndihmësve ligjorë repsektivisht në GJKKO-në e Apelit dhe SPAK.

Projekti konstatoi se ekziston një mungesë e përgjithshme e ndihmës profesionale për gjyqtarët e GJKKO-ve. Me ngarkesën e lartë të dosjeve, kjo mungesë e ndihmës profesionale gjithashtu kontribuon në kohëzgjatjen e proceseve dhe cilësinë e akteve gjyqësore. Kjo problematikë u nënvizua në Raportin e fundit Vjetor për Gjendjen e Gjyqësorit (viti 2022)³⁵ të publikuar nga KLGJ-ja. Në këtë raport konstatohet se pavarësisht se emërimi i gjyqtarëve të rinj (në vitin 2022, tre gjyqtarë të rinj u emëruan në GJKKO-në e Apelit, ndërsa një u emërua në GJKKO-në e Shkallës së Parë) e uli lehtë ngarkesën e dosjeve për gjyqtar, dosjet e prapambetura të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe fakti që të dyja gjykatat ende nuk funksiononin në kapacitet të plotë burimesh njerëzore, e rritën

ndjeshëm kohën e nevojshme për të mbyllur një çështje. Për GJKKO-në e Shkallës së Parë, koha e nevojshme për të trajtuar një çështje korrupsioni është dyfishuar, ndërsa koha që duhet për të trajtuar një çështje krimi të organizuar është rritur me 24% në krahasim me vitin e mëparshëm. Për GJKKO-në e Apelit, koha e nevojshme për të trajtuar një çështje është rritur me 40%.

Pavarësisht nga më sipër, GJKKO-të ende funksionojnë sipas strukturës së parashikuar nga dispozitat e vjetra ligjore (para ndryshimeve të datës 23 mars 2021), ku GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka ndihmës ligjorë dhe GJKKO-ja e Apelit ka një numër të kufizuar ndihmësish ligjorë. Si pasojë, të dyja gjykatat aktualisht funksionojnë pa mbështetjen strukturore të parashikuar nga ligji.

³⁵ "Raporti Vjetor i KLGJ-së 2022", [RAPORT-VJETOR-2022-shkarko.pdf \(klgj.al\)](#).

Gjatë konsultimeve, gjyqtarët konfirmuan nevojën për mbështetje të mëtejshme nga ndihmësit ligjorë, duke theksuar vështirësitë me të cilat përballen në trajtimin e dosjeve voluminoze, si dhe respektimin e të gjitha afateve ligjore dhe gjetjen e kohës dhe mbështetjes së nevojshme për hartimin e akteve gjyqësore. Ndryshimet e fundit në Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”³⁶

parashikojnë mundësinë që të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe apelit (përfshirë GJKKO-të) të kenë një njësi ligjore të përbërë nga ndihmës ligjorë të emëruar nga KLGJ-ja.

Duke parë nevojën urgjente për ndihmë profesionale për të menaxhuar mbingarkesën e dosjeve në mënyrë më efikase, Projekti rekomandon që KLGJ-ja të emërojë numrin maksimal të ndihmësve të parashikuar me ligj.

Kapaciteti

10

Rekomandim

Cilësia e akteve gjyqësore të nxjerra nga GJKKO-të dhe SPAK-u duhet të përmirësohet, duke përfshirë zhvillimin e mjeteve specifike për t'i orientuar ata në hartimin e këtyre akteve. Për këtë qëllim:

- i. KLGJ-ja duhet të hartojë një model për hartimin e vendimeve për gjyqtarët e GJKKO-ve. Modeli duhet të reflektojë kriteret ligjore të vendimeve, si dhe kërkesa teknike shtesë, për të siguruar ligjshmërinë dhe cilësinë e aktit.
- ii. KLP-ja duhet të hartojë një model për hartimin e kërkesave për gjykim për prokurorët e SPAK-ut. Modeli duhet të reflektojë kriteret ligjore të kërkesave për gjykim, si dhe kërkesa teknike shtesë, për të siguruar ligjshmërinë dhe cilësinë e aktit.

³⁶ Neni 42 i Ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor”, i ndryshuar.

iii. Prokuroria e SPAK-ut duhet të krijojë mekanizma të brendshëm për rishikimin e kërkesave për gjykim përpara përfundimit, duke siguruar njëkohësisht një ekuilibër të përshtatshëm midis autonomisë së prokurorit dhe autoritetit të eprorit për të dhënë urdhra në raste të veçanta. Mekanizmi duhet të mbështetet te një udhëzues i posaçëm që përcakton saktësisht procesin e kontrollit të cilësisë për hartimin e kërkesave për gjykim dhe përfshin tregues cilësorë rreth cilësisë së kërkesave për gjykim për vlerësimin e performancës së prokurorëve.

iv. KLGJ-ja duhet të rishikojë treguesin e performancës në lidhje me cilësinë e vendimeve gjyqësore në sistemet e menaxhimit të performancës për gjyqtarët, duke integruar këto udhëzime të reja në procesin e vlerësimit. Trajnimi i komisionit vlerësues për zbatimin e këtyre standardeve të reja është gjithashtu i rëndësishëm.

Projekti konstatoi se 22 nga 49 vendimeve u mungonte një analizë e plotë dhe kishin të meta strukturore, veçanërisht në adresimin e të gjitha pretendimeve të mbrojtjes dhe përgjigjen ndaj argumenteve të tyre ligjore.

Lidhja e provave nuk ishte përshkruar në mënyrën e duhur në lidhje me faktet penale për të cilat akuzoheshin të pandehurit. Shpesh ishte e vështirë të shihej se si lidhej me veprën çdo provë dhe si provoheshin akuzat kundër çdo të pandehuri.

Nga ana tjetër, në 31 nga 42 kërkesa për gjykim të analizuar mungonte një strukturë gjithëpërfshirëse, duke rezultuar në mosplotësimin e një ose më shumë nga elementet e kërkuara nga KPP-ja.

Jo të gjitha kërkesat për gjykim përmbanin një përshkrim të qartë të fakteve, veprimeve ose mosveprimeve të të pandehurve dhe një analizë të provave mbështetëse.

Kërkesat për gjykim që përfshinin shumë të pandehur shpesh nuk e përshkruanin mënyrën e përgjegjësisë dhe nuk i parashtrojnë qartë provat që vërtetonin kontributin penal individual të çdo të pandehuri ndaj çdo veprë për të cilën ishte akuzuar.

Në këtë pikë, gjyqtarët e GJKKO-së së Apelit njohën një mungesë të përgjithshme të një qasjeje të strukturuar dhe të rregullt analitike ndaj vendimeve, por edhe sugjeruan që KLGJ-ja duhet të shqyrtojë me më shumë kujdes cilësinë e vendimit si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

Modelet e vendimeve dhe kërkesave për gjykim të përshtatura me kërkesat e KPP-së mund të mundësojnë një strukturë gjithëpërfshirëse për të lehtësuar punën e hartimit për gjyqtarët dhe prokurorët, duke përmbajtur të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e KPP-së³⁷ dhe sugjeruar teknikat dhe praktikën më të mira për hartimin e akteve në çështje të ndërlikuara dhe të përshtaten për të adresuar sfidat e veçanta ligjore të çështjeve KOK.

Qëllimi i këtyre modeleve duhet të jetë që t'i bëjnë aktet ligjore më të lehta për t'u lexuar nga të pandehurit pa ndërhyrë në lirinë e gjyqtarëve apo prokurorëve për të hartuar një akt ligjor sipas vlerësimit të tyre më të mirë. Praktika e përdorimit të modeleve të vendimeve

mbështetet gjithashtu nga Udhëzimet CEPEJ³⁸ për shkak të efekteve pozitive në përmirësimin e procesit të përgjithshëm të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

Për më tepër, projekti rekomandon që një grup gjyqtarësh dhe prokurorësh duhet të përfshihen nga KLGJ-ja dhe KLP-ja përkatësisht në hartimin e këtyre modeleve për të marrë njohuritë më të mira të mundshme, që do të çonte në rezultate të prekshme në modele të mirëstrukturuara.

Për më tepër, në rrethanat ku ndihma profesionale mungon, modelet e standardizuara do të ishin një ndihmesë e rëndësishme në përgatitjen e akteve gjithëpërfshirëse të mirëstrukturuara si në gjyqësor dhe në prokurori.

³⁷ Neni 383 i KPP-së "Elementet e Vendimit" dhe neni 331/3 i KPP-së "Kërkesa për Dërgimin e Çështjes në Gjyq".

³⁸ Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), "Udhëzues në Fushën e Efikasitetit të Drejtësisë", Seksioni V, pika A, paragrafi 3, 16809f007a (coe.int).

VI. Bosnja dhe Hercegovina

Hyrje

Përmirësimi i trajtimit të çështjeve KOK mbetet parësor për forcimin e sundimit të ligjit në Bosnjë-Hercegovinë (BeH). Pavarësisht aspiratave të shprehura politike dhe institucionale dhe dedikimit të konsiderueshëm nga zyrtarë të caktuar gjyqësorë, trajtimi efektiv dhe efikas i çështjeve KOK të nivelit të lartë mbetet i mangët. Në nivel institucional, trajtimi dhe gjykimi i këtyre çështjeve dhe thelbi i proceseve të vazhdueshme të reformave gjyqësore për të përforcuar integritetin, transparencën dhe llogaridhënien, shumë prej së cilave kundërshtohen nga politika, reflektojnë mangësi serioze. Në vitin 2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial (KLGJP) i BeH-së miratuan një agjendë gjithëpërfshirëse reformash për gjyqësorin, pavarësisht se shumë prej masave nuk janë zbatuar. Në shkurt 2024 u miratua një agjendë reformash e rishikuar dhe më e kufizuar. Ligji i ri për KLGJP-në e BeH-së nuk është miratuar ende. Në vitin 2023 u miratuan ndryshime në lidhje me integritetin në Ligjin ekzistues për KLGJP-në e BeH-së, pavarësisht se ndryshimet e momentit të fundit, kur krahasohen me tekstin e miratuar nga Komisioni i Venecias, mund të minojnë ndikimin e synuar të ligjit të ri.³⁹ Ligji i ri për gjykatat e BeH-së gjithashtu nuk është miratuar ende.

Ekziston një problematikë e vazhdueshme në lidhje me ndikimin e parregullt të jashtëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve që trajtojnë çështje KOK të nivelit të lartë. Konsultimet me grupet e interesit zbuluan probleme të konsiderueshme në lidhje me politizimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Projekti vëzhgoi probleme të ngjashme në disa çështje të monitoruara që përfshinin politikanë të nivelit të lartë. Çështjet e përshkruara më poshtë, kur vendosen në kontekstin e gjerë të frikësimit politik të gjyqësorit nga shteti, mund të jenë tregues të integritetit dhe pavarësisë së pamjaftueshme në vend të mungesave të thjeshta në kapacitete ose efikasitet.

Mungesa e burimeve njerëzore dhe planifikimit të mjaftueshëm rreth burimeve njerëzore aktuale në të gjitha institucionet mbetet problematike. Për shkak të ritmit të ngadaltë të procesit të emërimit, pozicionet gjyqësore shpesh mbeten të papërmbushura për muaj, ndonjëherë edhe vite. Gjyqtarëve gjithashtu u mungon personeli ndihmës i duhur. Si shenjë progresi, shtimi i këshilltarëve ekonomikë në prokurori i jep një mbështetje të vyer punës me të dhënat financiare.

³⁹ Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Bosnia dhe Hercegovina Opinion mbi Projektligjin mbi ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Lartë të Gjyqësorit dhe Prokurorisë, nr. 1015/2021 (Strasbourg: Council of Europe, CDL-AD(2021) 015, 23 mars 2020).

Megjithëse Projekti nuk monitoron fazën e hetimit, informacionet e marra gjatë konsultimeve si dhe të dhënat e monitorimit të çështjeve gjyqësore tregojnë se hetimet proaktive janë të rralla. Megjithatë, si zhvillim pozitiv, disa prokurori kanë miratuar plane veprimi për t'i dhënë përparësi hetimit të çështjeve të caktuara në bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese ose institucione të tjera të lidhura, si organet e antikorrupsionit.

Një tregues i mundshëm i progresit gradual është rritja e numrit të kërkesave për gjykim të pranuar në çështjet e nivelit të lartë që nga viti 2018.⁴⁰ Për shembull, në vitin 2023, në krahasim me vitin 2022, kërkesat e pranuar për korrupsion të nivelit të lartë u rritën nga 14 në 16, ndërsa për krimin e organizuar të nivelit të lartë nga gjashtë në 14. Megjithatë, rezultatet e këtyre çështjeve dhe mënyra e trajtimit të tyre mbeten për t'u parë. Në vitin 2023, janë dhënë tetë vendime të formës së prerë në çështjet KOK të nivelit të lartë.⁴¹

Kohëzgjatja e proceseve në çështjet KOK mbetet një problematikë e konsiderueshme. Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës shfaqin një shkallë të lartë tolerance për vonesat, madje një qëndrim në përgjithësi pranues, në mos indiferent, kundrejt proceseve joefikase.

Si një zhvillim pozitiv, KLGJP-ja e BeH-së miratoi një konkluzion me synim rritjen e disiplinës procedurale, që kërkon mbajtjen javore të seancave; megjithatë, në shumë çështje të monitoruara, kjo ende nuk është normë. Kërkohet një qasje mjaft më proaktive ndaj menaxhimit të çështjeve gjyqësore për t'i dhënë fund kulturës aktuale të joefikasitetit

Pjesa tjetër, e zhvilluar në bazë të gjetjeve dhe konsultimeve të çështjeve gjyqësore nga Projekti dhe konsultimeve me zyrtarë gjyqësorë, paraqet dhjetë rekomandime për t'i adresuar këto çështje mjaft urgjente.

⁴⁰ KLGJP-ja e BeH-së hartoi një përkufizim të çështjeve të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë në vitin 2019, dhe e rishikoi në vitin 2021, që përfshin shqyrtimin e statusit të të pandehurit dhe rëndësinë e veprës penale të akuzuar.

⁴¹ Të dhënat nga KLGJP BeH, mars 2024, në dosje me Projektin.

Drejtësia

1

Rekomandim

Të rritet transparenca dhe qasja në informacion për trajtimin e çështjeve KOK, në veçanti:

i. KLGJP-ja e BeH-së duhet të sigurojë njësimin e praktikës duke hartuar ose përditësuar rregulloret aktuale për organizimin e gjykatave dhe prokurorive, dhe udhëzues që parashikojnë standarde minimale në lidhje me:

- Publikimin e akteve gjyqësore dhe informacioneve të tjera në lidhje me proceset penale, duke përfshirë orarin e seancave.
- Përgjigjen në kohë ndaj kërkesave për informacion.
- Komunikimin me publikun gjatë hetimit dhe në çështjet me interes publik.

ii. KLGJP-ja e BeH-së duhet të krijojë një grup konsultues për mediat dhe/ose të mbajë mbledhje të rregullta me median për të diskutuar dhe zgjidhur sfida në lidhje me aksesin në informacion.

Projekti identifikoi një mungesë transparence dhe qasje të pamjaftueshme në informacion në lidhje me çështjet KOK, duke përfshirë publikimin e parregullt të orareve të seancave nga gjykatat, publikimin e parregullt të akteve gjyqësore dhe proceset e gjata dhe problematike për të marrë informacion duke përdorur ligjet për lirinë e informacionit. Këto sfida u konfirmuan përmes konsultimeve me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupe interesi gjyqësore. Në fakt megjithëse grupet e

interesit i njohën gjerësisht hapat e marrë nga gjyqësori për të nxitur transparençën, shoqëria civile dhe media mbeten të zhgënjyera nga mungesa e informacioneve në kohë. Zyrtarët gjyqësorë shprehën një sërë qasjesh dhe këndvështrimesh në lidhje me ndarjen e informacionit për proceset penale me publikun, duke reflektuar qasjen e fragmentuar ndaj transparençës nga institucionet e ndryshme gjyqësore.

Udhëzuesit aktualë për publikimin e akteve gjyqësore nuk zbatohen në mënyrë të njësuar. Pavarësisht se KLGJP-ja e BeH-së ka mbajtur shumë mbledhje *ad hoc* me përfaqësues

të medias, një modalitet më i qëndrueshëm, si një grup konsultues për mediat, është një mënyrë më e rregullt komunikimi të dyanshëm ndërmjet gjyqësorit dhe medias.

2

Rekomandim

Të promovohet zbatimi i njësuar i ligjit për të nxitur sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit. Më në veçanti:

- i. KLGJP-ja e BeH-së, si dhe gjykatat e apelit në BeH, duhet të vazhdojnë të përmirësojnë raportimin dhe klasifikimin e praktikës gjyqësore në databazën e qëndrimeve juridike të gjyqtarëve dhe të sigurojnë që qëndrimet juridike të përfshihen në mënyrën e duhur.⁴²
- ii. Të gjithë zyrtarët gjyqësorë duhet t'u referohen dhe të mbështeten më shumë në qëndrimet juridike të gjyqtarëve të vendosura nga gjykatat më të larta.
- iii. KLGJP-ja e BeH-së, panelet e harmonizimit dhe gjykatat e apelit në BeH duhet të sigurojnë që të adresohen përplasjet e qëndrimeve juridike.
- iv. Ministritë e drejtësisë dhe organet ligjvënëse duhet t'i japin përparësi harmonizimit të legjislacionit material dhe procedural të lidhur me trajtimin e çështjeve KOK.

Zbatimi i njësuar i ligjit është thelbësor për sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit dhe kontribuon në drejtësi dhe barazi dhe perceptimin e publikut të këtyre të fundit. Në bazë të gjetjeve të monitorimit të çështjeve gjyqësore dhe

konsultimeve me zyrtarët gjyqësorë, mekanizmat për sigurimin e trajtimit konsistent të çështjeve të ngjashme janë të dobët. Për më tepër, vendimet dhe disponimet e shqyrtuara në çështjet e monitoruara rrallëherë

⁴² Databaza e qëndrimeve juridike të gjyqtarëve është e disponueshme në faqen e internetit të KLGJP-së së BeH-së: Baza.sudske.prakse.pravosudje.ba.

përmbajnë referenca ndaj praktikave gjyqësore ose qëndrimeve juridike, që tregojnë mungesën e mbështetjes të këto të fundit. Mjetet dhe mekanizmat ekzistues duhet të përforcohen dhe promovohen për të siguruar njësim më të madh të zbatimit të ligjit në proceset penale në përgjithësi dhe në veçanti në çështjet KOK.

Për më tepër, harmonizimi i procedurës penale dhe së drejtës penale në lidhje me trajtimin e çështjeve KOK duhet të ndiqet në mënyrë aktive nga ministritë përkatëse të drejtësisë. Përpjekjet e posaçme për harmonizimin e legjislacionit duhet të zëvendësohen nga një organ i përhershëm ekspertësh me këtë mandat.

Efikasiteti

3

Rekomandim

KLGP-ja e BeH-së, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët duhet të promovojnë trajtimin efikas të çështjeve KOK, veçanërisht ato të nivelit të lartë. Më në veçanti, ata duhet të:

- i. Miratojnë udhëzues për menaxhimin e çështjeve gjyqësore për të adresuar çështje si identifikimi i çështjeve faktike dhe juridike të pranuar dhe të kundërshtuara, identifikimi i provave të pranuar dhe të kundërshtuara, disponueshmëria e dëshmitarëve dhe ekspertëve, dhe taktikat e zvarritjeve nga të gjithë pjesëmarrësit e proceseve.
- ii. Sigurojnë zgjidhjen e shpejtë të çështjeve penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të nivelit të lartë duke kërkuar një plan seancash që përmban oraret e seancave ditore ose – së paku – disa seanca në javë, deri në përfundimin e gjykimit.
- iii. Shfrytëzojnë të gjitha mjetet e disponueshme të politikave për të kërkuar dhënien e përparësisë ndaj çështjeve KOK të nivelit të lartë, duke përfshirë planet për reduktimin e dosjeve të prapambetura, planet vjetore dhe planet e veprimt të vendosura me institucione të tjera.
- iv. Kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët duhet të vendosin, në institucionet e tyre, një mekanizëm monitorimi për të siguruar trajtimin ose hetimin efikas të çështjeve KOK, me mbikëqyrje dhe raportim në KLGP-në e BeH-së.

Projekti identifikoi vonesa të panevojshme dhe të shmangshme në procese dhe një mungesë praktikash efikase të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, duke përfshirë planifikimin e parregullt të seancave, shtyrje dhe vonesa për shkak të shëndetit të pandehurve ose avokatëve. Edhe në çështjet që ishin zgjidhur në një kuadër kohor të përshtatshëm, një shqyrtim më i afërt i procesit zbuloi mungesë efikasiteti, si seanca që shpesh zgjatnin më pak se dy orë, gjë që nuk shfrytëzon efektivisht seancat e planifikuara dhe kohën e pjesëmarrësve, dhe dëshmitarë që nuk paraqiteshin.

Planifikimi i parregullt i seancave është një sfidë e konsiderueshme e kudondodhur si në çështjet penale të korrupsionit edhe ato të krimit të organizuar, pavarësisht kompleksitetit të çështjes. Megjithatë seancat paraprake mbaheshin rregullisht, ato nuk shfrytëzoheshin për të vendosur afate realiste për përfundimin e çështjes. Mesatarisht, në çështjet e monitoruara në shkallën e parë ose me vendim të formës së prerë pas procesit gjyqësor, seancat mbaheshin një herë në muaj në çështjet e krimit të organizuar dhe një herë në dy muaj në çështjet e korrupsionit (shih Figurën 6).

Mesatarja mujore e seancave të mbajtura




Figura 6 - Numri mesatar i seancave të mbajtura çdo muaj në 33 çështje aktive të përfunduara të monitoruara nga korriku 2021 në mars 2024

Autoritetet gjyqësore kanë publikuar informacione të kufizuara në lidhje me kohëzgjatjen e përgjithshme të proceseve, një faktor që shërben gjithashtu si tregues efikasiteti. Nga 17 çështje të monitoruara ku është dhënë një vendim i shkallës së parë, dhe që tani janë në apel, kohëzgjatja mesatare e proceseve deri në vendimin e shkallës së parë ishte mbi tre vjet, pra

mesatarisht mbahej një seancë në muaj. Në shumicën e rasteve, këto çështje kishin një shkallë kompleksiteti, me shumë të pandehur dhe akuza. Është e rëndësishme të përmendet që, për çështjet e krimit të organizuar, mesatarisht u mbajtën 60 seanca deri në vendimin e shkallës së parë, ndërsa për çështjet e korrupsionit 22 seanca.

Për më tepër, meqenëse të gjitha këto çështje janë në apel, kohëzgjatja totale e proceseve do të jetë në mënyrë të pashmangshme shumë më e gjatë. Sa u përket vendimeve të formës së prerë pas proceseve gjyqësore, kohëzgjatja mesatare e proceseve ishte 3,54 vjet.

Megjithatë, masa e kampionit është e vogël, pasi janë vetëm nëntë çështje. Për më tepër, këto ishin çështje të drejtpërdrejta, shumë prej së cilave kishin vetëm një ose dy të pandehur. Megjithatë, pavarësisht se këto çështje ishin relativisht të thjeshta, gjykatat mbanin një seancë në dy muaj.

Kohëzgjatja mesatare e proceseve në vite




Figura 7 - Kohëzgjatja mesatare e proceseve në 33 çështje të monitoruara nga korriku 2021 në mars 2024.

Në 16 çështje të monitoruara, kërkesa për gjykim ishte pranuar para vitit 2018. Pesë nga këto çështje janë ende në fazën e gjyimit kryesor; tri çështje janë në rigjykim; pesë çështje janë në apel; dhe vetëm tri çështje kanë përfunduar, një në shtator 2022, një në qershor 2023 dhe një në nëntor 2023. Pavarësisht nevojës për t'i përfunduar këto procese urgjentisht si pasojë e kohëzgjatjes nga pranimi i kërkesave përkatëse, mesatarisht mbahej vetëm një seancë në muaj në këto çështje.

Monitorimi i çështjeve vëren se çështjet KOK të nivelit të lartë mund të zgjaten pa kufizim, pasi sistemi gjyqësor nuk ka vullnetin ose mundësinë për të marrë masat e duhura për të bërë progres dhe

për t'i finalizuar këto çështje.

Adresimi i këtij problemi kërkon aftësi më të mira drejtuese, disiplinë të shtuar procedurale dhe një ndryshim rrënjësor në politikat institucionale, si dhe angazhim institucional dhe individual.

Megjithëse KLGJP-ja e BeH-së ka miratuar Rregulloren për Afatet Kohore për Trajtimin e Çështjeve në Gjykata dhe Prokurori në BeH (Rregullorja) në vitin 2013, që vendos afate kohore optimale dhe të parashikueshme për çdo lloj dhe fazë procesesh, kjo politikë nuk ka pasur ndikim të madh në efikasitet. Rishikimi i Rregullores ishte një masë e parashikuar nga Agjenda e Reformës e vitit 2021 e KLGJP-së së BeH-së.

Në maj 2023, e ndryshuar në shtator 2023, KLGJP-ja e BeH-së miratoi një konkluzion i cili kërkonte që seancat të mbaheshin çdo javë në çështjet KOK.

Kjo dhe masa të tjera të propozuara nga KLGJP-ja e BeH-së që synojnë të përmirësojnë efikasitetin e proceseve në çështjet KOK të nivelit të lartë duhet të zbatohen pa vonesa.⁴³ Udhëzuesit gjithëpërfshirës të menaxhimit të çështjeve gjyqësore janë të nevojshëm për të përmirësuar zgjidhjen efikase të çështjeve KOK. Këta udhëzues duhet të

adresojnë vonesat në procese duke dhënë një kuadër për nxitjen e kulturës kundër zvarritjeve. Për më tepër, planet e reduktimit të dosjeve të prapambetura dhe dokumentet strategjike duhet t'i japin përparësi përfundimit të çështjeve KOK të nivelit të lartë. KLGJP-ja e BeH-së, në bashkëpunim me çdo kryeprokuror dhe kryetar gjykate, duhet të vendosë një mekanizëm mbikëqyrjeje për të siguruar trajtimin efikas të çështjeve KOK.

Përmirësimi i Performancës

4

Rekomandim

KLGJP-ja e BeH-së, si dhe kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët, duhet të vazhdojnë të përmirësojnë mekanizmat për monitorimin, analizimin dhe raportimin publik të çështjeve KOK si pikë hyrëse në politikëbërje efektive dhe të drejtuar nga të dhënat, veçanërisht në lidhje me performancën e përgjithshme institucionale. Më në veçanti, ata duhet:

i. Të sigurojnë mbledhje dhe zëbrthim të dobishëm të të dhënave cilësore, që mund të përfshijë përcaktimin e mëtejshëm të parametrave për vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit në çështjet KOK si të nivelit të lartë edhe të tjera.

⁴³ KLGJP BeH, Agjenda e Reformës 2021-2023, Masa III.3.3: Të zhvillohen më tej aftësitë e menaxhimit të kohës dhe menaxhimit të çështjeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve; Masa III.3.7: Të analizohen dhe propozohen masa për të siguruar efikasitetin dhe efektivitetin në planifikimin dhe mbajtjen e seancave, duke përfshirë seancat paraprake, veçanërisht në çështje që përfshijnë korrupsionin, krimin e organizuar dhe krimet e luftës; Masa IV.1.7: Në planet e reduktimit të dosjeve të prapambetura të gjykatave dhe prokurorive të përfshihen me përparësi çështjet e korrupsionit dhe krimet të organizuar të nivelit të lartë

ii. Të përmirësojnë modalitetet e kryerjes së analizës cilësore të problemeve të veçanta që prekin trajtimin e çështjeve KOK, ndër të tjera përmes rritjes së kapaciteteve kërkimore të brendshme dhe të jashtme.

iii. Të përcaktojnë dhe përmirësojnë procedurat për kryerjen, analizën dhe përdorimin e analizave sasiore dhe cilësore në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë të tillë që këto të dhëna të informojnë përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e trajtimit të çështjeve KOK, dhe t'i publikojnë këto gjetje çdo vit.

KLGP-ja e BeH-së ka përmirësuar monitorimin institucional të trajtimit të çështjeve KOK, si dhe raportimin përkatës. Sistemi i menaxhimit të çështjeve i prokurorisë është modifikuar për të menaxhuar të dhëna shtesë dhe për të prodhuar statistika në aspekte kyçe të këtyre çështjeve, si konfiskimi i pasurive. Megjithatë, disponueshmëria e të dhënave të besueshme dhe të zbërthyer nga gjykatat për vendimet e dhëna në çështjet KOK, duke përfshirë dënimet kundër çdo të pandehuri, mbetet e kufizuar.

Kështu, mbledhja, nxjerrja dhe raportimi publik i të dhënave duhet të modifikohet më tej për të përmirësuar disponueshmërinë e këtyre informacioneve

KLGP-ja e BeH-së, në bashkëpunim me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët, duhet të kryejë dhe të publikojë analizë cilësore për trajtimin e çështjeve KOK, në veçanti me synim identifikimin e çështjeve sistemike dhe reformave përkatëse të nevojshme. Kjo do të komplementojë analizën e të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse dhe kuptimplotë. KLGP-ja e BeH-së duhet të identifikojë më tej ata që kanë kapacitetin teknik dhe objektivitetin për t'i kryer këto analiza, dhe pas përfundimit, duhet të përcaktojë grupet e interesit dhe modalitetet për të zbatuar dhe vijuar mbi rezultatet. Bashkëpunimi me organet e jashtme kërkimore, duke përfshirë ato akademike ose shoqërinë civile, duhet të përmirësohet.

KLGP-ja e BeH-së duhet të sigurojë që vlerësimi i performancës gjyqësore dhe të prokurorisë dhe kërkesat e ngarkesës së punës të reflektojnë angazhimin e nevojshëm për trajtimin e çështjeve KOK. Në veçanti, KLGP-ja e BeH-së, bashkë me zyrtarët gjyqësorë të përfshirë në proceset e vlerësimit të performancës, duhet të:

- i. Sigurojnë që komponentët sasiorë dhe cilësorë të vlerësimeve të performancës gjyqësore të reflektojnë në mënyrën e duhur kompleksitetin e trajtimit të çështjeve KOK të nivelit të lartë, si dhe angazhimin përkatës të nevojshëm.
- ii. Vazhdojnë të monitorojnë dhe të vlerësojnë ndikimin e ndryshimeve në aspektet sasiore dhe cilësore të vlerësimeve të performancës për prokurorët dhe gjyqtarët për të siguruar që të ketë stimul të përshtatshëm për të trajtuar efektisht çështjet KOK të nivelit të lartë.
- iii. Sigurojnë që vlerësuesit të zbatojnë në mënyrë të përshtatshme dhe të njësuar të gjitha dispozitat e vlerësimit që lejojnë një reflektim të përshtatshëm të efikasitetit dhe cilësisë së punës.

Për të siguruar drejtësi, vlerësimet e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të reflektojnë saktësisht ngarkesat përkatëse të punës, duke marrë parasysh kompleksitetin e këtyre çështjeve si dhe kohën dhe burimet e kërkuara për ndjekjen penale dhe gjykimin e tyre. Duke njohur sfidat e veçanta në trajtimin e çështjeve KOK të nivelit të lartë, kriteret e vlerësimit të ponderuara në mënyrën e duhur përfaqësojnë një stimul të fuqishëm për të punuar me këto çështje.

Kërkesat për gjykim

Që nga janari 2022, shumica e prokurorëve kanë një kuotë të reduktuar në çështjet KOK të nivelit të lartë për të siguruar një vlerësim më të balancuar të komponentit sasior të vlerësimit të performancës dhe për të motivuar prokurorët që të marrin përsipër këto çështje që janë më të vështira dhe kërkojnë më shumë kohë. Është ende e vështirë për të vlerësuar ndikimin e këtyre ndryshimeve. Të dhënat për numrin e kërkesave për gjykim të nivelit të lartë nga viti 2018 në

2023 shfaqin një pamje me kontraste. Në pamje të parë, duket se kuotat e rishikuara, si dhe faktorë të tjerë, kanë kontribuar në një numër të shtuar të

kërkesave të pranura për gjykimin e çështjeve të nivelit të lartë, megjithatë nuk mund të përcaktohet një marrëdhënie shkak-pasojë.

Numri i kërkesave për gjykim të rasteve KOK të konfirmuara




Figura 8 - Numri i kërkesave për gjykim të konfirmuara në rastet KOK. Burimi: KLGJP i BeH, mars 2024.

Numri i të pandehurve në çështjet KOK




Figura 9 - Numri i të pandehurve në rastet KOK. Burimi: KLGJP i BeH, mars 2024

Vendimet

Rezultatet gjyqësore në çështjet KOK të nivelit të lartë, të matura nga vendimet e formës së prerë të dhëna, janë të kufizuara (shih Figurën 10). Në veçanti,

kuota vjetore për gjyqtarët sa i përket krimit të organizuar është reduktuar, ashtu si ajo për prokurorët, por nuk janë bërë ndryshime të ngjashme për korrupsionin ose çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë.

Numri i vendimeve të formës së prerë në çështjet e nivelit të lartë




Figura 10 - Vendimet e formës së prerë të nivelit të lartë në BeH. Burimi: Memot e brendshme të KLGJP-së së BeH-së për trajtimin e çështjeve KOK nga viti 2019 në 2023.

KLGP-ja e BeH-së duhet të marrë masa për të siguruar që komponentët sasiore dhe cilësorë të vlerësimit të performancës gjyqësore të reflektojnë nivelin e kompleksitetit të çështjeve

KOK të nivelit të lartë. Ndryshimet në sistemin e vlerësimit duhet të synojnë nxitjen e trajtimit dhe përfundimit të këtyre çështjeve në mënyrë efikase dhe efektive.

6

Rekomandim

Të përforcohet ekspertiza e gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit juridik për të ndjekur dhe gjykuar çështjet KOK në mënyrë efektive dhe efikase, duke siguruar që institucionet të organizohen për të mbështetur zgjidhjen e këtyre çështjeve. KLGP-ja e BeH-së, në bashkëpunim me kryeprokurorët dhe kryetarët e gjykatave dhe, sipas rastit, qendrat e trajnimit të gjykatave dhe prokurorive të Republika Srpska-s (RS) dhe Federatës së Bosnjë-Hercegovinës (FBeH) duhet të:

- i. Promovojnë më tej specializimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndihmësve ligjorë në çështjet KOK dhe të vazhdojnë të ofrojnë trajnim të specializuar.
- ii. Monitorojnë, vlerësojnë dhe zgjidhin funksionimin, efikasitetin dhe ndikimin e departamenteve të posaçme në trajtimin e çështjeve KOK.

Sistemi gjyqësor i BeH-së ka ngritur departamente të posaçme për krimin e organizuar, korrupsionin dhe krimet ekonomike në disa gjykata dhe prokurori. Në FBeH, autoritetet po marrin masa për të ngritur departamente të posaçme brenda Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë së FBeH-së për trajtimin e çështjeve KOK. Megjithatë, ngritja e strukturave të

posaçme nuk është zgjidhje përfundimtare; duhet të adresohen një sërë faktorësh të tjerë, si sigurimi i një numri të përshtatshëm zyrtarësh gjyqësorë, ekspertësh financiarë të posaçëm dhe personeli ndihmës ligjor, si dhe lehtësimi i bashkëpunimit të ngushtë me agjencitë e posaçme ligjzbatuese dhe organe të tjera përkatëse.

KLGP-ja e BeH-së, qendrat e trajnimit të gjykatave dhe prokurorive, kryeprokurorët dhe kryetarët e gjykatave të FBeH-së dhe RS-së duhet të sigurojnë që gjykatat dhe prokuroritë të përfitojnë nga ekspertiza e gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm, ndihmësve dhe këshilltarëve ligjorë, praktikantëve, si dhe të ekspertëve

financiarë. Qasjet për të thelluar ekspertizën lëndore në fusha si prokurimi publik, privatizimi dhe pastrimi i parave duhet të shqyrtohen. Kjo mund të përfshinte trajnimin e vazhdueshëm dhe krijimin e një ekipi zyrtarësh gjyqësorë të posaçëm dhe të disponueshëm për të udhëhequr dhe këshilluar kolegët e tyre sipas nevojës.

7

Rekomandim

Të përmirësohen procedurat në lidhje me hartimin, shqyrtimin dhe pranimin e kërkesave për gjykim për të përmirësuar cilësinë e tyre. Më në veçanti:

i. Dispozitat për shqyrtimin e kërkesave për gjykim në rregulloret e prokurorive për organizimin e brendshëm duhet të përmirësohen për të ravijëzuar më tej procesin, duke përfshirë fushën e shqyrtimit dhe standardet e zbatueshme. Dispozita të veçanta në lidhje me lloje të caktuara veprash penale, si ato KOK, duhet të përfshihen sipas nevojës.

ii. Kryeprokurorët, zëvendëskryeprokurorët dhe krerët e departamenteve duhet të zbatojnë mekanizmin e shqyrtimit të kërkesave për gjykim në mënyrë të rregullt dhe të njësuar para përfundimit të një kërkesë për gjykim të çështjeve KOK.

iii. Kryetarët e gjykatave duhet të sigurojnë që gjyqtarët më me përvojë të shërbejnë si gjyqtarë të seancave paraprake për të vendosur për kërkesat për gjykim në çështjet KOK.

iv. Komuniteti i ekspertëve ligjorë, në bashkëpunim me ministritë përkatëse të drejtësisë, duhet të analizojë praktikat aktuale dhe të marrë parasysh zhvillimin e propozimeve ligjvënëse për të përforcuar procedurën e pranimin të kërkesës për gjykim për të siguruar një proces shqyrtimi gjyqësor gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke ruajtur njëkohësisht efikasitetin.

Kërkesat për gjykim të shqyrtuara nga Projekti përmbanin ndër të tjera, 1) përshkrime faktike të paqarta; 2) prova mbështetëse të palidhura me akuzën; 3) mungesë faktesh dhe provash të mjaftueshme për të mbështetur cilësimin juridik; dhe 4) mungesë informacioni për fitimin financiar. Konsultimet me zyrtarët gjyqësorë i konfirmuan këto probleme në lidhje me cilësinë e kërkesave për gjykim.

Rregulloret për organizimin e brendshëm të prokurorive parashikojnë që kryeprokurorët, zëvendëskryeprokurorët dhe/ose krerët e departamenteve shqyrtojnë kërkesat për gjykim të përgatitura nga prokurorët që ata mbikëqyrin. Megjithatë, fusha e shqyrtimit nuk përcaktohet. Është e paqartë nëse shqyrtimi kufizohet vetëm në pajtimin formal me kërkesat ligjore thelbësore

ose përfshin gjithashtu vlerësimin e mjaftueshmërisë së provave për akuzat ligjshmërinë e këtyre provave, dhe aspekte të tjera praktike ose strategjike. Kjo çon në praktika që ndryshojnë në varësi të prokurorit dhe prokurorisë. Për të fuqizuar dhe harmonizuar këtë proces, në të gjitha prokuroritë, procedurat përkatëse duhet të përkufizohen më tej.

Në aspektin e shqyrtimit ligjor të kërkesave për gjykim, gjyqtarët e seancave paraprake pothuajse gjithmonë i pranojnë kërkesat.⁴⁴ Gjatë konsultimeve, profesionistët shprehën shqetësimin se procedura për pranimin e kërkesave për gjykim ka shumë mangësi, duke përfshirë mungesën e një procesi mjaftueshëm ballafaques dhe pamjaftueshmërinë e kohës për të shqyrtuar kërkesën në mënyrën e duhur, veçanërisht për çështjet e ndërlikuara.

8

Rekomandim

Të përmirësohet cilësia dhe praktikrat në lidhje me vënien e sanksioneve të individualizuara dhe proporcionale në çështjet KOK. Më në veçanti:

i. Gjyqtarët duhet të sigurojnë që vendimet të kenë arsyetim të qartë dhe të posaçëm për sa i përket masës së dënimit, duke përfshirë zbatimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues dhe përdorimin e dënimeve të pezulluara. Ky arsyetim duhet gjithashtu të kontribuojë për të siguruar që dënimet të jenë të individualizuara, proporcionale dhe frenuese.

⁴⁴ KLGJP BeH, Raporti Vjetor 2022 (Sarajevë: KLGJP BeH) 57, që konfirmon se në 2022, 98 për qind e kërkesave të dorëzuara janë pranuar.

ii. KP-të duhet të ndryshohen për të hequr mundësinë e konvertimit të një dënimi me burgim deri në një vit në gjobë për veprat penale KOK të nivelit të lartë.

Në individualizimin e dënimeve, sanksionet duhet të jenë proporcionale me rëndësinë e veprës dhe rrethanat e autorit. Gjyqtarët duhet të japin arsyetim të qartë se pse u përdorën sanksione penale të caktuara, çfarë faktorësh u morën parasysh për të përcaktuar dënimin, dhe si e përmbush sanksioni qëllimin e dënimit. Në vendimet e shqyrtuara nga Projekti, cilësia e arsyetimit në lidhje me dënimet e dhëna, duke përfshirë përdorimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues, ishte e dobët. Gjyqtarët prireshin të përdornin gjuhë të ngurtë për rrethanat rënduese dhe lehtësuese, pa dhënë vlerësim të individualizuar të rrethanave të rastit ose të autorit. Për më tepër, vendimet u referoheshin “rrethanave tejet zbutëse” si bazë për uljen e dënimit nën minimumin e përcaktuar nga ligji pa justifikuar se si

përmbushej standardi tejet zbutës nga rrethanat lehtësuese⁴⁵. Vendimet gjithashtu nuk u referoheshin praktikave të tjera gjyqësore në lidhje me praktikën e caktimit të dënimit.

Duke shtuar mungesën e arsyetimit të përshtatshëm, dënimet e caktuara ishin shpesh pranë pragut minimal të lejuar dhe pezullimit të dënimeve. Kjo reflektohet në gjetjet dhe të dhënat e Projektit të marra nga KLGJP-ja e BeH-së. Figura 12 më poshtë jep të dhënat e KLGJP-së së BeH-së për dënimet kundër autorëve në çështjet KOK; këto të dhëna përfshijnë si vendimet e shkallës së parë edhe ato të formës së prerë. Në vitin 2021, në dënimet e caktuara për autorët në çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë, pothuajse për gjysmën prej tyre është pezulluar dënimi.

⁴⁵ Shih uljen e dënimit, KP BeH neni 49(1)(b); KP FBeH neni 50(1)(b); KP RS neni 53(3); KP RRB BeH neni 50(1)(b).

Dënimet e dhëna ndaj të pandehurve në çështjet KOK në BeH




Figura 11 - Dënimet në rastet e KOK. Burimi: KLGJP BeH, mars 2024.

Këto prirje mund të shihen edhe më dukshëm në çështjet e përfunduara të monitoruara nga Projekti. Nga 65 autorë të dënuar, vetëm 17 për qind morën një dënim me burgim mbi 12 muaj; afërsisht 39 për qind morën një dënim me burgim deri në 12 muaj; dhe për 41,5 për qind prej tyre u pezullua

dënimi (shih Figurën 12). Të dhënat gjithashtu tregojnë përdorimin e masave të sigurimit të ndalimit të një pune, aktiviteti ose detyre të caktuar, dhe gjobat si elemente shtesë të sanksionit. Masat e sigurimit u vendosën për 14 për qind të autorëve.

Dënimet e dhëna kundër të pandehurve në çështjet përfundimtare




Figura 12 - Sanksionet kundër 65 autorëve të dënuar (duke përfshirë personat juridikë) në çështjet e monitoruara dhe të përfunduara, korrik 2021 - mars 2024.

Të katërt KP-të kanë një dispozitë ku, nëse një person i dënuar deri në një vit kërkon konvertimin e dënimit me burgim në gjobë, gjykata duhet ta pranojë kërkesën.⁴⁶ Natyra detyruese e kësaj dispozite, që u kërkon gjyqtarëve të pranojnë kërkesën e personit të dënuar pa shqyrtuar themelin e ndryshimit të dënimit, ngre shqetësime. Vetëm KP-të e BeH-së dhe RS-së kufizojnë përdorimin e kësaj dispozite për disa vepra penale serioze, por veprat KOK nuk përfshihen në këto përjashtime.⁴⁷ Duke parë zbatimin e gjerë të dispozitave për uljen e dënimit, shpesh të dënuarit – edhe për çështje serioze KOK – kanë mundësinë të konvertojnë dënimin e burgimit në gjobë. Për veprat e motivuara nga

lakmia, që shpesh përfshijnë shuma të konsiderueshme të pretenduara dëmi ekonomik ose fitimi të paligjshëm, përdorimi i këtyre dispozitave mund të mos përmbushë qëllimin frenues, madje mund edhe të sjellë një mesazh për përfitim nga këto krime. Duke pasur parasysh sa më sipër, përdorimi dhe ndikimi i këtyre dispozitave në çështjet KOK duhet të vlerësohet më tej, me synim heqjen e kësaj mundësie në çështjet KOK të nivelit të lartë.

Dispozita për zëvendësimin e një dënimi me burgim në gjobë duket se përdoret gjerësisht. Grafiku më poshtë tregon dënimet kundër 63 shkelësve në çështjet përfundimtare që kanë marrë dënim me burgim ose dënim të

⁴⁶ Shih zëvendësimin e burgimit në KP BeH neni 42a; KP FBeH neni 43a; KP RRB BeH neni 43a dhe natyrën e jashtëzakonshme të dënimit me burgim afatshkurtër në KP RS neni 46(a)2.

⁴⁷ Shih zëvendësimin e burgimit në KP BeH neni 42a(4) dhe natyrën e jashtëzakonshme të dënimit me burgim afatshkurtër në KP RS neni 46(a)4.

pezulluar me burgim. Vetëm 18 për qind e autorëve kanë marrë dënim me burgim mbi 12 muaj, dhe afërsisht 38 për qind kanë marrë dënim deri në 12 muaj. Nga 25 autorët e dënuar deri në

12 muaj, në kohën e shkrimit, 19 kërkuan konvertimin në gjobë, që u dha në çdo rast, edhe kur nuk ishte e detyrueshme (shih Figurën 13).

Dënimet ndaj 63 autorëve

● Pezulluar ● 12 muaj ose më pak ● Mbi 12 muaj



Figura 13 - Dënimet ndaj 63 autorëve në çështjet përfundimtare të monitoruara dhe përdorimi i dispozitës.

Shumë nga dënimet e shqyrtuara nga Projekti nuk u referoheshin faktorëve të veçantë dhe nuk jepnin justifikim për dënimin e caktuar. Duke vërejtur më tej që burgimi deri në 12 muaj duhet të zëvendësohet me një gjobë nëse kërkohet nga i pandehuri, dënimet duken të lehta. Kështu, duke parë

tërësinë e këtyre rrethanave – arsyetimi i dobët dhe dhënia e shpeshtë e dënimeve të ulëta dhe të pezulluara – ka rrezik që dënimet të duken, ose mund të jenë vërtet, arbitrare, pasi u mungojnë elemente treguese të proporcionalitetit dhe faktorit frenues të dënimit.

Të sigurohet që marrëveshjet për pranimin e fajësisë të përdoren strategjikisht dhe drejt në çështjet KOK dhe, sipas rastit, të sigurohet që fitimi i paligjshëm, pagesa e dëmshpërblimit ndaj palëve të dëmtuara dhe/ose bashkëpunimi me të pandehurin të jetë pjesë e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë. Më në veçanti:

i. Kryeprokurorët e BeH-së, FBeH-së, RS-së dhe Rrethit Brčko (RRB) duhet të rivlerësojnë ndikimin e udhëzuesve për marrëveshjet për pranimin e fajësisë në çështjet KOK. Ky rivlerësim duhet të përfshijë një rishikim sasior dhe cilësor të vendimeve të dhëna nga marrëveshjet për pranimin e fajësisë në çështjet KOK. Udhëzuesit e rishikuar duhet të adresojnë shqyrtimin e brendshëm të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë dhe modaliteteve për bashkëpunimin e të pandehurve.

ii. Kryeprokurorët, zëvendëskryeprokurorët dhe prokurorët duhet të sigurojnë që marrëveshjet për pranimin e fajësisë të përdoren strategjikisht për të fituar bashkëpunimin e të pandehurve në lidhje me marrjen e informacioneve dhe provave, dhe duhet të kërkojnë konfiskimin e pasurive ose pagesën e dëmshpërblimit ndaj palës së dëmtuar, sipas rastit dhe mundësisë.

iii. Gjyqtarët duhet të sigurojnë që të respektohet prezumimi i pafajësisë së palëve të treta në vendimet e bazuara në marrëveshjet për pranimin e fajësisë.

iv. Ligjvënësit në BeH, FBeH, RS dhe RRB BeH, në bazë të qëndrimit të ekspertëve të pranuar në komunitetin juridik, duhet të miratojnë dispozita identike në KPP-të përkatëse që parashikojnë bashkëpunëtorin e drejtësisë.

v. Komuniteti i ekspertëve juridikë duhet të identifikojë një zgjidhje ligjvënëse për të parashikuar bashkëpunimin e të pandehurit në dispozitat përkatëse të KPP-së për marrëveshjet për pranimin e fajësisë, dhe të propozojë njohjen e saj nga të gjitha ministritë e drejtësisë.

Marrëveshjet për pranimin e fajësisë (MPF) përdoren gjerësisht në çështjet e monitoruara nga Projekti. Në BeH, MPF-të marrin formën e negocimit të dënimit; prokurorët dorëzojnë marrëveshjen në gjykatë për shqyrtim, duke çuar në një vendim penal, me mundësi apeli në rrethana të kufizuara.⁴⁸ Gjykata mund të refuzojë marrëveshjen por jo ta ndryshojë atë.⁴⁹ Në fund të vitit 2019, KLGJP-ja e BeH-së nxori udhëzues për të gjithë kryeprokurorët për të nxjerrë urdhra për kritere shtesë për MPF-të në çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe të tjera.⁵⁰ Udhëzuesi synon të sigurojë që prokurorët të mos propozojnë një dënim nën minimumin e përcaktuar me ligj, një dënim më të

lehtë ose një sanksion më të vogël se dy të tretat e sanksionit të pritshëm në procesin penal. Si përjashtim, nëse MPF-ja lejon zbulimin e veprave penale ose autorëve të tjerë, konfiskimin e pasurive ose pagesën e dëmshpërblimit ndaj palës së dëmtuar, prokurori mund të lidhë një MPF nën minimumin e parashikuar ligjor për veprën.

Figura e mëposhtme tregon rezultatet kundër 80 të pandehurve në lidhje me të gjitha çështjet e përfunduara të monitoruara nga Projekti, duke treguar që marrëveshjet për pranimin e fajësisë janë përdorur për të zgjidhur proceset për 69 për qind të të gjithë të pandehurve (shih Figurën 14).

Rezultatet në çështjet e monitoruara




Figura 14 - Rezultatet për 80 të pandehur në të gjitha çështjet e monitoruara nga korriku 2021 në mars 2024.

Pavarësisht se ka disa përjashtime, në shumë çështje të shqyrtuara, prokuroria nuk i përdori MPF-të për të konfiskuar pasuritë e paligjshme, për të paguar dëmshpërblimet ndaj palëve të dëmtuara ose për të fituar bashkëpunimin e rëndësishëm të të pandehurit në lidhje me zbulimin e aktiviteteve të tjera kriminale. Këto të

dhëna tregojnë një mosshfrytëzim strategjik të MPF-ve. Në veçanti, moskonfiskimi i fitimeve të paligjshme në vendimet e bazuara në MPF-të është i dukshëm; konfiskimi u urdhërua vetëm ndaj 33 për qind të të gjithë të pandehurve që nënshkruan MPF, kryesisht në çështjet e krimit të organizuar të nivelit të lartë (shih Fig.15).

⁴⁸ Shih MPF në KPP BeH neni 231; KPP FBeH neni 246; KPP RS neni 246; dhe KPP RRB BeH neni 231

⁴⁹ Shih MPF në KPP BeH neni 231(5); KPP FBeH neni 246(5); KPP RS neni 246(5); dhe KPP RRB BeH neni 231(5).

⁵⁰ Shih KLGJP-në e BeH-së, *Udhëzues për urdhrat për kritere shtesë për marrëveshjet për pranimin e fajësisë në çështjet e nivelit të lartë të korrupsionit, krimit të organizuar dhe të tjera*, 28 nëntor 2019.

Autorët e dënuar në çështjet me marrëveshje për pranim fajësie




Figura 15 - Konfiskimi i pasurive kundër 54 autorëve të dënuar në çështjet e zgjidhura nga marrëveshje për pranim fajësie të monitoruara nga Projekti

Sa i përket zgjidhjes së pretendimeve të dorëzuara nga palët e dëmtuara, vetëm një vendim i dhënë pas marrëveshjes për pranim fajësie e adresonte këtë pretendim. Gjykata urdhëroi anulimin e një transaksioni të paligjshëm prone që ishte pjesë e veprës penale. Një problematikë tjetër e vërejtur në lidhje me vendimet e bazuara në marrëveshjet për pranim fajësie lidhej me faktin që shumë vendime nuk ruanin prezumimin e pafajësisë së bashkautorëve të tjerë të pretenduar, veçanërisht në çështjet e krimit të organizuar. Veprat penale të

akuzuara, siç përshkruhen në kërkesën për gjykim, shpesh kopjohen fjalë për fjalë në çështjet e përfunduara pas marrëveshjes për pranim fajësie tejkalon një vit, që nuk është veçanërisht efikase për proceset e shkurtuara. Përdorimi i marrëveshjeve për pranim fajësie në procese siguron përfitimet e procesit të marrëveshjes për pranim fajësie, duke përfshirë efikasitetin, sigurimin e pasurive të paligjshme, zgjidhjen e pretendimeve për kompensim dhe bashkëpunimin e të pandehurit.

Përdorimi i Mjeteve Gjyqësore

10

Rekomandim

Të merren masa për të rritur përdorimin e hetimeve financiare, si dhe ngrirjen, konfiskimin dhe konfiskimin e zgjeruar të fitimeve të paligjshme. Më në veçanti:

i. KLGJP-ja e BeH-së dhe të gjithë kryeprokurorët duhet të jenë proaktivë në përcaktimin e modaliteteve për të përmirësuar qasjen në të dhënat financiare dhe të pronësisë të të dyshuarve/pandehurve, duke përfshirë personat juridikë, duke respektuar konfidencialitetin e proceseve dhe të drejtat e privatësisë. Institucionet përkatëse në të gjitha nivelet që mbajnë këto të dhëna duhet të përfshihen në këtë angazhim sipas fushëveprimit dhe autoritetit të tyre.

ii. KLGJP-ja e BeH-së, në bashkëpunim me ministritë përkatëse të drejtësisë dhe Komisioni Gjyqësor i RRB BeH-së, duhet të sigurojnë që prokuroritë të kenë burimet e nevojshme buxhetore për të punësuar ose pasur gatishmërinë e ekspertëve të posaçëm financiarë, sipas nevojës, për të ndjekur efektivisht çështjet që përfshijnë të dhëna të ndërlikuar financiare, pronësore dhe tregtare.

iii. Ministritë e drejtësisë dhe Komisioni Gjyqësor i RRB BeH-së duhet të:

- Rishikojnë dhe, sipas nevojës, të ndryshojnë të gjitha ligjet për ekspertët për të siguruar pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe ofruar sigurimin e nevojshëm të cilësisë.
- Sigurojnë që lista e ekspertëve të ofrojë ekspertizën e nevojshme në çështjet KOK.

iv. KLGJP-ja e BeH-së, bashkë me kryeprokurorët e BeH-së, FBeH-së, RS-së dhe RRB BeH-së, duhet të përmirësojnë urdhrat për kryerjen e hetimeve financiare për të adresuar aspekte të tjera financiare të krimeve, duke përfshirë ngrirjen dhe konfiskimin e fitimeve të paligjshme, dhe përdorimin e konfiskimit të zgjeruar.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare, kuadri ligjor i BeH-së parashikon një sërë masash për ngrirjen dhe konfiskimin e fitimeve të paligjshme, duke përfshirë urdhrat e përkohshëm ose masat e sigurimit për të ngrirë pasuritë,⁵¹ konfiskimin e fitimeve të paligjshme,⁵² dhe përdorimin e konfiskimit të zgjeruar.⁵³ Ligjet e posaçme në fuqi në FBeH, RS dhe RRB BeH e rregullojnë këtë gjithashtu.⁵⁴ Pavarësisht nga kuadri i mjaftueshëm ligjor dhe i politikave, këto mjete të rëndësishme mbeten në masë të madhe të pashfrytëzuara.

Është shënuar progres në lidhje me përmirësimin e rikuperimit të pasurive në lidhje me përmirësimin e mbledhjes së të dhënave në sistemin e menaxhimit të çështjeve të prokurorisë, si dhe në klasifikimin e një hetimi financiar si element i veçantë si për ruajtjen e të dhënave dhe si pjesë e kuotës vjetore të punës së prokurorit. Megjithatë, kjo nuk i zgjidh plotësisht problemet e lidhura me të. Konsultimet me grupet e interesit nxorën në pah sfida në marrjen e informacioneve konfidenciale financiare në kohë dhe në mënyrë të tillë që nuk rrezikon hetimin. Ndonëse është

Ndonëse është shënuar progres përmes nënshkrimit të memorandumëve të mirëkuptimit ndërmjet institucioneve përkatëse, duke lehtësuar qasjen në të dhëna, duhen më shumë hapa për të siguruar që prokurorët në të gjitha juridiksionet të kenë qasje të shpejtë në këto informacione në lidhje me të gjitha burimet përkatëse të të dhënave financiare, pronësore dhe tregtare.

Ekspertët dëshmitarë

Ndërsa ministritë përkatëse të drejtësisë dhe Komisioni Gjyqësor i RRB BeH-së mbajnë lista me numër të madh ekspertësh financiarë, zyrtarët gjyqësorë shprehën shqetësimin gjatë konsultimeve me Projektin për një mungesë ekspertësh të kualifikuar, vonesa në dorëzimin e gjetjeve dhe potencial për anshmëri nga ekspertët. Pa përmirësime në cilësinë e ekspertëve dëshmitarë ose procedurat për angazhimin e tyre, rezultatet e hetimit mund të mos çojnë në sigurimin real të dëshmive të ekspertëve gjatë gjykimit.

Udhëzues për hetimet financiare

Gjyqësori ka marrë hapa për të përmirësuar ngrirjen dhe konfiskimin e fitimeve të paligjshme. Në janar 2019,

⁵¹ Shih Urdhrat e Përkohshëm në KPP BeH nenet 202 dhe 395; KPP FBeH nenet 216 dhe 416; KPP RS nenet 112 dhe 389; dhe RRB BeH nenet 202 dhe 395.

⁵² Shih bazën e konfiskimit të produkteve të veprës penale dhe mjetet e konfiskimit të fitimeve materiale të përfuara përmes kryerjes së veprës penale, KP BeH nenet 110 dhe 111; KP FBeH nenet 114 dhe 115; KP RS nenet 83 dhe 84; dhe KP RRB BeH nenet 114 dhe 115.

⁵³ Shih konfiskimin e zgjeruar të fitimeve materiale të përfuara përmes kryerjes së një veprë penale në KP BeH neni 110(a); KP FBeH neni 114a; KP RRB BeH neni 114a dhe neni 28 Ligji për konfiskimin e produkteve të veprës penale RS.

⁵⁴ Shih Ligjin për konfiskimin e produkteve të veprës penale FBeH (Gazeta Zyrtare e FBeH-së nr. 71/14) dhe Ligjin për konfiskimin e produkteve të veprës penale RS (Gazeta Zyrtare e RS-së nr. 66/18) dhe Ligjin për konfiskimin e produkteve të veprës penale RRB BeH (Gazeta zyrtare e RRB BeH-së nr. 29/16).

KLGP-ja e BeH-së miratoi një udhëzues që u kërkonte kryeprokurorëve të nxirrnin urdhra që prokurorët të urdhëronin hetime financiare në çështjet e korrupsionit, krimin të organizuar dhe pastrimit të parave.⁵⁵

Ky udhëzues, që duhej në vijim të përfshihej në urdhrat e nxjerrë nga kryeprokurorët, kërkon që prokurori në detyrë të shqyrtojë hapjen e një hetimi financiar për një listë të veçantë veprash penale. Rrjedhimisht, pavarësisht se shërben si fillesë e dobishme, fusha e kufizuar e këtij udhëzuesi adreson vetëm një aspekt të një procesi të ndërlikuar. Për më tepër, si komponent i veçantë i procesit hetimor, hetimet

financiare u përkufizuan si një çështje e shkëputur në kuotën vjetore për prokurorët⁵⁶. Nomenklatura e re lejon që sistemi i menaxhimit të çështjeve të monitorojë përdorimin e hetimeve financiare dhe duhet të nxitë prokurorët të kryejnë hetime financiare, pasi ky veprim ndikon te kuota e tyre. Siç shihet në Figurën 16, megjithëse hetimet financiare janë rritur që nga viti 2018, përdorimi i këtyre mjeteve mbetet i parregullt, pasi numri i të pandehurve nën hetim ndryshon nga viti në vit. Pavarësisht kësaj, siç vërehet më sipër, përfshirja e hetimeve financiare në kuotën vjetore për prokurorët duket se shërben si stimul.

Hetimet financiare




Figura 16 -Hetimet financiare, për të pandehur dhe për çështje, 2018-2023. Burimi: KLGJP BeH, mars 2024.

⁵⁵ KLGJP BeH, *Raporti vjetor 2019* (Sarajevë: KLGJP BeH, 2019), f. 55, që i referohet miratimit të udhëzuesit që kryeprokurorët të nxjerrin urdhra që parashikojnë detyrimin për të kryer një hetim financiar kur kryhet një hetim në çështje të caktuara korrupsioni, krimi të organizuar dhe pastrimi parash.

⁵⁶ KLGJP BeH, *Rregullore për kuotat e performancës për prokurorët në prokuroritë e BeH-së* (Gazeta Zyrtare e BeH-së nr. 6/2022, 31 janar 2022), [Sluzbeni List- Pregled Dokumenta \(sluzbenilist.ba\)](https://sluzbenilist.ba).

Megjithatë, të dhënat për ngrirjen dhe konfiskimin e fitimeve të paligjshme ilustrojnë një pamje të paqartë (shih Figurën 17).

Konfiskimi i zgjeruar rrallëherë përdoret, ndërsa masat e sigurimit për ngrirjen e pasurive para vendimit të formës së prerë janë të kufizuara

Ngrirja, konfiskimi dhe konfiskimi i zgjeruar




Figura 17 - Ngrirja (masa sigurie), konfiskimi dhe konfiskimi i zgjeruar ne BeH, 2020 deri ne 2023. Burimi: HJPC i BeH, Mars 2024)

Këto gjetje përputhen edhe me rezultatet në çështjet e monitoruara nga Projekti. Ndër çështjet e përfunduara, vetëm 32 për qind e të

gjithë autorëve të dënuar ishin objekt i konfiskimit të pasurive, veçanërisht në çështjet e krimit të organizuar, dhe disa nga shumat ishin thjesht 100 marka (50 euro) (shih Figurat 18 dhe 19).

Konfiskimet

- Jo konfiskim i pasurive kundër autorëve të dënuar
- Konfiskimi i pasurive kundër autorëve të dënuar



Figura 18 - Konfiskimi i pasurive kundër autorëve të dënuar në të gjitha vendimet e dhëna, korrik 2021-mars 2024

Llojet e çështjeve me pasuri të konfiskuara




Figura 19 - Llojet e çështjeve me pasuri të konfiskuara, çështjet e monitoruara, korrik 2021-mars 2024.

Megjithëse kërkohet monitorim dhe analizë e mëtejshme e rezultateve të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive, të dhënat tregojnë rezultate të parregullta. Gjetjet e Projektit të monitorimit, siç përshkruhet më lart, tregojnë një nevojë për burime dhe ndërtim shtesë kapacitetesh për përforcimin e aftësive dhe ekspertizës në këtë fushë. Megjithëse janë hartuar materiale cilësore trajnimi dhe udhëzues të përgjithshëm për hetimet financiare dhe procedurat për ngrirjen

dhe konfiskimin e fitimeve të paligjshme,⁵⁷ nuk janë nxjerrë udhëzues që të jenë detyrues dhe më praktikë.⁵⁸

KLGP-ja e BeH-së është zotuar për të hartuar udhëzues në lidhje me përcaktimin e aspekteve financiare të veprave penale.⁵⁹ Kjo masë mund të zbatohet duke përditësuar dhe zgjeruar urdhrat ekzistues të nxjerrë nga kryeprokurorët për hetimet financiare në çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

⁵⁷ Shih Eldan Mujanović dhe Darko Datzer, bot., *Manual për Konfiskimin e Fitimeve të Paligjshme* (Sarajevë: Centar za istraživanje politike suprotstavljanja kriminalitetu, 2016) [Oduzimanje imovinske koristi pribavljene krivičnim djelom Prirucnik.pdf \(fazuoi.gov.ba\)](https://fazuoi.gov.ba); Qendra e Këshillimit për të Drejtat Individuale në Evropë (AIRE), *Priručnik o djelotvornom oduzimanju imovinske koristi pribavljene krivičnim djelom u skladu s evropskim i međunarodnim standardima* (Qendra AIRE, Inicijativa Rajonale Kundër Korrupsionit).

⁵⁸ Eldan Mujanović, bot., *Smjernice za postupanje nadležnih institucija u postupku za oduzimanje imovinske koristi pribavljene krivičnim djelom* (Sarajevë: Centar za istraživanje politike suprotstavljanja kriminalitetu, 2017).

⁵⁹ KLGP BeH, Agjenda e Reformës, Masa IV.1.13: Duhet të hartohen udhëzues të veçantë në lidhje me përcaktimin e aspekteve financiare të krimeve ... dhe përdorimin e rrethanave faktike për të provuar këto elemente.

VII. Kosova

Hyrje

Administrimi i drejtësisë i Kosovës në çështjet e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit ("KOK") tregon si progres edhe sfida. Zhvillimet pozitive përfshijnë miratimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026⁶⁰ dhe miratimin e Planit Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Çështjeve të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar 2022-2024.⁶¹ Për më tepër, nënshkrimi i një deklaratë të përbashkët ("Deklarata e Përbashkët e Zotimit") nga grupe kyçe interesi në mars 2023 theksoi angazhimin e tyre ndaj reformës së sistemit të drejtësisë dhe përforsimit të sundimit të ligjit⁶².

Ndërsa nënshkruesit duken vërtet të angazhuar për reformën gjyqësore, vazhdon të ketë mosmarrëveshje në lidhje me vetë ligjet që duhet të ndryshojnë, dhe përmbajtjen e nevojshme të ndryshimeve (duke përfshirë sistemin e kontrolleve të integritetit).

Megjithatë, sfidat e vazhdueshme ruajnë perceptimin e pandëshkueshmërisë dhe minojnë

besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Gjyqtarët dhe juristët kanë vështirësi në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të Kodit të Procedurës Penale ("KPP") dhe një numër i lartë çështjesh KOK vazhdojnë të kthehen për rigjykim. Kjo zgjat proceset dhe shteron burimet.

Ka një mungesë transparence dhe qasjeje në informacion publik. Ka një nevojë për sisteme të përmirësuara njoftimi për seancat gjyqësore dhe statistika më të sakta për funksionimin e sistemit të drejtësisë. Përgjigjet e parregullta ndaj kërkesave për informacion gjithashtu vazhdojnë. Ndërsa janë miratuar strategjitë e komunikimit, janë të nevojshëm urdhrat dhe mekanizmat e monitorimit për të siguruar efektivitetin e tyre. Gjithashtu, papajtueshmëritë në praktikën gjyqësore, mungesa e orientimit nga Gjykata Supreme, dhe platformat elektronike të kufizuara për të aksesuar vendimet cenojnë barazinë para ligjit.

⁶⁰ Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021–2026 është e disponueshme në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/8EF86336-E250-4EA2-9780-D4B8F7E853B5.pdf> [aksesuar më 21 mars 2024]

⁶¹ E disponueshme në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/KGJK_Plani_Strategjik_per_zgjidhjen_efikase_te_lendeve_te_korrupsionit_dhe_krimit_te_organizuar_2022_2024.pdf. [aksesuar më 21 mars 2024]

⁶² Ministria e Drejtësisë (MD), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryetari i Gjykatës Supreme ishin nënshkruesit fillestarë të "Deklaratës së Përbashkët të Zotimit" për reformën gjyqësore në mars 2023. Palët identifikuan objektiva kyçë për reformën gjyqësore në lidhje me përmirësimin e vlerësimeve të performancës të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kontrollet e integritetit, përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, dhe statusin dhe zhvillimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Problematika vazhdon edhe në lidhje me procedurat e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, të drejtat e të pandehurve dhe vonesat në përkthime, që ndikojnë në drejtësinë e proceseve. Efikasiteti i proceseve gjithashtu mbetet si problem, me një numër të lartë seancash të shtyra dhe joproductive dhe shtyrje të gjata, pjesërisht si pasojë e mungesës së afateve të qarta për caktimin e seancave të gjyqimit dhe rigjyqimit. Përdorimi i parregullt i Sistemit të Menaxhimit dhe Informacionit të Çështjeve ("CMIS") dhe mbështetja në dokumentet fizike gjithashtu vështirëson menaxhimin e çështjeve.

Cilësia e kërkesave për gjykim në çështjet KOK priret të jetë e ulët, duke çuar në shkallë të lartë lirimesh. Ekziston një theksim i kriterëve sasiore në vlerësimet e performancës për prokurorët dhe gjyqtarët, që mund t'i japë përparësi shpejtësisë dhe volumit mbi cilësinë për të përmbushur kërkesat e performancës.

Për më tepër, trajtimi joefektiv i çështjeve KOK përkeqësohet nga nivelet e ulëta të konfiskimit të pasurive. Pavarësisht pretendimeve për fitime të paligjshme të konsiderueshme në shumë çështje, konfiskimi është minimal, pjesërisht për shkak të një moskuptimi në radhët e institucioneve ligjzbatuese dhe prokurorëve për dobinë e hetimeve financiare efektive.

Për të trajtuar këto probleme sistemike, ky raport paraqet rekomandime që synojnë të përforcojnë kapacitetin e Kosovës për të ndjekur dhe gjykuar efektivisht çështjet KOK të nivelit të lartë, duke rritur integritetin dhe besueshmërinë e sistemit të drejtësisë.

Të përforcohet transparenca dhe qasja në informacion në çështjet KOK

i. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ("KGJK") duhet të sigurojë publikimin dhe përditësimin e rregullt të informacioneve të sakta dhe në kohë për çështjet KOK, duke përfshirë oraret dhe vendimet e gjykatave.

ii. KGJK-ja, Këshilli Prokurorial i Kosovës ("KPK"), gjyqtarët dhe prokurorët duhet të përmirësojnë komunikimin me shoqërinë civile duke iu përgjigjur shpejt, rregullisht dhe plotësisht kërkesave për informacion. Kjo duhet të përfshijë:

- mbajtjen e konferencave të rregullta për shtyp dhe adresimin e çështjeve me interes të lartë publik, veçanërisht ato të lidhura me çështjet KOK;
- monitorimin e zbatimit të strategjive përkatëse të komunikimit;
- nxjerrjen e urdhrave të parashikojnë standarde minimale për publikimin e informacionit për çështjet.

iii. KPK-ja duhet të ngrejë mekanizma për të siguruar një qasje të qëndrueshme ndaj publikimit të kërkesave për gjykim. Këta mekanizma duhet të përfshijnë garanci të mjaftueshme për të ruajtur të drejtat e privatësisë dhe për të mbrojtur të dhënat sensitive.

Monitorimi i çështjeve gjyqësore, si dhe konsultimet me median dhe shoqërinë civile, nxorën në pah probleme me aksesin e publikut në informacion, duke përfshirë mungesën e një sistemi të

besueshëm njoftimi për seancat gjyqësore,⁶³ publikimin e parregullt të vendimeve gjyqësore dhe përgjigjet e dobëta ndaj kërkesave të shoqërisë civile për informacion.⁶⁴

⁶³ Problematika në lidhje me sistemet e njoftimit përfshinte publikimin e orareve të seancave pa emrat e të pandehurve dhe zërat e pasaktë ose mungesën e tyre në platformë.

⁶⁴ Siç u përmend në një forum diskutimi me median dhe shoqërinë civile më 10 prill 2023.

Sigurimi i transparencës në procesin e drejtësisë, veçanërisht në çështjet KOK, kërkon një ekuilibër të kujdesshëm ndërmjet interesit të publikut në procese dhe mbrojtjes së informacioneve sensitive. Si rrjedhim, respektimi i kuadrit ligjor dhe standardeve etike për të shmangur cenimin e privatësisë apo paragjykimin e procesit është thelbësor dhe është e rëndësishme që të ketë strategji dhe orientime për gjykatat dhe prokuroritë për komunikimin me publikun.

Projekti vëzhgoi që në vitin 2023, kishte një përmirësim të dukshëm në publikimin e vendimeve nga Gjykata e Apelit, në krahasim me vitin 2021 dhe 2022. Megjithatë, janë identifikuar vonesa të vazhdueshme në publikimin e vendimeve nga Gjykatat Themelore.

Në nivel institucional, publikimi i rregulloreve, buxheteve, planeve, raporteve dhe statistikave, si dhe mbajtja e konferencave për shtyp,

përmirëson transparencën dhe llogaridhënien, dhe ndërton besimin e publikut. KGJK-ja dhe KPK-ja kanë strategji gjithëpërfshirëse komunikimi për të rritur transparencën dhe bashkëpunimin me median dhe shoqërinë civile.⁶⁵ Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme që këshillat të monitorojnë në mënyrë proaktive zbatimin e këtyre strategjive.

Udhëzuesi për Komunikimin me Median dhe Publikun për Gjykatat dhe Autoritetet e Prokurorisë i Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) ofron orientime të dobishme që mund të shërbejnë si tregues për aksesin në informacion.⁶⁶ Përdorimi i CMIS-it për mbledhjen e të dhënave është gjithashtu jetik dhe do të sigurojë që informacionet e besueshme dhe të përditësuara të jenë të disponueshme për publikun përmes "Pasqyrës së Performancës së Gjyqësorit".⁶⁷

⁶⁵ Strategjia e Këshillit Prokurorial për Komunikimin e Sistemit Prokurorial 2021 – 2023 e disponueshme në <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Dokumente%20Strategjike/Strategy%20for%20communication%20of%20the%20prosecutorial%20system%202021-2023.pdf> dhe Strategjia e Komunikimit e Këshillit Gjyqësor 2022 - 2024 e disponueshme në https://www.gjygesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/03/KGJK_Strategjia_Komunikimit_2022-2024.pdf. [të dyja aksesuar më 21 mars 2024].

⁶⁶ E disponueshme në <https://rm.coe.int/cepej-2018-15-en-communication-manual-with-media/16809025fe>. Për një referencë tjetër krahasuese shih udhëzuesin e Anglisë dhe Uellsit për qasjen e medias në gjykata, të disponueshme në <https://www.gov.uk/government/publications/guidance-to-staff-on-supporting-media-access-to-courts-and-tribunals/jurisdictional-guidance-to-support-media-access-to-courts-and-tribunals-criminal-courts-guide-accessible-version>. [aksesuar më 21 mars 2024].

⁶⁷ E disponueshme në: <https://www.gjygesori-rks.org/performance-dashboard/?lang=en> [aksesuar më 21 mars 2024].

Të rritet kapaciteti i gjykatave për të funksionuar efektivisht në të dyja gjuhët zyrtare

i. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të vlerësojnë nevojat e të gjitha gjykatave dhe prokurorive themelore dhe të përcaktojnë sa interpretë dhe përkthyes të caktojnë për secilën. Në këtë proces, ato duhet t'i japin përparësi shpërndarjes së burimeve për çështjet urgjente dhe të prapambetura.

ii. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të shqyrtojnë kriteret kualifikuese dhe nevojat e vazhdueshme të trajnimit për të siguruar që interpretët dhe përkthyesit të kenë aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të punuar efektivisht në sistemin e drejtësisë.

iii. Në kuadrin afatgjatë, KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të sigurojnë që kushtet e punësimit të jenë të përshtatshme për të lehtësuar rekrutimin dhe mbajtjen e interpretëve dhe përkthyesve profesionalë.

Interpretët dhe përkthyesit e trajnuar mirë janë thelbësorë për lehtësimin e pjesëmarrjes efektive në procese dhe realizimin e të drejtave gjuhësore të të pandehurve. Parimi reflektohet në Kushtetutë, KPP dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ"). Të gjitha këto parashikojnë të drejtën e ndihmës falas nga një interpret nëse i pandehuri nuk mund të kuptojë gjuhën e procesit.⁶⁸

Një nga problemet mbizotëruese në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë lidhet me përkthimin dhe interpretimin vazhdimisht të dobët. Projekti vëzhgoi probleme në të 15-ta çështjet e monitoruara ku kërkohej interpretim ose përkthim. Interpretët e caktuar nuk ishin të njohur me terminologjinë juridike ose kishin mangësi në aftësitë thelbësore të interpretimit.

⁶⁸ Shih: Kushtetuta, neni 30; KPP, neni 14; dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6. Për më tepër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka deklaruar që detyrimi për të ofruar interpretim "nuk kufizohet thjesht te caktimi i interpretit por edhe tek ushtrimi i një shkalle kontrolli mbi përshtatshmërinë e interpretimit". ECtHR, Cuscani v. the United Kingdom, 24 shtator 2002, e disponueshme në [https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:\[%22002-5182%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22002-5182%22]}). [aksesuar më 21 mars 2024].

Projekti vëzhgoi të paktën 25 raste vonesash për shkak të mungesës së interpretëve. Për më tepër, vonesat dhe çrregullimet e shkaktuara nga mungesa e pajisjeve për interpretim simultan në gjykata, ose problemet teknike me pajisjet ekzistuese u vërejtën në të paktën 28 raste.

Projekti vuri re vështirësi në sigurimin e përkthimit të kërkesave për gjykim dhe dosjeve të çështjes, duke sjellë vonesa nga dy në gjashtë muaj në pesë çështje KOK të nivelit të lartë.

Rregulloret e miratuara, kodi i etikës dhe manuali për interpretët dhe përkthyesit në KGJK janë zhvillime të mirëpritura që mund të adresojnë disa nga sfidat e lartpërmendura.⁶⁹ Megjithatë, gjatë konsultimeve, shpesh raportohej se pagat e ulëta përbëjnë barrierë për rekrutimin dhe mbajtjen e interpretëve dhe përkthyesve të kualifikuar. Kjo sugjeron një nevojë për masa për të krijuar një mjedis që tërheq dhe mban profesionistë të kualifikuar në fushën e interpretimit dhe përkthimit.

3

Rekomandim

Të sigurohet ndihmë juridike efektive për të pandehurit në të gjitha fazat e procesit penal

- i. KGJK-ja, KPK-ja dhe Oda e Avokatëve të Kosovës ("OAK") duhet të bashkëpunojnë për të nxjerrë urdhra, duke përfshirë afate kohore të detajuara, për të siguruar që mbrojtja të ketë akses te provat dhe materialet gjatë fazës së gjykimit paraprak në përputhje me KPP-në.
- ii. Gjykatat duhet të sigurojnë strukturat për konsultimet private ndërmjet avokatit dhe klientit para seancave dhe të lejojnë kohë të mjaftueshme për këto konsultime.
- iii. OAK-ja duhet të hartojë udhëzues për avokatët mbrojtës që përfshijnë standarde minimale për përgatitjen për çështjen, këshillimin dhe përfaqësimin.

⁶⁹ Më 21 qershor 2023, KGJK-ja miratoi dokumentet e mëposhtme: i) Rregullore nr. 07/2023 "Për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet, Shpërblimin dhe Disiplinimin e Përkthyesve dhe Interpretëve Gjyqësorë"; ii) Manualin për Punën e Përkthyesve dhe Interpretëve në Gjyqësorin e Kosovës; dhe iii) Kodin e Etikës për Përkthyesit Gjyqësorë dhe/ose Përkthyesit dhe Interpretët e Certifikuar dhe të Emëruar. Në kohën e hartimit, vetëm Rregullorja 07/2023 është e disponueshme në internet: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/29119_KGJK_Rregullore_07_2023_per_perkthyes_dhe_interpret_gjyqesore.pdf [aksesuar më 21 mars 2024]

iv. OAK-ja duhet të ngrejë një mekanizëm për adresimin e ankesave të marra nga gjykatat në lidhje me sjelljen e anëtarëve dhe të sigurojë që gjetjet disiplinore të jenë të disponueshme publikisht, duke ruajtur gjithashtu të drejtat e privatësisë.

Sipas KPP-së, mbrojtja ka të drejtën për të pasur një kopje të kërkesës për gjykim dhe për të rishikuar dosjen e çështjes para seancës fillestare.⁷⁰ Projekti vëzhgoi raste ku prokurori nuk i siguroi mbrojtjes akses te këto dokumente thelbësore. Si pasojë, seancat u shtynë në 16 çështje të monitoruara për shkak të nevojës për të siguruar kopje të kërkesës për gjykim dhe/ose dosjes së çështjes,⁷¹ duke sjellë zvarritje nga dy në 24 javë.⁷²

Në tetë çështje të monitoruara me shumë të pandehur, Projekti vëzhgoi hapësirë të kufizuar në sallën e gjyqit dhe mbërritja me vonesë e të pandehurve nga qendrat e paraburgimit pengoi aftësinë e avokatëve mbrojtës për t'u konsultuar me klientët e tyre.

Projekti vëzhgoi 24 çështje ku avokatët mbrojtës kryen një përfaqësim të dobët për shkak se ishin të papërgatitur. U vërejt se trupat gjykues në përgjithësi nuk ndërhyjnë në këto rrethana. Për të

të siguruar përfaqësim ligjor efektiv, gjykatat duhet të ushtrojnë mbikëqyrje duke përdorur kompetencat e përcaktuara në KPP. Megjithatë, konsultimet me gjyqtarët konfirmuan se e vetmja masë për adresimin e problematikës në lidhje me performancën e avokatëve mbrojtës privatë është raportimi i avokatëve tek OAK-ja për masa disiplinore. Kjo do të ishte e përshtatshme vetëm në raste të rënda. Megjithatë, ajo duhet të zbatohet kur është e nevojshme. Fatkeqësisht, gjyqtarët dhe prokurorët raportuan se OAK-ja rrallëherë u përgjigjet kërkesave për masa disiplinore dhe/ose ata nuk informoheshin për rezultatin e ankesave. Nëse rrethanat janë të tilla, kjo sugjeron një mungesë shqetësuese respekti ndaj kërkesave të gjykatave dhe mund të kontribuojë te një ndjenjë pandëshkueshmërie në radhët e avokatëve që nuk respektojnë standardet profesionale.

⁷⁰ KPP, neni 239, "Materialet të cilat i Jepen të Pandehurit me Ngritjen e Aktakuzës".

⁷¹ Dispozitat e këtij neni janë objekt i masave që mbrojnë palët e lënduara dhe dëshmitarët. Neni 239, para. 5 i KPP-së së miratuar së fundmi, parashikon: "Kur prokurori i shtetit nuk përmbush detyrimet nga paragrafit 1 i këtij neni, njoftohet kryeprokurori i zyrës."

⁷² Në dy raste, zvarritjet u përkeqësuan për shkak të nevojës për përkthimin e dosjes së çështjes.

Gjatë konsultimeve, KGJK-ja, KPK-ja dhe OAK-ja raportuan se nuk ka mekanizëm për zgjidhjen e këtij problemi, pasi nuk ka mbledhje të rregullta ose platforma për të diskutuar për problemet ndërmjet institucioneve.

OAK-ja duhet të shqyrtojë udhëzime më efektive për avokatët mbrojtës. Këto udhëzime duhet të përfshijnë standardet minimale për përgatitjen për

çështjen, këshillimin dhe përfaqësimin. Ky orientim do të ndihmojë në vendosjen e standardit për përfaqësimin gjatë mbrojtjes penale dhe do të caktonte një tregues për të përcaktuar se kur është e nevojshme ndërhyrja.

Zbatimi i udhëzimeve duhet të mbështetet përmes trajnimeve gjithëpërfshirëse për të përmirësuar nivelin e përfaqësimit.

4

Rekomandim

Të sigurohet zbatim i rregullt i ligjit në përputhje me standardet ndërkombëtare, veçanërisht ato të vendosura nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE).

i. Të inkurajohen gjykatat e ulëta për t'iu referuar praktikës gjyqësore të gjykatave të larta kur përballen me probleme interpretimi. Gjykata Supreme duhet të japë orientim për çështjet e vështira të interpretimit juridik.

ii. Të rritet numri i mbledhjeve ndërmjet gjyqtarëve nga shkallë të ndryshme gjyqësore dhe të hartohet një përmbledhje vendimesh të përzgjedhura për trajtimin e çështjeve KOK të ndërlikuara dhe të nivelit të lartë.

iii. KGJK-ja duhet të sigurojë publikimin e vendimeve, veçanërisht ato nga gjykatat e larta, në mënyrë të rregullt dhe relativisht të shpejtë.

Gjyqtarët raportuan marrëdhënie të pakënaqshme vertikale brenda sistemit gjyqësor. Në veçanti, ka mbledhje të pamjaftueshme ndërmjet gjyqtarëve nga Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit me gjyqtarët e gjykatave

themelore dhe degëve të tyre për të promovuar praktikën gjyqësore të mirë dhe të rregullt. Për më tepër, konsultimet treguan se gjykatat e ulëta shpesh hezitonin për të kërkuar

mendime juridike nga Gjykata Supreme.⁷³ Gjithashtu u raportua se gjyqtarët e shkallëve të ulëta nuk ishin proaktivë në kërkimin dhe zbatimin e jurisprudencës së gjykatave të larta. Kjo kufizon aftësinë e gjykatave të larta për të adresuar sfidat në interpretimin e ligjit dhe për të promovuar harmonizimin, duke çuar në shtimin e mospërputhjeve.

Në dhjetor 2023, Gjykata Supreme miratoi dy udhëzues. I pari, i titulluar “Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës”,⁷⁴ përmban një përmbledhje të vendimeve kyçe në fushën e çështjeve penale dhe civile me synim unifikimin e praktikës gjyqësore. I dyti, i titulluar “Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme në çështje penale dhe civile,”⁷⁵ ofron zgjidhje për sfidat me të cilat përballen gjyqtarët në çështjet penale dhe civile, duke përfshirë orientime në zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”). OSBE-ja i mirëpret këto publikime dhe do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e tyre. Inkurajohet miratimi i udhëzuesve të veçantë për adresimin e problemeve

sfiduese në çështjet KOK të ndërlikuara me shumë të pandehur. Pavarësisht volumit të ligjeve të reja që hyjnë në fuqi, duke përfshirë një Kod Penal (“KP”) të ri në vitin 2019 dhe KPP të ndryshuar në vitin 2023, Projekti vërejti një rënie në nxjerrjen e opinionëve nga Gjykata Supreme që prej vitit 2016.⁷⁶ Për më tepër, kur ka vendime gjyqësore, vendime nga KPK-ja, ose orientime të tjera që prekin praktikën gjyqësore, është thelbësore që këta gjyqtarë të informohen. Në këtë aspekt, përditësimet e rregullta profesionale ose njoftimet e natyrës paralajmëruese në CMIS mund të shërbejnë për të ndërgjegjësuar gjyqësorin ndaj zhvillimeve të rëndësishme profesionale.

Projekti gjithashtu vërejti që gjykatat rrallëherë i referohen jurisprudencës ekzistuese. Në fakt, në vetëm dy çështje të monitoruara Gjykata e Apelit iu referua praktikës gjyqësore – në të dyja çështjet, gjyqtarët cituan vendime të GJEDNJ-së.⁷⁷ Gjatë konsultimeve, disa gjyqtarë shprehën shqetësime për mundësinë e shfrytëzimit të pjesshëm të jurisprudencës për të favorizuar një

⁷³ Sipas nenit 26(1.4), Ligjit nr. 06/L-054 “Për gjykatat”, Gjykata Supreme “përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës”.

⁷⁴ E disponueshme në: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/26927_Permbledhje%20me%20vendime%20t%C3%AB%20p%C3%ABrzgjedhura%20t%C3%AB%20Gjykat%C3%ABs%20Supreme%202023.PDF [aksesuar më 21 mars 2024]

⁷⁵ E disponueshme në: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/76246_Permbledhje%20nga%20praktika%20e%20Gjykates%20Supreme,%20ne%20ceshtjet%20penale%20dhe%20civile%202023.pdf [aksesuar më 21 mars 2024]

⁷⁶ Në vitin 2016, Gjykata Supreme nxori 15 mendime juridike (me numra të ngjashëm në vitet e mëparshme). Megjithatë, nga viti 2017 në vitin 2023 janë nxjerrë gjithsej vetëm dhjetë mendime juridike. Shih, <https://supreme.gjyqesori-rks.org/mendimet-juridike/?cYear=2023>. [aksesuar më 21 mars 2024]

⁷⁷ Zbatueshmëria e jurisprudencës së GJEDNJ-së mund të jetë më e qartë pasi përcaktohet në nenin 53 të Kushtetutës, që parashikon: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

interpretim të preferuar. Kjo thekson nevojën për orientim të qartë se kur dhe si munden gjykatat t'i referohen në mënyrën e duhur jurisprudencës së gjykatave më të larta. Kërkohet një ndryshim i konsiderueshëm për të inkurajuar referencën ndaj jurisprudencës ekzistuese dhe për të qartësuar detyrimet e palëve në këtë aspekt. Kjo praktikë nuk duhet të konsiderohet si kërcënim ndaj

pavarësisë gjyqësore. Në fakt, ajo duhet parë si një mjet për të siguruar zbatimin e njësuar të ligjit. Janë marrë hapa të rëndësishëm për të rritur publikimin e vendimeve.⁷⁸ Në vitin 2023, shumica e vendimeve u publikua në faqen e internetit të KPK-së, duke mundësuar kërkimin e jurisprudencës.⁷⁹ Megjithatë, faqja e internetit mund të bëhet më praktike dhe tiparet e kërkimit duhet të rafinohen për të lejuar identifikimin e saktë të çështjeve.

5

Rekomandim

Të sigurohet paanshmëria e gjykatave dhe perceptimet rreth saj

i. Të ofrohen seanca praktike trajnimi për gjyqtarët rreth menaxhimit të seancave gjyqësore dhe kryerjes së proceseve në mënyrë profesionale dhe të paanshme në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në 15 çështje të monitoruara, Projekti vëzhgoi komente të papërshtatshme nga gjyqtarët dhe prokurorët që minuan perceptimin e paanshmërisë dhe të prezumimit të pafajësisë. Për shembull, në një çështje korrupsioni të nivelit të lartë, pasi një dëshmitar iu referua të pandehurit si “njeri i mirë”, një nga anëtarët e trupit gjykues u përgjigj: “Nëse i pandehuri është njeri i

mirë, atëherë pse mendoni se është akuzuar?” Pavarësisht se kjo deklaratë minoi perceptimin e paanshmërisë së gjykatës dhe cenoj prezumimin e pafajësisë së të pandehurit, mbrojtja nuk kërkoi përjashtimin e gjyqtarit.⁸⁰ Në një çështje tjetër korrupsioni të nivelit të lartë, pasi një dëshmitar bëri një koment pozitiv për karakterin e të pandehurit, kryetari i trupit gjykues tha:

⁷⁸ Sipas raportit të Lëvizjes FOL për monitorimin e publikimit të vendimeve gjyqësore (janar - dhjetor 2022), ka pasur një rritje të publikimit të vendimeve gjyqësore me 41% në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 (2021: 24.593 gjykime të publikuara; 2022: 34.694 të publikuara). KGJK-ja ka kërkuar më shumë angazhim në publikimin e vendimeve gjyqësore për të rritur nivelin e transparencës. Shih, <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2023/03/Monitorimi-i-publikimit-te-vendimeve-gjyqesore.pdf>. [aksesuar më 21 mars 2024]

⁷⁹ eKosova është një portal ku shërbimet publike ofrohen në internet. E disponueshme në <https://ekosova.rks-gov.net/Service/10> [aksesuar më 21 mars 2024]

⁸⁰ Neni 38(3), KPP, “[g]jyqtari gjithashtu mund të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rast konkret, nëse [...] paraqiten rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij.”

“Nuk po e varim”. I njëjti gjyqtar komentoi për shënimet që dëshmitari kishte shkruar për të ndihmuar memorien duke thënë: “Po, e dimë sa i përgatitur je”. Gjithashtu, gjatë marrjes në pyetje të këtij dëshmitari, që ishte paraburgosur më parë në lidhje me të njëjtën çështje, prokurori komentoi: “Është e pabesueshme që u lirove”.

Në shumicën e çështjeve me shumë të pandehur, trupat gjykues kishin vështirësi për të ruajtur rendin, shpesh duke marrë masa që mund të perceptoheshin si të anshme. Monitoruesit e çështjeve gjyqësore vëzhguan probleme si zbatimi jokohërent i rregullave për marrjen në pyetje të dëshmitarit, duke minuar më tej perceptimin e paanshmërisë.

Për shembull, në shumë çështje, gjyqtarët u lejuan palëve të rimarrin në pyetje dëshmitarët shumë herë, pavarësisht se KPP-ja lejon vetëm marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe rimarrjen në pyetje.⁸¹ Për më tepër, në të paktën 16 raste, gjyqtarët i refuzuan në tërësi propozimet dhe kundërshtimet e palëve pa dhënë justifikime të arsyetuara mirë.

Një pjesë e mirë e problematikës së vëzhguar lidhej me menaxhimin e dobët dhe/ose të papërshtatshëm të seancave gjyqësore. Akademia e Drejtësisë e Kosovës (ADK) duhet të ofrojë trajnime praktike dhe cilësore për prokurorët për teknikat e marrjes në pyetje, si dhe për gjyqtarët për ruajtjen e rendit dhe drejtimin e paanshëm. Kjo do të rritë cilësinë e drejtësisë së dhënë dhe besimin e publikut te gjyqësori.

Efikasiteti

6

Rekomandim

Të përmirësohet monitorimi i çështjeve për të identifikuar rrënjët e vonesave dhe për të ndjekur në mënyrë proaktive çështjet e gjata

i. KGJK-ja duhet të vendosë një mekanizëm për të raportuar çështjet që hasin zvarritje të gjata, për të identifikuar shkakun e zvarritjeve dhe për të përcaktuar masat korrigjuese.

⁸¹ KPP, nenet 328-331. Nuk ka dispozitë për dhënien e mundësisë palëve për të ribërë marrjen në pyetje të tërthortë dhe rimarrjen në pyetje. Për më tepër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar rëndësinë e paanshmërisë për qasje të drejtë në drejtësi në *García Ruiz kundër Spanjës*, 24 janar 1999, e disponueshme në: [GARCÍA RUIZ v. SPAIN \(coe.int\)](#), *Piersack kundër Belgjikës*, 01 tetor 1982, e disponueshme në [PIERSACK v. BELGIUM \(coe.int\)](#), dhe *Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 25 shkurt 1997, e disponueshme në: [FINDLAY v. THE UNITED KINGDOM \(coe.int\)](#). [të gjitha të aksesuara më 25 mars 2024]

ii. KGJK-ja duhet të rishikojë rregullat dhe rregulloret e brendshme që prekin progresin e çështjeve. Kjo duhet të përfshijë vlerësimin e zbatimit praktik të rregullave për promovimin, daljen në pension dhe riemërimin për të siguruar që disponueshmëria e juristëve të mos vonojë proceset.

Që prej korrikut 2021, OSBE-ja monitoroi 16 çështje që janë përfunduar. Kohëzgjatja e proceseve, nga dorëzimi i kërkesës për gjykim te nxjerrja e vendimit të formës së prerë,

varionte nga një në 120 muaj. Në mënyrë të veçantë, 12 çështje (75 për qind) zgjatën më shumë se 24 muaj deri në vendimin e formës së prerë.

Kohëzgjatja e proceseve nga kërkesa për gjykim te vendimi i formës së prerë në muaj




Figura 20 - Kohëzgjatja e proceseve nga kërkesa për gjykim te vendimi i formës së prerë në muaj

Seancat joproductive u konstatuan si arsyeja kryesore për zvarritjen e proceseve në çështjet KOK të nivelit të lartë dhe të mesëm. Gjithsej, 30 për qind e të gjitha seancave të monitoruara ose ishin joproductive ose

të ricaktuara në një datë tjetër.⁸² Është kritike të theksohet se, duke parë grafikun më poshtë, progresi sa i përket efikasitetit të proceseve gjyqësore, ndjek një ritëm sporadik dhe të paparashikueshëm.

⁸² Seancat përkufizohen si "joproductive" nëse nuk ndodh asgjë e vlefshme gjatë seancës dhe/ose çështja nuk përparon. Seancat përshkruhen si të ricaktuara kur data e seancës ndryshohet paraprakisht dhe palët informohen, duke shmangur nevojën për t'u paraqitur në gjykatë.

Seancat produktive dhe joproductive dhe të ricaktuara gjatë fazës së monitorimit




Figura 21 - Seancat produktive dhe joproductive dhe të ricaktuara

Arsyeja më e zakonshme për seancat joproductive ishte mungesa e një ose më shumë prej palëve, d.m.th. mungesa e të pandehurit, dëshmitarit, avokatit

mbrojtës ose prokurorit. Ky ishte shkaku kryesor në 88 nga 126 seanca joproductive (70 për qind).

Arsyet e seancave joproductive




Figura 22 - Arsytet e Seancave Joproductive

Çështjet me tri seanca ose çështje joproduktive të njëpasnjëshme për më shumë se tre muaj duhet të ndiqen nga një mekanizëm për masa analizimi dhe korrigjimi.

Një faktor tjetër që shkakton zvarritje është përdorimi i rigjyimit. Për shembull, monitoruesit vëzhguan një çështje ku Gjykata e Apelit i hodhi poshtë dënimet e të pandehurve në Gjykatën Themelore (shkalla e parë) në tre raste të ndara dhe e ktheu çështjen për rigjykim në çdo rast. Në rigjykimin e tretë, Gjykata Themelore i deklaroi të pandehurit të pafajshëm.⁸³ Nuk ka afat për fillimin e një rigjykimi pasi një çështje është kthyer nga Gjykata e Apelit, si dhe asnjë kufizim se sa herë mund të kthehet një çështje për rigjykim.

Gjatë konsultimeve, gjyqtarët shprehën shqetësime për mbingarkesën e punës, veçanërisht në Departamentin Special

në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Caktimi i tre gjyqtarëve shtesë në këtë departament ishte një zhvillim pozitiv. Megjithatë, janë hapur edhe dy vende vakante që atëherë.⁸⁴ Prokuroria Speciale (PSRK) do të rekrutojë edhe nëntë prokurorë në vitin 2024.⁸⁵ Megjithatë, që kjo të përmirësojë efikasitetin, duhet të ketë gjyqtarë të mjaftueshëm në Departamentin Special.

Gjyqtarët gjithashtu u ankuan që mungesa e zyrtarëve juridikë dhe personelit administrativ sjell pengesa për trajtimin më efektiv të çështjeve. Shumë gjyqtarë nuk kanë këshilltarë ligjorë apo trajnues për të mbështetur punën e tyre. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të sigurojnë vlerësimin e vazhdueshëm të nevojave të gjykatave dhe departamenteve të ndryshme, duke marrë parasysh jo vetëm numrat e çështjeve por edhe natyrën dhe kompleksitetin e tyre.

⁸³ Kërkesa për gjykim u dorëzuar në vitin 2014. Vendimet e Gjykatës Themelore u dhanë në vitet 2017, 2018 dhe 2020 me disa ose çdo të pandehur të dënuar. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës Themelore në vitin 2023 liroi të gjithë të pandehurit.

⁸⁴ Për shkak të vdekjes së një gjyqtari dhe daljes në pension të një gjyqtari tjetër. Për më tepër, Projekti është informuar që një gjyqtar i tretë i Departamentit Special do të dalë në pension në korrik 2024.

⁸⁵ Që prej vitit 2019, Departamenti Special ka pasur juridiksion mbi të gjitha çështjet e ndjekura nga PSRK-ja.

Të përmirësohen praktikat në lidhje me përdorimin e marrëveshjeve të rregullta dhe të negociuara për pranimin e fajësisë

- i. Të inkurajohen gjyqtarët dhe prokurorët për të përdorur marrëveshjet e rregullta dhe të negociuara për pranimin e fajësisë në çështjet e përshtatshme.
- ii. Zyra e Kryeprokurorit duhet të përditësojë Udhëzimin për Marrëveshjet e Negociuara për Pranimin e Fajësisë dhe të monitorojë zbatimin e tij.
- iii. Gjykata Supreme duhet të hartojë udhëzues për marrëveshjet për pranimin e fajësisë, duke përfshirë rastet kur gjykatat duhet të pranojnë një marrëveshje për pranim fajësie dhe qasjen e saktë ndaj masës së dënimit.

Marrëveshjet për pranimin e fajësisë, si të negociuara edhe të rregullta, dhe të vullnetshme, kursejnë burimet e kufizuara gjyqësore. Në çështjet ku provat janë të mjaftueshme dhe i pandehuri pranon përgjegjësinë vullnetarisht, marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të japin një zgjidhje efektive ndaj çështjes, duke ndihmuar në efikasitetin e menaxhimit të çështjeve dhe përdorimit të burimeve, veçanërisht në çështjet KOK të ndërlikuara.⁸⁶

Në Kosovë, Projekti vëzhgoi një përdorim të ulët të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë (konfirmuar nga grupet e interesit), veçanërisht në çështjet e nivelit të lartë.

Legjislacioni i Kosovës lejon lehtësimin e dënimeve pas një marrëveshjeje për pranim fajësie.⁸⁷ Kjo është e përshtatshme duke pasur parasysh se pranimi i përgjegjësisë dhe pasojave për administrimin efikas të drejtësisë janë faktorë lehtësues të rëndësishëm.

⁸⁶ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar sugjeron që dënimi mund të lehtësohet kundër personave "të cilët ofrojnë një bashkëpunim të mirëfilltë në hetimin ose ndjekjen" e veprave penale të krimit të organizuar dhe të lidhura. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, neni 26(2). GJEDNJ-ja ka konfirmuar që "negocimi për pranimin e fajësisë" nuk shkel në vetvete të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe mund të kontribuojë në procese efikase, ulje të ngarkesës së punës në gjyqësor, dhe shërben si "një mjet i suksesshëm në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar". Natsvlishvili and Togonidze v. Georgia, No. 9043/05, 29 prill 2014, paragrafi 90.

⁸⁷ 2023 KPP, neni 230

Megjithatë, masa e dënimit duhet të mbetet proporcionale dhe nuk duhet të lejojë pandëshkueshmërinë. Të drejtat e

të pandehurve, duke përfshirë aksesin në këshillim juridik efektiv duke përvijuar të gjitha pasojat e një deklarimi si fajtor, duhet të mbrohen.

Në katër çështje të monitoruara, të pandehurit shprehën qëllimin për të pranuar fajësinë. Megjithatë, gjykata i refuzoi pranimet e tyre të fajësisë. Në dy çështje, pranimet e fajësisë u refuzuan sepse të bashkëpandehurit po e kundërshtonin çështjen, dhe gjykata arsyetoi se ata, si pasojë, duhet të gjykohen të gjithë.⁸⁸

Në dy çështjet e tjera, gjykata gjeti që baza për pranimin e fajësisë nuk përputhej me faktet e pretenduara.⁸⁹ Këto fakte ilustronë disa nga sfidat për gjykatat në interpretimin e dispozitave për marrëveshjet e pranimin të fajësisë si të negociuara (MPFN) edhe të rregullta.

Në vitin 2021, Zyra e Kryeprokurorit nxori një udhëzim për përdorimin e MPFN-ve.⁹⁰

Vërehet se mospajtimi me udhëzimet konsiderohet si shkelje e Kodit të Etikës të Prokurorëve.⁹¹

Megjithatë, udhëzimi duhet të përditësohet për të reflektuar ndryshimet e fundit ligjore dhe për të monitoruar zbatimin, veçanërisht dispozitat për konfiskimin dhe kompensimin pas një MPFN-je.

Udhëzues të ngjashëm nga Gjykata Supreme mund të ndihmonin për të harmonizuar praktikën gjyqësore në këtë fushë.

Në tre vendime në bazë të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë,⁹² gjykata nuk ruajti prezumimin e pafajësisë për të bashkëpandehurit që nuk kishin lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë. Në këto vendime, çështja e prokurorisë u kopjua në vendim pa përjashtuar referencën ndaj të pandehurve që vazhduan të kundërshtonin akuzat. GJEDNJ-ja ka deklaruar se vendimet e dhëna në bazë të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë duhet të garantojnë prezumimin e pafajësisë për bashkëpunëtorët e tjerë të akuzuar.⁹³

⁸⁸ Në të dyja çështjet veprat penale akuzohej se ishin kryer “në bashkëpunim”.

⁸⁹ KPP, neni 242 (2.3)

⁹⁰ Udhëzuesi përcakton procedura në lidhje me MPFN-të, duke përfshirë: përmbajtjen e marrëveshjes, stimujt, të pandehurit bashkëpunues dhe detyrat në lidhje me konfiskimin dhe kompensimin. E disponueshme në: https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/Udhezim%20nr.%20160_2021%20per%20Negoci m%20e%20marreveshjes%20mbi%20pranimin%20e%20fajesise.pdf. [aksesuar më 21 mars 2024]

⁹¹ E disponueshme në https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/ANKodet/2019_02_08_082355_Shqip.pdf [aksesuar më 21 mars 2024]

⁹² Të gjitha çështjet e korrupsionit.

⁹³ Mucha v. Slovakia, no. 63703/19, 25 nëntor 2021, paragrafi 66. Në veçanti, GJEDNJ-ja ka deklaruar se “vendimet gjyqësore duhet të formulohen në mënyrë që të shmangin çdo paragjykim të mundshëm për fajësinë e palës së tretë në mënyrë që të mos cenohet shqyrtimi i drejtë i akuzave në proceset e ndara.”

Të sigurohet menaxhimi efektiv i çështjeve KOK

- i. KGJK-ja dhe Gjykata Supreme duhet të hartojnë udhëzues për menaxhimin e çështjeve gjyqësore. Udhëzuesit duhet të përcaktojnë përdorimin e përshtatshëm të sanksioneve dhe masave të tjera për të siguruar praninë e palëve në seanca.
- ii. KGJK-ja dhe Gjykata Supreme duhet të inkurajojnë seancat për menaxhimin e çështjes në çështjet serioze/të ndërlikuara për të lejuar:
 - Vendosjen e afateve realiste për çështjen.
 - Identifikimin e çështjeve faktike dhe juridike të pranuar dhe të kundërshtuara.
 - Identifikimin e provave të pranuar dhe të kundërshtuara.
 - Urdhrrat për zbardhjen e provave.
 - Identifikimin e nevojës për provat e ekspertëve.
- iii. KGJK-ja duhet të zhvillojë dhe promovojë më tej përdorimin e thirrjeve elektronike dhe njoftimeve online për të informuar palët për datat e seancave.

Gjatë konsultimeve, ka pasur mbështetje të përgjithshme për hartimin e udhëzuesve për menaxhimin e çështjeve dhe përdorimin e seancave paraprake për menaxhimin aktiv të çështjeve. Këta udhëzues duhet të ndjekin legjislacionin kryesor dhe të lejojnë autoritetin gjyqësor sipas rastit. Por ata duhet gjithashtu të përmbajnë tregues të qartë për standardet e pritshme se si duhet të përparojnë çështjet.

KGJK-ja duhet të marrë parasysh hartimin dhe pilotimin e formularëve të menaxhimit të çështjeve.⁹⁴ Udhëzuesit e lartpërmendur duhet të adresojnë përdorimin e përshtatshëm të sanksioneve dhe masave procedurale për të siguruar praninë e palëve në seanca. Legjislacioni i Kosovës u jep gjyqtarëve autoritetin për të marrë masa ndëshkuese ose disiplinore, por gjyqtarët i zbatojnë rrallë këto masa në

⁹⁴ Shembuj të mirë të formularëve të menaxhimit të çështjeve të përdorur në Angli dhe Uells gjenden në: [cm001eng.docx \(live.com\)](#); [cm001eng.docx \(live.com\)](#); [cm001eng.docx \(live.com\)](#); [PTPH 1_defendant.docx \(live.com\)](#); me formularë të tjerë të disponueshëm në: [Criminal Procedure Rules: Forms - GOV.UK \(www.gov.uk\)](#) [aksesuar më 21 mars 2024]

seancat e monitoruara. Gjyqtarët shpesh citojnë një mungesë udhëzimesh të qarta për zbatimin e sanksioneve për moszbatimin e këtyre masave ndëshkuese, duke theksuar nevojën për orientim në këtë çështje.

KGJK-ja duhet të hartojë më tej databazat ekzistuese dhe të promovojë digjitalizimin, duke përfshirë zhvillimin e një sistemi njoftimi për të informuar palët dhe publikun për oraret e çështjeve.⁹⁵

Hapat drejt realizimit të këtij rekomandimi duhet të përfshijnë:

i. Zbatimin e një sistemi digjital njoftimi për të dërguar posta elektronike ose mesazhe SMS automatike të palët, duke u dhënë atyre përditësime të shpejta për datat e çështjeve dhe ndryshimet e orareve.

ii. Sigurimin që faqet e internetit të gjykatave të mirëmbahen dhe të përditësohen çdo ditë me oraret e seancave dhe ndryshimet e tyre.

iii. Vazhdimin e zhvillimit dhe promovimit të CMIS-it për të centralizuar informacionet për çështjet, lehtësuar komunikimin dhe për të dhënë akses te dokumentet përkatëse.

iv. Ofrimin e trajnimeve të rregullta për personelin gjyqësor për shfrytëzimin efektiv të teknologjive përkatëse dhe rëndësinë e sistemeve të njoftimit në kohën e duhur.

Këto masa do të përmirësojnë efikasitetin e proceseve gjyqësore, mbajnë palët të informuara dhe zgjerojnë aksesin e publikut në informacion.

Në qershor 2023, KGJK-ja miratoi “Planin e Punës të Departamentit Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë për vitin 2023” (PP). Në shkurt 2024, plani u përditësua dhe rinovua. Objektivi i PP-së është të rritë efikasitetin dhe dhënien e përparësisë për çështjet në Departamentin Special. Miratimi i PP-së është për t’u vlerësuar dhe inkurajohet hartimi i PP-ve të ngjashme për departamentet e tjera gjyqësore.

⁹⁵ Projekti Rajonal për Monitorimin e Çështjeve Gjyqësore “Lufta kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Ballkanin Perëndimor”, Raport i Ndërmjetëm Gjetjesh dhe Rekomandimesh, Viti i rishikimit korrik 2021–qershor 2022, faqe 42

Të sigurohet zbatimi i dispozitave në KPP-në e re me synim uljen e vonesave.

- i. Gjykata Supreme duhet të nxjerrë udhëzues për interpretimin e duhur të ndryshimeve ndaj dispozitave për rigjykimet në nenin 402, KPP.
- ii. KGJK-ja duhet të marrë parasysh të analizojë përdorimin e vazhdueshëm të rigjykimeve në çështjet KOK.
- iii. Gjykata Supreme duhet të nxjerrë udhëzues për dispozitat e reja në mungesë në nenin 303, KPP.
- iv. OAK-ja duhet të nxjerrë udhëzues për rolin e avokatëve mbrojtës gjatë proceseve në mungesë dhe të japë trajnime për anëtarët mbi këto dispozita.

Në datën 17 Shkurt 2023 hyri në fuqi një KPP e ndryshuar, duke sjellë shumë ndryshime që synonin të adresonin mangësitë në proceset penale.⁹⁶ Këto përfshinin parashikimin e gjyqeve në mungesë në lidhje me veprat penale dhe miratimin e një kontrolli më të rreptë për kthimin e çështjeve nga Gjykata e Apelit për rigjykim. Pavarësisht se kishte një periudhë gjashtëmujore nga botimi i KPP-së së re deri në hyrjen e saj në fuqi, Projekti ka vëzhguar se ka ende keqkuptime të konsiderueshme të dispozitave të reja dhe të ndryshuara. Mund të argumentohet se nuk u zbatuan trajnime të mjaftueshme dhe

gjithëpërfshirëse për juristët gjatë periudhës kalimtare dhe kjo ka çuar në probleme zbatimi.

Gjatë pesë seancave të monitoruara, gjyqtarët sugjeruan të procedohej me të pandehurit në mungesë, por mbrojtja kundërshtoi me sukses sepse nuk kishte marrë trajnimet e duhura. Gjithashtu, rekomandohet që OAK-ja të marrë parasysh nxjerrjen e orientimeve për proceset në mungesë për avokatët mbrojtës. Orientimet duhet të përforcohen përmes trajnimeve praktike. Kjo është e rëndësishme pasi dispozitat krijojnë sfida të veçanta etike dhe juridike për avokatët mbrojtës.

⁹⁶ Gazeta Zyrtare, e disponueshme në <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61759> [aksesuar më 21 mars 2024]

Është identifikuar nga Projekti një mbështetje e tepërt të rigjykimet si shkak kyç i zvarritjeve në gjykimin e çështjeve. Për të adresuar këtë çështje, KPP-ja e vitit 2023 parashikon një kontroll më të rreptë për kthimin e çështjeve për rigjykim. Sipas KPP-së së re, rigjykimet janë të lejueshme vetëm në “rrethana të jashtëzakonshme”, dhe Gjykata e Apelit është e detyruar të përfshijë në vendim arsyet për mosndryshimin e vendimit në vend të rigjykimit.⁹⁷ Megjithatë, “rrethanat e jashtëzakonshme” nuk përcaktohen, dhe ka hapësirë për interpretime të ndryshme. Duhet të jepen orientime për

të siguruar që gjykatat të sjellin një efekt nga këto dispozita.

Aktualisht, rigjykimet kryhen nga i njëjti trup gjykues që gjykoi çështjen në shkallën e parë. Mund të argumentohet që Gjykata Supreme duhet të marrë parasysh edhe këtë praktikë dhe të përfshijë një mendim për përbërjen e përshtatshme të trupave gjykues për rigjykimet.

Duke parë rëndësinë e KPP-së për përmirësimin e drejtësisë penale, rekomandohet që Ministria e Drejtësisë të marrë pjesë në një “vlerësim ex-post” të zbatimit të ligjit të ri.⁹⁸

Kapaciteti

10

Rekomandim

Të përmirësohet standardi i kërkesave për gjykim dhe akteve të tjera juridike.

i. Zyra e Kryeprokurorit duhet të përmirësojë mekanizmat e brendshëm për rishikimin e kërkesave për gjykim përpara përfundimit, duke siguruar njëkohësisht një ekuilibër të përshtatshëm midis autonomisë së prokurorit dhe autoritetit të epriorit për të dhënë urdhra në raste të veçanta.

⁹⁷ Neni 402, Kodi i Procedurës Penale 2013 ... parashikon: “1. Gjykata e Apelit, në raste të caktuara me aktvendim anulon aktgjykimin e gjykatës themelore dhe çështjen e kthen në rigjykim [...]”. Sipas nenit 402, Kodi i Procedurës Penale 2023, kjo është zëvendësuar me “1. Gjykata e Apelit, në raste të jashtëzakonshme me aktvendim anulon aktgjykimin e gjykatës themelore dhe çështjen e kthen në rigjykim [...]”. Për më tepër, sipas Kodit të vitit 2023, paragrafi 2 “[a]ktvendimi duhet të përmbajë në mënyrë të qartë arsyet dhe bazat për të cilat Gjykata e Apelit nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të këtij Kodi”.

⁹⁸ I disponueshëm në: “Manual për Vlerësimin Ex-Post të Akteve Juridike”; i disponueshëm në <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/07/Manual-on-Ex-Post-Evaluation-of-Legal-Acts.pdf> [aksesuar më 21 mars 2024]

- ii. Zyra e Kryeprokurorit duhet të zhvillojë një mekanizëm për të siguruar rishikimin e brendshëm të çështjeve KOK që çojnë në lirime ose kur kërkesat për gjykim pushohen/refuzohen.
- iii. Akademia e Drejtësisë e Kosovës ("ADK") duhet të rritë numrin e trajnimeve të posaçme për prokurorët dhe gjyqtarët për të përmirësuar cilësinë e kërkesave për gjykim në çështjet KOK.

Janë vëzhguar mangësi në shumicën e kërkesave për gjykim të dorëzuara në çështjet e monitoruara. Problematika e zakonshme përfshin stilin e hartimit, akuzat e pambështetura, rrethanat faktike të paqarta, shpjegimin e pamjaftueshëm të rëndësisë së provës dhe përsëritjen fjalë për fjalë të dëshmive. Kërkesat për gjykim gjithashtu shpesh nuk kanë të dhëna për fitimin ose dëmin ekonomik dhe nuk kërkojnë konfiskimin e pasurive. Veçanërisht në çështjet e krimit të organizuar, kërkesat për gjykim shpesh nuk përshkruanin elementet e veprës së ngarkuar në përputhje me Kodin Penal Pavarësisht këtyre mangësive, në shumicën e rasteve, gjyqtarët nuk i pushonin akuzat ose nuk kërkonin ndryshime të kërkesave për gjykim.⁹⁹

Gjatë forumeve të diskutimit dhe konsultimeve, kishte mosmarrëveshje për rolin e gjyqësorit në rishikimin e kërkesave për gjykim – dhe veçanërisht në kompetencën e tyre për ta bërë këtë kur nuk kërkohej nga palët duke parë

natyrën mjaft konfliktuale të sistemit gjyqësor në Kosovë. Shumë gjyqtarë raportojnë se ata preferojnë të mbështeteshin në kërkesat e mbrojtjes për të pushuar kërkesën për gjykim, pasi u druhashin akuzave për anshmëri. Vlen të vërehet se në secilën prej 52 çështjeve të monitoruara, mbrojtja bëri kërkesë për të pushuar kërkesën për gjykim.¹⁰⁰ Megjithatë, asnjë nga këto kërkesa nuk ishte e suksesshme.

Në një çështje korrupsioni të nivelit të lartë, pika e ekzekutimit të kërkesës për gjykim nuk përmendte fare njërin prej të pandehurve. Në këtë rast, gjykata e ktheu kërkesën për gjykim te prokurori dhe kërkoi ndryshim. Kjo kontribuoi në administrimin efikas të drejtësisë dhe rrjedhimisht u theksua si praktikë e mirë.

Në përpjekjen për të identifikuar shkakun e aftësive hartuese të pamjaftueshme, konsultimet zbuluan se prokurorët ndonjëherë përqendrohen te rezultatet sasiore në vend të atyre

⁹⁹ Neni 235(4), KPP

¹⁰⁰ Në disa raste, refuzimi i këtyre praktikave u ankimua (pa sukses). Fakti që një numër kaq i madh sfidash i bëhen mjaftueshmërisë së kërkesave për gjykim ka implikime të rëndësishme për burimet e gjykatës dhe menaxhimin efikas të çështjeve.

cilësore; d.m.th. përqendrohen te numri i kërkesave të dorëzuara në vend të standardit të tyre. Kjo mund të vijë si pasojë e vënies së theksit te treguesit sasiorë nga vlerësimet e performancës së prokurorëve.

Një çështje tjetër e identifikuar është që kërkesat për gjykim shpesh nuk kanë informacionet kyçe. Kjo mund të tregojë një nevojë që prokurorët të jenë më proaktivë në mbikëqyrjen e hetimeve të autoriteteve ligjzbatuese për të siguruar që të jenë mbledhur të gjitha provat përkatëse para se kërkesa për gjykim të dorëzohet.

Mangësitë e vëzhguara në kërkesat për gjykim kontribuuan në lirimin e të pandehurve në të paktën katër çështje të monitoruara. Si pasojë, duhet të bëhen përpjekje për të rritur cilësinë e kërkesave për gjykim sa i përket përmbajtjes dhe hartimit. Duke njohur faktin që prokurorët marrin trajnim për hartimin e kërkesave për gjykim, gjatë programit fillestar të trajnimit dhe zhvillimit profesional të mëtejshëm¹⁰¹, rekomandohet që të ngrihet një mekanizëm i brendshëm rishikimi efektiv për të:

- Ruajturi autonominë vendimmarrëse të prokurorit ndërkohë që sigurohet koherenca, llogaridhënia dhe respektimi i standardeve ligjore përmes një sistemi mbikëqyrës.
- Promovuar vendimmarrjen koherente dhe për t'u mbrojtur nga

anshmëritë ose konfliktet e interesit, duke nxitur një sistem drejtësie të drejtë dhe të paanshëm.

- Pajisur prokurorët me ekspertizë dhe orientim nga eprorët.
- Lejuar identifikimin e hershëm të gabimeve, mosveprimeve ose dobësive duke rritur cilësinë e ndjekjeve penale.

Nuk ekziston një standard i përbashkët në Evropë. Në disa juridiksione, prokurorët me më shumë vjetërsi kanë autoritet të gjerë për të mbikëqyrur punën e kolegëve më të rinj. Në juridiksione të tjera, i jepet përparësi autoritetit të prokurorëve individualë. Megjithatë, përgjithësisht pranohet që kur prokurorët e vjetër kanë autoritet të gjerë për të ndërhyrë në çështje, kërkojnë kontrollë për të siguruar që ky autoritet të mos shpërdorohet.

Për më tepër, duhet të ketë një proces formal për adresimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet prokurorit që trajton çështjen dhe eprorit ose drejtuesit të tij.¹⁰²

Është raportuar se nuk ka një mekanizëm rishikimi për çështjet ku ka pasur lirime ose janë refuzuar ose pushuar kërkesat për gjykim. Përcaktimi i një mekanizmi rishikimi të tillë do të lejonte nxjerrjen e mësimave dhe informonte praktikën e ardhshme. Mund të argumentohet që kjo është veçanërisht e rëndësishme në çështjet KOK të nivelit të lartë.

¹⁰¹ Të dyja programet e trajnimit zbatohen nga Akademia e Drejtësisë e Kosovës.

¹⁰² I disponueshëm në https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016804be55a [aksesuar më 21 mars 2024]

KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të sigurojnë që kriteret e vlerësimit të performancës dhe pritshmëritë për ngarkesën e punës për gjyqtarët dhe prokurorët të reflektojnë në mënyrën e duhur nivelin e përpjekjeve të nevojshme për të trajtuar çështjet KOK.

- i. Këshillat duhet të marrin parasysh rëndësinë që u jepet treguesve cilësorë në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- ii. Si elementet sasiore edhe ato cilësore të vlerësimit të performancës duhet të kenë parasysh në formën e duhur kompleksitetin dhe përpjekjet e nevojshme për trajtimin e çështjeve KOK të nivelit të lartë.
- iii. Këshillat duhet të rishikojnë vazhdimisht kriteret e vlerësimit të performancës në çështjet KOK për të siguruar që të nxitin praktikën e mirë dhe dhënien e përparësisë së duhur ndaj çështjeve.

Vlerësimet e performancës synojnë të sigurojnë llogaridhënien dhe të ruajnë standardet e sistemit gjyqësor dhe prokurorisë, duke nxitur besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Ndërsa treguesit sasiore të performancës, si menaxhimi i ngarkesës dhe normat e mbylljes së çështjeve, japin një informacion të vlefshëm, ata duhet të kombinohen me tregues cilësorë që vlerësojnë standardin e punës së gjyqtarit dhe prokurorit. Në Kosovë, sistemet e vlerësimit të

performancës aktualisht theksojnë treguesit sasiore. Për të gjetur një ekuilibër më të mirë, duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje faktorëve cilësorë. Kjo duhet të ulë përparësinë që gjyqtarët dhe prokurorët i japin "sasisë mbi cilësinë" dhe të lejojë një vlerësim gjithëpërfshirës të kompetencës dhe profesionalizmit të përgjithshëm. Zbatimi i vazhdueshëm i këtij rekomandimi është pjesë e Deklaratës së Përbashkët të Zotimit".¹⁰³

¹⁰³ Këshilli i Evropës ka kryer vlerësime të hollësishme të sistemeve të vlerësimit si për gjyqtarët dhe për prokurorët sipas standardeve të KKGJE-së, që duhet të informojë rishikimin e sistemeve ekzistuese si pjesë e kësaj nisme. Shih gjithashtu CCJE Opinion No. 17 (2014) 'on the evaluation of judges' work, the quality of justice and respect for judicial independence'; të disponueshëm në: <https://rm.coe.int/16807481ea> [aksesuar më 21.03.2024]. KKGJE-ja rekomandon të merren parasysh treguesit cilësorë të mëposhtëm: kompetenca profesionale, duke përfshirë njohurinë e ligjit, aftësia për të kryer proceset gjyqësore, dhe kapaciteti për të shkruar vendime të arsyetuara; kompetenca personale, duke përfshirë aftësinë për të përballuar ngarkesën e punës, aftësinë për të marrë vendime, dhe pranimin e teknologjive të reja; dhe kompetencat sociale, duke përfshirë aftësinë për të ndërmjetësuar, respektuar palët, dhe për të përmbushur detyrën në rolet drejtuese.

Raporti i konsoliduar që përshkruan progresin e arritur në “Deklaratën e Përbashkët të Zotimit” reflekton gjetjen që si gjyqtarët dhe prokurorët duhet të vlerësohen nga një sërë treguesish cilësorë, si dhe sasiorë.¹⁰⁴ Në vitin 2023, KGJK-ja miratoi Rregulloren për normën e punës të gjyqtarëve (“Norma e Gjyqtarëve”). Sistemi i “ponderuar” i pikëve që reflekton punën e nevojshme¹⁰⁵ për çështjet KOK të nivelit

të nivelit të mesëm dhe të lartë është për t’u vlerësuar. Rekomandohet që të vlerësohet zbatimi i Normës së Gjyqtarëve për të matur efektin në performancën gjyqësore dhe për të siguruar që nuk krijon rrethana të padëshiruara si përzgjedhja e qëllimshme e çështjeve që lehtësojnë plotësimin e normës, në vend të dhënies së përparësisë objektive ndaj çështjeve.

12

Rekomandim

Institucionet gjyqësore duhet të koordinojnë më mirë aktivitetet me grupet e interesit dhe donatorët për të shmangur punën e dyfishtë dhe për të rritur në maksimum sinergjitë.

- i. Institucionet duhet të mbajnë mbledhje të rregullta koordinimi për partnerët ndërkombëtarë, organizatat e shoqërisë civile dhe të tjerë të përfshirë në zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve në fushën e sundimit të ligjit.
- ii. Institucionet duhet të kryejnë ushtrime të rregulla “hartëzimi” për të mbajtur një regjistër të përditësuar aktiviteteve që mund të shfrytëzohen për të mbështetur koordinimin dhe vlerësuar zbatimin dhe ndikimin.

Shumë donatorë, partnerë ndërkombëtarë dhe OSHC në Kosovë zbatojnë projekte dhe aktivitete në fushën e sundimit të ligjit në mbështetje të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Aktivitetet përfshijnë ofrimin e trajnimeve dhe seminareve,

orientimin dhe ofrimin e ekspertizës dhe burimeve. Për të siguruar qëndrueshmërinë dhe shmangur mbivendosjen, institucionet gjyqësore duhet të marrin përgjegjësi për koordinimin e këtyre përpjekjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale.

¹⁰⁴ Deklaratë e Përbashkët Zotimi, Reforma gjyqësore, Përmbledhje raportesh të grupeve të punës (dhjetor 2023), faqe 12. Raportet nuk janë të disponueshme në internet.

¹⁰⁵ Rregullore për normën e punës së gjyqtarëve, neni 14 (1); E disponueshme në: <https://www.gjyqesori-rks.org/regulloret/?r=M&legId=295> [aksesuar më 21 mars 2024]

Institucionet lokale janë më të mirëpozicionuara për të krijuar dhe ruajtur nisma të veçanta për nevojat, strategjitë dhe planet e posaçme të veprimit të institucioneve gjyqësore, duke çuar në ndërhyrje më të qëndrueshme dhe efektive.

Institucionet lokale duhet të ndërmarrin hapa për të koordinuar më mirë projektet dhe aktivitetet e lidhura me sistemin e drejtësisë. Kjo duhet të përfshijë të paktën mbajtjen e rregullt të

“mbledhjeve për koordinimin e donatorëve” dhe hartëzimin e mbështetjes dhe aktiviteteve që zbatohen duke shfrytëzuar modelin e mirë të mbledhjeve të rregullta të KGJK-së me donatorët.

Si rrjedhim, institucionet gjyqësore që marrin përsipër të udhëheqin koordinimin do të sjellin mbështetje më të dobishme, efikase dhe të mirëfilltë, duke nxitur përforsimin e infrastrukturës së sundimit të ligjit.

13

Rekomandim

Të vlerësohen nevojat dhe performanca e njësive të specializuara që punojnë me çështjet KOK të nivelit të lartë.

i. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet vazhdimisht të mbikëqyrin, vlerësojnë dhe adresojnë performancën dhe efikasitetin e departamenteve të specializuara për çështjet KOK të nivelit të lartë.

Departamenti Special, Gjykata Themelore Prishtinë dhe Prokuroria Speciale (PSRK) janë përgjegjës për shumicën e çështjeve KOK të nivelit të lartë. Megjithatë, rezultatet e çështjeve mbeten të paqëndrueshme. Këshillat duhet të vlerësojnë vazhdimisht nevojat e këtyre departamenteve të specializuara dhe të sigurojnë shpërndarjen proporcionale të

burimeve. Kjo përfshin sigurimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të kualifikuar dhe të përshtatshëm për tëmenaxhuar çështjet, disponueshmërinë e ekspertëve dhe personelit ndihmës ligjor; si dhe nxitjen e bashkëpunimit më të fortë me agjenci ligjzbatuese të specializuara dhe institucione të tjera të lidhura.

Trajnimet duhet të sigurojnë që të vlerësohen edhe njohuri të posaçme për tema si prokurimi publik, përgjegjësia penale e personave juridikë, hetimet financiare, mjetet e posaçme të hetimit dhe pastrimi i parave. Thellimi i ekspertizës mund të arrihet edhe përmes ngritjes së pikave kyçe për ofrimin e drejtimit, orientimit dhe

shkëmbimit mes kolegëve për tema kyçe duke përdorur modelin e ofruar nga rrjeti i koordinatorëve të Zyrës së Kryeprokurorit për konfiskimin e pasurive. Sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe aftësive të thelluara do të çojë në një analizë juridike më të saktë dhe vendimmarrje më të mirë, duke rezultuar në rezultate më të drejta.

14

Rekomandim

Të përmirësohet cilësia e vendimeve në çështjet KOK të nivelit të lartë.

- i. Gjykata Supreme duhet të ndryshojë Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore të vitit 2018 për ta përshtatur atë me KPP-në e re. Ky udhëzues i ri duhet të adresojë gjithashtu problemin e sanksioneve në çështjet KOK të ndërlikuara që përfshijnë shumë të pandehur.
- ii. Gjyqtarët duhet të japin vendime të qarta dhe të arsyetuara mirë. Kur të pandehurit lirohen, duhet të jepet arsyetim i veçantë. Vendimet për masën e dënimit duhet të adresojnë rrethanat rënduese dhe lehtësuese për çdo të pandehur.

Prej fillimit të Projektit, ekipi ka monitoruar 16 çështje që kanë marrë vendime të formës së prerë (12 për korrupsion dhe katër për krim të organizuar). Një pjesë e madhe e çështjeve të përfunduara kanë çuar në lirime. Në veçanti, 21 nga 26 të pandehur (81 për qind) që përballeshin me akuza të

lidhura me korrupsionin u liruan ose kërkesa për gjykim u refuzua.¹⁰⁶ Tridhjetegjashtë nga 48 të pandehur (75 për qind) të akuzuar për vepra penale të lidhura me krimin e organizuar u liruan. Tri nga katër çështje të krimit të organizuar, që përfshinin akuza në lidhje me trafikimin e drogës, çuan në dënime.

¹⁰⁶ U shënuan lirime për nëntë nga 12 çështjet e monitoruara (75 për qind)

Vlen të përmendet se një nga katër çështjet e përfunduara të krimit të organizuar çuan në lirimin e të gjithë të pandehurve (36 të pandehur). Si pasojë, numri i ulët i çështjeve të monitoruara duhet të merret parasysh kur vlerësohet rëndësia e shkallës së lirimit në çështjet

e krimit të organizuar. Në tërësi, shkalla e lirimit në çështjet KOK të monitoruara është 76 për qind. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto statistika paraprake janë marrë nga relativisht pak çështje (16).

Rezultati i çështjeve të përfunduara




Figura 23 - Çështjet aktive dhe të përfunduara

Nga 16 çështje të përfunduara, njëra çoi në vendim të formës së prerë në shkallën e parë pasi i pandehuri u deklarua fajtor, një çështje përfundoi në rigjykim, nëntë çështje çuan në vendim të formës së prerë në Gjykatën e Apelit dhe pesë çështje përfunduan në Gjykatën Supreme pas apeleve për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Çështjet aktive dhe të përfunduara




Figura 24 - Rezultati i çështjeve të përfunduara

Në total, 17 të pandehur u dënuan (një pas deklarimit si fajtor, 16 pas gjykimeve të kundërshtuara). Zbërthimi i dënimeve tregohet në figurën më poshtë. Vlen të përmendet se 16 nga 17 të pandehur morën dënime burgimi të menjëhershëm. Të 17 të pandehurit gjithashtu morën sanksione financiare.

Dënimet në çështjet KOK të përfunduara




Figure 25 - Dënimet në çështjet e përfunduara.

Projekti vëzhgoi se vendimet e Gjykatës Themelore shpesh nuk kishin arsyetim të qartë dhe gjithëpërfshirës për vendimet, si për lirimet dhe për dënimet. Në disa vendime, konstatimet e faktit ishin të paqarta dhe kishin nevojë për mbështetje më të fortë. Disa vendime për masën e dënimit përmbledhnin rrethanat rënduese dhe lehtësuese pa përshkruar se si lidheshin me secilin të pandehur. Kjo çonte në vendime mjaft të shkurtra duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes dhe numrin e të pandehurve.

Gjyqtarët duhet të sigurojnë që vendimet të përmbushin kriteret e KPP-së. Vendimet për masën e dënimit duhet të jenë plotësisht të arsyetuara dhe të individualizuara, me një shpjegim për rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe arsyen që dënimi konsiderohet si

proporcional për çdo të pandehur.

Në vitin 2018, Gjykata Supreme publikoi një udhëzues gjithëpërfshirës për politikën ndëshkimore që synonte njësimin e praktikave të masave të dënimit në të gjitha gjykatat.¹⁰⁷ Në vitin 2021 u publikua gjithashtu "Udhëzuesi i veçantë: korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare".¹⁰⁸ Pavarësisht se u ngrit një komitet për të monitoruar udhëzuesin e vitit 2018, kishte monitorim dhe vlerësim të pamjaftueshëm të këtij të fundit. Gjykatat shpesh nuk e respektojnë rregullisht udhëzuesin e politikës ndëshkimore. Udhëzuesi nuk është i detyrueshëm dhe trupat gjykues rrjedhimisht kanë autoritet të konsiderueshëm kur dënojnë të pandehurit. Megjithatë, zbatimi i këtij udhëzuesi mund të përmirësojë

¹⁰⁷ Gjykata Supreme, Udhëzuesi i politikës ndëshkimore, Botimi i 1-rë, 2018, gjithashtu i disponueshëm në: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Sentencing%20Guidelines_February%202018.pdf [aksesuar më 21 mars 2024]

¹⁰⁸ Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzuesi i veçantë: korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, qershor 2021, gjithashtu i disponueshëm në: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/5884_Corruption%20Specific%20Guidelines-%20June%2010.pdf [aksesuar më 21 mars 2024]

koherencën në vendimet e masës së dënimit dhe të ulë numrin e apeleve kundër dënimeve. Si pasojë, gjyqtarët duhet të inkurajohen t'i referohen udhëzuesit në vendimet e tyre.¹⁰⁹

Meqenëse ka pasur ndryshime të konsiderueshme ligjore që nga viti 2018,¹¹⁰ Gjykata Supreme duhet të përditësojë udhëzuesin aktual për të reflektuar këto ndryshime.

Mjetet Gjyqësore

15

Rekomandim

Të sigurohet që hetimet financiare dhe konfiskimi i pasurive të zbatohen sistematikisht në çështjet KOK.

- i. Të promovohet përdorimi efektiv i mjeteve të hetimit, duke përfshirë Mjetet e Posaçme të Hetimit (MPH) dhe ndihmën e ndërsjellë juridike.
- ii. Të zbatohet udhëzuesi për prokurorët për sekuestrimin dhe konfiskimin, i publikuar në vitin 2023 dhe të merret parasysh nëse kërkohet orientim shtesë për hetimet financiare.
- iii. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të sigurojnë që vlerësimet e performancës gjyqësore dhe të prokurorisë dhe ngarkesat e punës të reflektojnë angazhimin e nevojshëm për proceset e konfiskimit.
- iv. ADK-ja duhet të sigurojë që ndërtimi i kapaciteteve për hetimet financiare dhe konfiskimin e pasurive të jetë i mjaftueshëm, efektiv dhe i posaçëm për ata ku është më shumë i dobishëm.

Projekti shqyrtoi të dhëna për hetimet financiare në çështjet e monitoruara dhe vëzhgoi se prokurorët kryen hetime

financiare vetëm në 32 nga 52 çështje të monitoruara (62 për qind).

¹⁰⁹ Një alternativë mund të jetë që gjyqtarët të detyrohen të japin arsyetim nëse dalin nga udhëzuesi.

¹¹⁰ Përfshirë Kodin Penal të vitit 2019 dhe Kodin e Procedurës Penale të vitit 2023.

Pavarësisht që çështjet e monitoruara përfshinin shuma të konsiderueshme të pretenduara si dëm ose fitim, konfiskimi i pasurive ishte i rrallë.

Shumë faktorë kontribuojnë në përdorimin e dobët të hetimeve financiare dhe konfiskimit të pasurive në Kosovë. Së pari, ka mungesë vlerësimi dhe aftësie si në radhët e policisë edhe të prokurorëve në lidhje me rëndësinë e konfiskimit dhe se si të kryhen hetime financiare efektive. Për më tepër, monitoruesit vëzhguan përdorimin e pamjaftueshëm të mjeteve si Mjetet e Posaçme të Hetimit (MPH) dhe ndihma e ndërsjellë juridike për të gjurmuar produktet e veprës penale.

Kur një çështje KOK e nivelit të lartë çon në dënim, prokurorët priren të drejtojnë vëmendjen në çështje të tjera në vend që të fillojnë procedurën e parashikuar për konfiskimin e zgjeruar. Ky ridrejtim mund të rrjedhë nga kufizimet e burimeve, përparësitë e mbivendosura ose një mungesë theksi ndaj rikuperimit të pasurive pas dënimit në vlerësimet e performancës.

Rritja e konfiskimeve përfundimtare të pasurive në vitin 2023 në krahasim me vitet e mëparshme është zhvillim pozitiv.¹¹¹ Megjithatë, rritja lidhet me një numër të vogël çështjesh ku janë sekuestruar pasuri me vlerë të madhe, rrjedhimisht ajo nuk tregon një përdorim më të gjerë/sistematik të konfiskimit pas dënimit.

Proceset e konfiskimit kërkojnë angazhim dhe ekspertizë të konsiderueshme nga autoritetet gjyqësore dhe të prokurorisë. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të reflektojnë kompleksitetin e këtyre çështjeve në vlerësimet e performancës dhe ngarkesat e punës. Kjo qasje do të sigurojë që gjyqtarët dhe prokurorët të pajisen me burimet dhe kohën e duhur për të kryer hetime financiare gjithëpërfshirëse dhe për të trajtuar proceset e konfiskimit të pasurive në mënyrë efektive.

Miratimi i udhëzuesit për konfiskimin e pasurive të nxjerrë nga Zyra e Kryeprokurorit në tetor 2023 është një ndryshim tjetër pozitiv.¹¹² Përpjekjet tani duhet të përqendrohen te ndërgjegjësimi për udhëzuesin dhe monitorimi i përdorimit të tij. Raportohet se keqkuptimet e konsiderueshme rreth Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë kanë penguar përdorimin e masave të sekuestrimit dhe konfiskimit. Këto probleme vazhdojnë pavarësisht numrit të madh të trajnimeve të bëra për këto tema.

Adresimi i suksesshëm i këtyre sfidave kërkon një qasje të shumanshme. Autoritetet përkatëse duhet së paku të adresojnë mangësitë në njohuritë dhe aftësitë e zyrtarëve ligjzbatues dhe juristëve, të japin stimuj për përdorimin e rikuperimit të pasurive duke rishikuar kriteret për vlerësimin e performancës.

¹¹¹ Raportuar gjatë konsultimeve

¹¹² Kjo pasoi rekomandime të mëparshme për të dhënë orientim shtesë për këtë temë.

Të përmirësohet akses i informacionet financiare për zyrtarët ligjzatues dhe prokurorët duke respektuar të drejtat e privatësisë

- i. T'i jepet Prokurorisë Speciale akses te të dhënat nga regjistrat zyrtarë në të njëjtin nivel si Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës (p.sh., databazat e policisë, kadastra dhe administrata tatimore).
- ii. T'i jepet orientim sektorit privat për përgjigjen ndaj kërkesave për informacion/ zbulim nga autoritetet gjyqësore.
- iii. Të sigurohet që ekspertët financiarë të kenë aftësi dhe ekspertizë të mjaftueshme dhe puna e tyre të vlerësohet në mënyrën e duhur.

Në mënyrë që të sigurohet një hetim dhe ndjekje penale efektive e çështjeve KOK, veçanërisht e pastrimit të parave, kërkohet akses i shtuar tek informacionet financiare për zyrtarët ligjzatues dhe prokurorët duke respektuar të drejtat e privatësisë. Prokuroria Speciale aktualisht mbështetet te Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) për hetimet financiare, por përballet me pengesa në aksesin e të dhënave kritike nga databazat ekzistuese. Për më tepër, prokurorët shpesh nuk arrijnë t'i kuptojnë qartë të dhënat e mbledhura, gjë që pengon analizën faktike dhe juridike.

Akresi i Prokurorisë Speciale te të dhënat nga regjistrat zyrtarë në të njëjtin nivel si NJIF-ja do të rrisë në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin e saj për të hetuar dhe ndjekur çështjet.

Megjithatë, duhet të ngrihen garanci të forta për të mbrojtur të drejtat e privatësisë, duke përfshirë protokolle të rrepta për mbrojtjen e të dhënave, kontrolle mbi aksesin, dhe përdorimin e të dhënave të anonimizuara dhe të agreguara sipas rastit.

Në lidhje me sektorin privat, orientimi i qartë për institucionet financiare kyçe si bankat dhe shoqëritë e sigurimit për detyrimet e tyre kur u përgjigjen kërkesave nga autoritetet gjyqësore është kritik. Ky orientim duhet të mbulojë kuadrin ligjor, llojet e kërkesave, trajtimin e procedurave dhe masat e konfidencialitetit, duke theksuar bashkëpunimin, pajtueshmërinë, por edhe të drejtat e privatësisë.

Në lidhje me aftësitë dhe ekspertizën e ekspertëve financiarë,

duhet të ngrihet një mekanizëm gjithëpërfshirës vlerësimi për të vlerësuar kualifikimet, kompetencën dhe integritetin e ekspertëve financiarë. Ky mekanizëm vlerësimi duhet të përmbajë kriterë të rrepta përzgjedhjeje, vlerësime të rregullta të performancës dhe kërkesa të vazhdueshme për zhvillim profesional. Duke u siguruar që ekspertët financiarë respektojnë standarde rigoroze, mund të ruhet efikasiteti dhe besueshmëria e hetimeve financiare.

Në zbatimin e këtyre masave, duhet të ketë një ekuilibër të përshtatshëm ndërmjet lehtësimit të aksesit tek informacionet financiare për zyrtarët ligjzbatues dhe prokurorët dhe mbrojtjes së të drejtave të individëve për privatësinë. Masat e konsoliduara për mbrojtjen e të dhënave, udhëzimet e qarta dhe mekanizmat e rreptë të vlerësimit mund të ndihmojnë për të arritur këtë ekuilibër dhe për të siguruar që aksesit tek informacionet financiare është si efektiv edhe ligjor.

17

Rekomandim

Të përforcohet bashkëpunimi rajonal në trajtimin e çështjeve KOK

- i. Të përdoren rrjetet joformale dhe grupet rajonale ekzistuese, si CARIN,¹¹³ për të shkëmbyer informacione.
- ii. Të inkurajohet përgjigje e shpejtë ndaj kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike, duke përfshirë:
 - Udhëzime të qarta dhe procedura standarde funksionimi për trajtimin e shpejtë dhe efikas të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike nga autoritetet.
 - Të përcaktohen pika kontakti brenda autoriteteve gjyqësore për të përshpejtuar trajtimin e kërkesave.
 - Të ofrohen programe trajnimi për të kuptuar më mirë kornizat juridike ndërkombëtare.

¹¹³ CARIN është një rrjet joformal profesionistësh ligjzbatues dhe gjyqësorë në fushën gjurmimit, ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive. Ai është një rrjet prej disa agjencish. Çdo shtet anëtar përfaqësohet nga një zyrtar ligjzbatues dhe ekspert gjyqësor (prokuror, gjyqtar hetues, etj., në varësi të sistemit juridik). CARIN aktualisht ka 54 juridiksione anëtare të regjistruara, duke përfshirë Kosovën, 27 Shtete Anëtare të BE-së dhe nëntë organizata ndërkombëtare. E disponueshme në <https://www.carin.network/> [aksesuar më 21 mars 2024]

Projekti ka monitoruar katër çështje ku proceset janë zgjatur për shkak të zvarritjeve në marrjen e ndihmës së ndërsjellë juridike. Periudha më e shkurtër e vëzhguar për marrjen e kësaj ndihme ishte dy muaj.¹¹⁴ Juristët e Kosovës konfirmuan se kërkesat formale për ndihmë të ndërsjellë juridike mund të marrin deri në 12 muaj, dhe në disa raste, ato nuk marrin përgjigje.

Për të minimizuar ndikimin e këtyre vonesave dhe për të thelluar më tej bashkëpunimin gjyqësor rajonal dhe ndërkombëtar, duhet të përdoren rrjetet ekzistuese joformale dhe grupet rajonale.

Rrjetet joformale si CARIN (Rrjeti Ndërinstitucional Camden i Rikuperimit të Pasurive¹¹⁵), mund të lehtësojnë shkëmbimin e informacionit në radhët e autoriteteve gjyqësore dhe të shtojë besimin reciprok dhe bashkëpunimin në ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike.

Rekomandohet vënia në zbatim e udhëzuesve dhe procedurave standarde të funksionimit, si dhe trajnimet praktike për zbatimin e ndihmës së ndërsjellë juridike dhe kornizave juridike ndërkombëtare për të rritur besimin e profesionistëve të zbatimi i këtyre masave.

¹¹⁴ Marrje në pyetje e një personi në paraburgim në një juridiksion fqinj.

¹¹⁵ <https://www.carin.network/>

VIII. Mali i Zi

Hyrje

Gjatë tri viteve të fundit, procedimi gjyqësor i çështjeve serioze KOK në Malin e Zi ka demonstruar progres të kufizuar. Funksionimi i përgjithshëm i sistemit gjyqësor është cenuar nga përbërja e paplotë e organeve të rëndësishme gjyqësore dhe mandatet e përkohshme në pozicione kyçe. Megjithatë, Mali i Zi ka marrë disa hapa pozitivë për të zgjidhur krizën gjyqësore.

Në mars 2022 u emërua Kryeprokurori Special i ri. Që prej marrjes së detyrës, ka pasur progres të konsiderueshëm në numrin e kërkesave për gjykim të dorëzuara kundër të pandehurve të profilin të lartë që kanë interes të veçantë publik.

Për më tepër, Parlamenti emëroi gjyqtarin e fundit të Gjykatës Kushtetuese në Nëntor 2023, tre anëtarët e mbetur nga radhët e juristëve në Këshillin Gjyqësor në Dhjetor 2023 dhe Prokurorin Suprem të Shtetit në Janar 2024. Në kohën e shkrimit të këtij raporti, Kryetari i Gjykatës Supreme nuk ishte emëruar ende, pavarësisht se pozicioni mbahet me mandat të përkohshëm që prej Dhjetorit 2020.

Duke marrë parasysh që çështjet e nivelit të lartë – edhe sipas Metodologjisë së Projektit – zakonisht kanë pasoja politike,

vlerësimi i pavarësisë së gjyqësorit ka qenë pjesë e analizës së ekipit të Projektit.

Projekti ka vënë re vazhdimisht politikanë që kanë komentuar në mënyrë të papërshtatshme për proceset penale të papërfunduara në çështjet nën monitorim.

Përmes monitorimit mediatik, Projekti gjithashtu ka gjetur prova që mediat kanë përkeqësuar dhe zmadhuar efektin e lartpërmendur duke ripublikuar dhe qarkulluar në mënyrë të gjerë deklaratat problematike.

Për më tepër, disa akuza të fundit kundër përfaqësuesve të nivelit të lartë, të mëparshëm ose aktualë, të gjyqësorit dhe administratës publike sugjerojnë se krimi i organizuar është përpjekur të ushtrojë ndikim tek institucionet kyçe, duke përfshirë agjencitë ligjzbatuese dhe gjyqësorin, në një masë dhe me pasoja që ende nuk janë përcaktuar.

Nga ana tjetër, Projekti gjithashtu njeh se gjykatat kanë filluar të rritin transparencën e punës së tyre duke miratuar disa praktika të mira si publikimi i orareve të seancave më rregullisht në faqet përkatëse të internetit.

Duke parë më nga afër çështjen e afateve, Projekti vëren se mungesa e efikasitetit në procese është një nga mangësitë më të mëdha në trajtimin e çështjeve KOK në Malin e Zi.

Nga 59 çështjet nën monitorim, vetëm dy kanë përfunduar. Njëra rezultoi në një pafajësi, ndërsa tjetra përfundoi në fazën paraprake pasi kërkesa për gjykim nuk u pranua. Vetëm tetë çështje përfunduan në shkallën e parë gjatë periudhës së zbatimit të Projektit.

Projekti gjithashtu vëzhgoi se aktet gjyqësore – duke përfshirë vendimet, kërkesat për gjykim dhe vendimet e paraburgimit – shpesh nuk kishin arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm.

Për më tepër, burgimi gjatë proceseve nuk dukej se trajtohej si masa e fundit e mundshme, ndërsa vendimet që urdhëronin burgimin shpesh karakterizoheshin nga një arsyetim i pamjaftueshëm, siç është konstatuar nga Gjykata Kushtetuese, që ka gjetur se e drejta e lirisë e të pandehurve është shkelur në këto raste.

Për më tepër, toleranca e tepërt në praktikën e sanksionimit përbën problem. Në çështjet nën monitorim, gjykata aplikoi dënimin minimal ose pranë minimumit të parashikuar nga vepra përkatëse në Kodin Penal për pesë të pandehur dhe aplikoi

sanksione poshtë minimumit të detyrueshëm për 55 të pandehur.

Duke parë se këto shifra bazohen më së shumti te dënimet që rezultojnë nga vendime të bazuara në MPF, është pozitive që Gjykata Supreme dhe Prokuroria Supreme e Shtetit (PSSH) nxorën udhëzime për përdorimin e MPF-ve. Problemi i tolerancës përmes MPF-ve pritet të adresohet përmes zbatimit të duhur të këtyre udhëzimeve.

Gjithashtu u vërejtën mangësi të konsiderueshme në lidhje me konfiskimin e pasurive në çështjet KOK. Paaftësia për të gjetur pasuritë për t'u sekuestruar ose ngrirë me qëllim konfiskimin e drejtpërdrejtë ose të zgjeruar të produkteve të veprës penale tregon se metodat e hetimit financiar aktualisht në përdorim nuk janë efektive.

Për të korrigjuar sfidat e lidhura me pavarësinë e gjyqësorit, menaxhimin e çështjeve gjyqësore, politikën ndëshkimore, cilësinë e akteve gjyqësore, hetimet financiare dhe konfiskimin e pasurive, në kapitullin e mëposhtëm paraqitet një seri gjithëpërfshirëse prej 19 rekomandimesh të posaçme dhe konkrete në bazë të gjetjeve të monitorimit të çështjeve gjyqësore nga Projekti.

Drejtësia

1

Rekomandim

Të bëhen publikisht të disponueshme informacionet për trajtimin e çështjeve KOK në mënyrë të shpejtë, të saktë dhe të rregullt, duke përfshirë publikimin e orareve të seancave gjyqësore, kërkesave për gjykim dhe vendimeve. Në veçanti:

i. Kryetarët e gjykatave dhe prokurorive të shtetit duhet të sigurojnë njësimin e praktikës në publikimin e akteve gjyqësore dhe informacioneve të tjera në lidhje me proceset penale, duke përfshirë orarin e seancave.

ii. Qendra për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe të Prokurorisë duhet të zhvillojë dhe ofrojë kurse të posaçme trajnimi për marrëdhëniet me publikun (MP) për të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët që trajtojnë çështjet KOK, veçanërisht krerët e institucioneve dhe përfaqësuesit e MP-së, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira në raportimin e çështjeve KOK dhe çështjeve me interes të lartë publik.

iii. Gjykata Supreme dhe PSSH-ja duhet të përditësojnë strategjitë e tyre të komunikimit me udhëzime të qarta se si duhet të raportojë gjyqtarët dhe prokurorët për çështjet KOK me interes të lartë publik

iv. Këshilli Gjyqësor dhe Gjykata Supreme duhet të fillojnë programe ndërgjegjësimi në mënyrë që të kuptohet më mirë roli i gjyqësorit në ruajtjen e sundimit të ligjit.

Ekipi i Projektit vëzhgoi se oraret e seancave, si dhe aktet gjyqësore përkatëse, nuk publikoheshin rregullisht në faqet e internetit të Gjykatës së Lartë në Podgoricë dhe Prokurorinë Speciale. Të dhënat nga të paktën 229 seanca në

42 çështje nën monitorim mungonin nga faqja e internetit e gjykatës. Shumica e seancave të pashpallura ishin seanca për kontrollin e kërkesave për gjykim dhe për diskutimin rreth MPF-ve.

Në lidhje me aktet gjyqësore, të paktën 24 kërkesa për gjykim nuk u publikuan në 21 çështje, si dhe 72 vendime të bazuara në MPF në 11 çështje.

Gjatë konsultimeve, shumë bashkëbisedues theksuan rëndësinë për të pasur një mjet të posaçëm për të komunikuar me publikun për çështjet KOK, pasi kultura e marrëdhënieve me publikun në gjyqësor, veçanërisht në gjykata, kishte hapësirë për përmirësim.

Për më tepër, mbetet i nevojshëm trajnimi për të ndihmuar aktorët gjyqësorë për të identifikuar çështjet që vlenin të raportoheshin dhe për të mësuar për standardet e transparencës dhe raportimit në çështjet penale. Zhvillimi i strategjive të komunikimit

dhe përfshirja e zyrtarëve të marrëdhënieve me publikun dhe krerëve të institucioneve është një mënyrë efektive për të gjetur ekuilibrin ndërmjet transparencës dhe mbrojtjes së aktorëve gjyqësorë.

Ekipi i Projektit gjithashtu propozon zhvillimin e programeve të ndërgjegjësimit për të përforcuar lidhjet ndërmjet gjykatave dhe komuniteteve të tyre.

Këto programe mund të përfshijnë aktivitete si debate publike, prezantime, aktivitete të hapura në gjykata dhe shpërndarje materialesh informuese ose të tjera që do të nxitin marrëdhëniet ndërmjet gjyqësorit dhe publikut¹¹⁶

2

Rekomandim

Të përforcohen kapacitetet e medias për të respektuar standardet ndërkombëtare dhe Kodin e Sjelljes së Gazetarëve në raportimin e çështjeve KOK:

i. Të Organet vetërregulluese të medias duhet të hartojnë një fjalorth terminologjie juridike për gazetarët që mbulojnë çështjet KOK për të lejuar raportimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë prezumimin e pafajësisë.

ii. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorisë duhet të ofrojnë trajnim për gazetarët për terminologjinë juridike dhe procedurat ligjore për të ndërtuar kapacitetet e gazetarëve për mbulimin e

¹¹⁶ CCJE, Opinion no. 23(2020) mbi rolin e organizimit të gjyqtarëve në ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit, page 9, gjendet në [Strasbourg, 27 September 2012 \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/Document/CCJE/Opinion%20no%2023%282020%29.pdf).

duhur të çështjeve KOK, duke përfshirë pavarësinë gjyqësore dhe prezumimin e pafajësisë. Kjo do të kontribuojë gjithashtu në ndërtimin e besimit ndërmjet dy palëve.

Ekipi i Projektit identifikoi të paktën 42 artikuj mediatikë me përmbajtje që minonte pavarësinë e gjyqësorit dhe prezumimin e pafajësisë së të pandehurve.

Shembujt më të zakonshëm përfshinin përdorimin e papërshtatshëm të terminologjisë juridike që i paraqiste të pandehurit sikur të ishin dënuar; publikimin e fotografive të të pandehurve në pranga; promovimin e deklaratave paragjyqëse të politikanëve ose personave të tjerë publikë në llogaritë e mediave sociale ose në hapësira të tjera; dhe publikimin e artikujve që kritikojnë mënyrën e gjyqtarëve në çështjet penale në proces. Për më tepër, kishte rrjedhje dhe publikime të disa provave nga çështjet penale nën hetim, duke përfshirë zbardhjen e mesazheve të enkriptuara.

Sipas komenteve të marra nga të gjithë aktorët gjyqësorë, mënyra e raportimit të medias malazeze për çështjet penale është shpesh e papërshtatshme dhe mund të jetë e projektuar për të shtuar presionin te gjyqtarët dhe prokurorët, dhe për të minuar besimin e publikut te gjyqësori.

Disa nga gazetarët që morën pjesë në aktivitetin e OSHC-së të organizuar nga Projekti ranë dakord, duke vërejtur se media u jepte shumë ekspozim deklaratave të papërshtatshme të politikanëve, veçanërisht atyre në ekzekutiv, që duhet të kenë kujdes të veçantë për të mos minuar të drejtat e të pandehurve dhe pavarësinë e gjyqtarëve.

Për të ndihmuar gazetarët të raportojnë në mënyrë më profesionale dhe etike, një hap i parë i vlefshëm është një fjalorth terminologjie juridike i hartuar nga organet vetërregulluese të medias me ndihmën e Gjykatës Supreme ose Këshillit Gjyqësor. Ai do të japë njohuritë juridike të nevojshme për raportimin e çështjeve penale nga gazetarët. Për më tepër, në bashkëpunim me organet gjyqësore, mund të ofroreshin trajnime të posaçme për nevojat e gazetarëve raportues, të cilat mund të bëheshin tërheqëse duke përfshirë shembuj fiktivë të bazuar në raste reale.

Anëtarët e konsultuar nga Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë gjithashtu shprehën mendimin se gazetarët do të përfitonin nga trajnimet e organizuara nga pjesëtarët e sistemit gjyqësor.

Këshilli Gjyqësor dhe i Këshilli i Prokurorisë duhet të përforcojnë besimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke:

- i. U siguruar që të përdoren mekanizmat ekzistues që mbrojnë pavarësinë e gjyqtarëve dhe autonominë e prokurorëve, dhe si rrjedhojë duke adresuar të gjithë problematikën në lidhje me sigurinë personale të prokurorëve dhe gjyqtarëve.
- ii. Formuar një organ të brendshëm nga Këshilli Gjyqësor për të adresuar problemet në lidhje me pavarësinë dhe sigurinë e gjyqtarëve në mënyrë më shteruese.
- iii. Organizuar mbledhje dhe forume të rregullta ku gjyqtarët dhe prokurorët mund të ngrenë shqetësime dhe të bëjnë pyetje.

Siç është vërejtur më parë, gjatë monitorimit të medias, ekipi i Projektit vëzhgoi raste ku politikanët, personat publikë dhe gazetarët komentuan në mënyrë të papërshtatshme për çështjet në proces.

Në katër çështje korrupsioni të nivelit të lartë dhe tri çështje të krimit të organizuar të nivelit të lartë, zyrtarët publikë komentuan në mënyrë të papërshtatshme për proceset penale në zhvillim.

Për shembull, në një nga këto çështje, politikanët kritikuan rëndë një lirim jopërfundimtar nga gjykata e shkallës së parë. Në tri çështje u bënë komente të papërshtatshme në lidhje me lirimin e disa të pandehurve nga burgu, disa prejre me status të Lartë+,

sipas metodologjisë së monitorimit të çështjeve gjyqësore të Projektit. Si gjyqtarët ashtu dhe prokurorët ranë dakord me konkluzionin e Projektit dhe shprehën shqetësime të ngjashme gjatë konsultimeve.

Konsultimet gjithashtu konfirmuan se mekanizmat ekzistues për të mbrojtur pavarësinë dhe autonominë nuk përdoren mjaftueshëm. Sipas nenit 27 (6) të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe gjyqtarët dhe nenit 37 (9) të Ligjit për Prokurorinë e Shtetit, si gjyqtarët ashtu dhe prokurorët mund të dorëzojnë ankesa te këshillat përkatës nëse mendojnë se pavarësia e tyre është minuar, ndërsa këshillat janë të detyruar të marrin qëndrim për këto ankesa.

Megjithatë, pavarësisht se disa anëtarë të gjyqësorit iu ankuan ekipit të Projektit për presionin para të cilit ndodhen nga raportimi i medias dhe komentet e politikanëve, anëtarët e konsultuar të Këshillave u shprehën se gjyqtarët dhe prokurorët nuk kanë dorëzuar asnjëherë ankesa të tilla.

Ata gjithashtu ranë dakord me Projektin se këto mekanizma duhet të përforcohen, pasi reagimet e duhura ndaj komenteve të papërshtatshme mund të frenojnë komentet e ngjashme në të ardhmen.

Efikasiteti

4

Rekomandim

Gjykata Supreme duhet të krijojë një grup pune për të zhvilluar një sistem ponderimi çështjesh në mënyrë që të sigurojë burime të përshtatshme dhe gjykim efikas për çështjet KOK:

i. Grupi i punës duhet të zhvillojë kriteret e nevojshme për të ngritur një sistem ponderimi çështjesh. Kjo do të kërkojë të merren parasysh shumë faktorë, duke përfshirë llojin e veprave penale, numrin e të pandehurve, rrethanat e veçanta të çdo çështjeje, kohën e nevojshme për të studiuar çdo çështje, ngarkesën e punës të gjyqtarëve dhe burimet e disponueshme, siç është personeli gjyqësor.

ii. Sistemi i ponderimit të çështjeve duhet të integrohet në proceset vendimmarrëse nga Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur vendoset për shpërndarjen e burimeve, duke përfshirë ato njerëzore dhe buxhetore, për Gjykatën e Lartë në Podgoricë. Sistemi duhet të arrijë t'i përshtatet procesit në vazhdim të ngritjes së sistemit elektronik të rishikuar të menaxhimit të çështjeve në gjykata.

iii. Për të nxitur vlerësim dhe zhvillim të vazhdueshëm, pasi sistemi

të jetë funksional duhet të ketë vlerësime dhe përditësime të rregullta për të siguruar dobinë dhe efektivitetin e vazhdueshëm. Kjo duhet të përfshijë mirëmbajtjen e sistemit në përputhje me zhvillimin e një sistemi informatik të përshtatshëm në gjyqësor.

Gjetjet e ekipit të Projektit tregojnë se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore është një nga problemet kyçe që minojnë efikasitetin e drejtësisë. Një nga arsytet për proceset e gjata, siç konfirmohet nga gjyqtarët e konsultuar, është mbingarkesa e gjyqtarëve në Departamentin e Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë, që përkeqësohet nga kompleksiteti i çështjeve. Sipas standardeve të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), ponderimi i çështjeve është një sistem që lejon aktorët gjyqësorë të vlerësojnë kompleksitetin e llojeve të ndryshme të çështjeve.¹¹⁷

Kjo merr parasysh se çdo lloj çështjeje ndryshon sa i përket kohës dhe angazhimit gjyqësor të nevojshëm për ta trajtuar atë. Si pasojë, grupi i punës duhet të marrë parasysh të gjithë “hapat e lidhur me çështjet” për të përcaktuar kohëzgjatjen reale të punës të nevojshme për të përfunduar një çështje në vend të kohës së procedimit. Në këtë aspekt, ai duhet të miratojë metodën Delphi¹¹⁸ për të mbledhur përllogaritje në kohë reale të kohës së shpenzuar në një çështje. Kjo do të përfshijë një vetëvlerësim të kohës së nevojshme për të punuar me

një çështje nga gjyqtarët që marrin pjesë në grupin e punës. Në bazë të këtyre kriterëve, çdo çështje duhet të kategorizohet në mënyrën e duhur pas formimit të saj në gjykatë.

Sistemi i ponderimit të çështjeve do të lehtësonte më shumë shpërndarjen e barabartë të çështjeve, dhe do të kontribuonte në një vlerësim më të drejtë të gjyqtarëve. Ai do t’u shërbejë gjithashtu qëllimeve të tjera, duke përfshirë ndihmesën për të përcaktuar më efektivisht numrin e kërkuar të gjyqtarëve dhe ndihmësve gjyqësorë në Departamentin e Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

Grupi i punës duhet të ketë parasysh mësimet e nxjerra nga përpjekjet e mëparshme të Malit të Zi për të ponderuar çështjet në vitin 2015 për të shmangur gabimet e së shkuarës dhe për të përmirësuar përpjekjet. Për më tepër, Projekti rekomandon fuqimisht kryerjen e një rishikimi gjithëpërfshirës të përdorimit të sistemeve të ponderimit të çështjeve në vende të tjera si Austria, Danimarka, Estonia, Gjermania, Holanda dhe Rumania¹¹⁹, në mënyrë që të vendosen standardet e duhura.

¹¹⁷ CEPEJ, Case weighting in judicial systems, faqe 4, e disponueshme në: [16809ede97 \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/e/treaties/cepej/2002/02_0040.asp).

¹¹⁸ Metoda Delphi është një nga modelet e ponderimit të çështjeve e përdorur për të mbledhur përllogaritjet e kohëzgjatjes mesatare të punës për çështje në bazë të vetëvlerësimit të gjyqtarëve.

¹¹⁹ CEPEJ, Case weighting in judicial systems, faqe 18, e disponueshme në: [16809ede97 \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/e/treaties/cepej/2002/02_0040.asp).

Të sigurohen procese të shpejta përmes vendosjes së afateve kohore të parashikueshme për trajtimin e çështjeve KOK dhe fuqizimin e rolit drejtues të kryetarëve të gjykatave:

i. Gjykata Supreme duhet të ngrejë një grup pune për të vendosur standardet e kohëzgjatjes optimale për proceset gjyqësore në çështjet KOK. Këto standarde duhet të përfshijnë një mekanizëm monitorimi, që do të lejojë mbledhjen e të dhënave për kohëzgjatjen e proceseve për qëllime politikëbërjeje dhe rivlerësimi. Kjo është kritike për politikëbërjen dhe rivlerësimin e standardeve në vijimësi.

ii. Kryetarët e gjykatave, siç sugjerohet nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) dhe CEPEJ, duhet të monitorojnë kohëzgjatjen e proceseve dhe të mbledhin të dhëna për hapat e rëndësishëm në procesin gjyqësor.

Në kohën e shkrimit të këtij raporti, kohëzgjatja mesatare e çështjeve në proces që monitoroheshin nga Projekti ishte 39 muaj, duke filluar nga pranimi i kërkesës për gjykim. Nga numri total i çështjeve në proces, 10 janë në fazën e gjykimit paraprak, 39 në fazën e gjykimit në themel, gjashtë në fazën e apelit dhe dy në fazën e rigjykimit. Në një çështje, gjykimi në themelkryesor ka qenë në proces për 121 muaj.

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve në shkallën e parë është 37 muaj. I njëjti grup pune i ngarkuar me ngritjen e

sistemit të ponderimit të çështjeve mund të përcaktojë gjithashtu kohëzgjatjen e pranueshme të proceseve në çështjet KOK. Për të bërë këtë, grupi i punës duhet të marrë parasysh gjithashtu rëndësinë e një kategorie të dhënë çështjesh, si dhe standardet e KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Grupi mund të mësojë nga juridiksione të tjera me sisteme të ngjashme gjyqësore në këtë aspekt, si Finlanda, Letonia, Norvegjia dhe Sllovenia.¹²⁰

¹²⁰ CEPEJ, Përmbledhje e praktikave më të mira për menaxhimin e kohës së procedurave gjyqësore, 2006, në dispozicion [Compendium \(coe.int\)](http://coe.int).

Projekti merr parasysh që kryetarët e gjykatave kanë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e efikasitetit të proceseve. Kjo është në përputhje me standardet ndërkombëtare, pasi si KKGJE-ja dhe CEPEJ inkurajojnë kryetarët e gjykatave për të monitoruar kohëzgjatjen e proceseve, mbledhur informacionet e lidhura për hapat më të rëndësishëm dhe për të regjistruar kohëzgjatjen e çdo faze individuale të procesit gjyqësor.¹²¹

Megjithatë, gjetjet e mbledhura nga monitorimi i çështjeve, si dhe nga konsultimet me grupet përkatëse të interesit, sugjerojnë që kryetarët e gjykatave nuk duket se i përdorin të dhënat e disponueshme për kohëzgjatjen e proceseve për qëllime analitike dhe vendimmarrëse.

Kryetarët e gjykatave ose administratorët përkatës të menaxhimit të çështjeve duhet të monitorojnë gjithashtu të dhënat e shpërndarjes së ngarkesës së punës për këshilltarët gjyqësorë. Kjo do të ndihmojë për të matur efikasitetin duke vlerësuar raportin ndërmjet personelit të punësuar dhe çështjeve të trajtuara.

Për më tepër, kryetarët e gjykatave mund të emërojnë një person përgjegjës për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të lidhura me fluksin e çështjeve. Ky administrator i posaçëm do të japë përditësime të kryetari i gjykatës për fazat e veçanta të proceseve.

6

Rekomandim

Të zbatohen standardet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të ndihmuar gjyqtarët në përgatitjen dhe drejtimin e çështjeve KOK:

i. Gjykata Supreme duhet të hartojë udhëzime për praktikën më të mira të menaxhimit të çështjeve për të ndihmuar gjyqtarët në përgatitjen dhe drejtimin e çështjeve KOK. Këto duhet të mbulojnë të gjitha aspektet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtarët, me vëmendje të veçantë tek udhëzimi i gjyqtarëve se si të zhvillojnë rregullat e planifikimit, të arrijnë një marrëveshje me palët për kalendarin procedural të seancave dhe të minimizojnë devijimet nga kalendari i pranuar. Ky udhëzues duhet të përfshijë udhëzime se si të procedohet për secilën nga pengesat më të

¹²¹ KKGJE, Opinion mbi Rolin e Kryetarëve të Gjykatave, faqe 4, e disponueshme në [CCJE\(2016\)2REV2\(coe.int\)](#); CEPEJ, Udhëzimet e rishikuara të Saturnit për Menaxhimin e Kohës Gjyqësore, faqe 7, e disponueshme në [TE0801648\(coe.int\)](#).

Rekomandim

zakonshme, duke përfshirë, për shembull, mungesën e të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës, kërkesat për shtyrje, taktikat e tjera të zvarritjes, dhe mungesën e sallave të gjyqit.

ii. Këshilli Gjyqësor dhe organet e tij duhet të sigurojnë që procesi i vlerësimit të gjyqtarëve të përfshijë dhe të vlerësojë në mënyrën e duhur aftësinë e gjyqtarëve për të përgatitur dhe planifikuar çështjet gjyqësore, duke marrë parasysh udhëzimet e Gjykatës Supreme.

Siç vërehet në rekomandimet 4 dhe 5, ekipi i Projektit evidentoi shtyrje të shpeshta të seancave në çështjet KOK. Për shembull, nga shtatori 2021 në mars 2024 kishte mesatarisht vetëm tetë seanca produktive në muaj në të gjitha çështjet nën monitorim. Arsyet kryesore të shtyrjeve përfshinin mungesën e të pandehurve në 152 seanca, nga të cilat 72 seanca u shtynë për shkak të arsyeve shëndetësore, mungesën e avokatëve mbrojtës në 78 seanca dhe mungesën e gjyqtarëve në 51 seanca.

Për më tepër, mungesa e burimeve njerëzore dhe materiale, duke përfshirë sallat e gjyqit, si dhe qasjet pasive të gjyqtarëve gjithashtu kontribuan në shumë shtyrje. Kjo mund të trajtohet duke planifikuar menaxhimin e proceseve, veçanërisht duke vendosur një orar seancash gjyqësore, afate, si dhe një listë veprimesh procedurale që duhet të merren.

Megjithatë, ekipi i Projektit arriti në përfundimin që gjyqtarët nuk i ndërmarrin këto veprime. Në fakt, rregullat e planifikimit të seancave nuk u organizuan në asnjë nga çështjet nën monitorim, pavarësisht se KPP-ja i parashikon ato si një mjet për planifikimin e seancave gjyqësore.

Ekipi i Projektit vëzhgoi shumë raste ku gjyqtarët mund të kishin shmangur shtyrjet nëse do të kishin pasur një qasje proaktive dhe do të kishin planifikuar seancat gjyqësore. Për shembull, në të paktën pesë çështje, gjyqtari nuk ishte i përgatitur për të vazhduar me shqyrtimin e provave të tjera pavarësisht se koha e caktuar për seancën do ta kishte lejuar këtë.

Në dy raste, seanca duhet të shtyhej sepse gjykata nuk i kishte dorëzuar kërkesën për gjykim të pandehurve, pavarësisht se kishin kaluar disa muaj që prej depozitimit të kërkesës për gjykim. Në të paktën dy raste, gjyqtarët

e shtynë seancën sipas kërkesës së avokatëve, pavarësisht se kërkesat procedurale për mbajtjen e seancës ishin përmbushur.

Në raste të tjera, Projekti gjithashtu vërejtë se gjendja shendetësore e vazhdueshme e të pandehurve në tri çështje të ndryshme parandalonte dhe vetë fillimin e gjykimeve, por gjyqtarët nuk merrnin masa efektive për ta zgjidhur këtë problem. Në këto rrethana, gjyqtarët mund të sigurojnë praninë e të pandehurve me video-konferencë.¹²²

Gjatë periudhës së raportimit, avokatët mbrojtës dorëzuan të paktën 18 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke shkaktuar shtyrje të seancave.

Për këtë arsye, udhëzimet e lartpërmendura për menaxhimin e çështjeve gjyqësore duhet të adresojnë si mund të trajtohen ky problem në mënyrë më efektive nga gjyqtarët, duke parandaluar shtyrjet e panevojshme dhe taktikat e zvarritjes nga avokatët mbrojtës.

Vonesat e panevojshme po kontribuojnë në procese gjyqësore

mjaft të gjata, me pasoja madhore në administrimin e drejtësisë.

Në një çështje të monitoruar, çështja gjyqësore u krye në mënyrë joefektive, duke përfunduar me pushimin e akuzave për shkak të afateve të parashkrimit.

Në një çështje tjetër, i pandehuri u lirua nga paraburgimi pasi përmbushi maksimumin e parashikuar me ligj prej tri vitesh në paraburgim. Që nga lirimi, i pandehuri nuk ka qenë i pranishëm në seanca.

Duke parë këta faktorë, Projekti rekomandon standardizimin e planifikimit të seancave në çështjet KOK për të siguruar angazhimin e palëve dhe përshpejtimin e proceseve.

Meqenëse rekomandimi 6 plotëson angazhimin e rekomanduar në rekomandimin 4, Gjykata Supreme mund të shqyrtojë delegimin e hartimit të udhëzuesit të grupi i punës i krijuar me qëllim krijimin e sistemit të ponderimit të çështjeve.

¹²² Vendimi i GJEDNJ-së në çështjen Marcello Viola kundër Italisë, kërkesa 45106/04, para. 67, e disponueshme në [MARCELLO VIOLA v. ITALY \[Extracts\] \(coe.int\)](#); CEPEJ, Udhëzime për videokonferencat në procedurat gjyqësore, e disponueshme në [Guidelines on videoconferencing in judicial proceedings \(coe.int\)](#).

Për të rritur efikasitetin, duhet të ngushtohet kompetenca lëndore e Prokurorisë Speciale dhe Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë. Në veçanti:

i. Ministria e Drejtësisë duhet të identifikojë si të kufizojë kompetencën lëndore në lidhje me çështjet e korrupsionit. Për këtë synim, grupi i punës duhet të marrë parasysh rishikimin e përkufizimit ligjor aktual të “zyrtarit publik” për të identifikuar dhe kuptuar mangësitë e tij. Ai duhet të gjithashtu të marrë parasysh futjen e një termi të ri (p.sh., zyrtar publik i nivelit të lartë) në Ligjin për Prokurorinë Speciale.

Gjatë konsultimeve të ekipit të Projektit, shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve identifikoi ngarkesën e punës si një nga shkaqet madhore të zvarritjeve në proceset e gjykimit. Në këtë aspekt, ata ranë dakord që ngushtimi i kompetencës lëndore të Prokurorisë Speciale dhe Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë mund të rritë efikasitetin e punës së tyre.

Një mënyrë e qartë për të ulur numrin e çështjeve në kompetencën e organeve të specializuara është të rishikohet përkufizimi i zyrtarit publik, pasi ky term lidhet me kompetencën lëndore të çështjeve të korrupsionit të Prokurorisë Speciale dhe Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

Përkufizimi aktual është shumë i gjerë dhe i paqartë, veçanërisht për faktin se

përfshin një numër të madhpersonash që punojnë në sektorin publik. Aktualisht, është e pamundur të përcaktohet me saktësi se cila kategori e zyrtarëve publikë bie në përkufizimin e korrupsionit të lartë në nenin 3 (2) të Ligjit për Prokurorinë Speciale dhe nenin 16 (2) pika 2 të Ligjit për gjykatat.

Nga ana tjetër, është e vështirë të vlerësohet nëse çështja duhet të jetë në juridiksionin e Prokurorisë Speciale dhe Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë të Podgoricës.

Kjo përplasje krijon dy probleme. Së pari, ajo shpesh çon në konflikte kompetencash ndërmjet gjykatave, siç është vëzhguar në dy çështje nën monitorim. Së dyti, ajo shkakton një fluks të madh çështjesh për këto organe të specializuara, që kanë burime njerëzore të kufizuara, veçanërisht pasi jo të gjitha këto çështje kërkojnë

kualifikim dhe specializim të lartë për t'u ndjekur dhe gjykuar.

Duke ulur numrin e çështjeve me të cilat duhet të përballen prokurorët dhe gjyqtarët në organet përkatëse të specializuara, cilësia e punës së tyre do

të rritet, pasi ata do të mund të përqendrohen në disa çështje të përzgjedhura në vend të shumë çështjeve që nuk kanë patjetër kompleksitet dhe "urgjencë" të madhe.

8

Rekomandim

Qeveria e Malit të Zi duhet të ofrojë ambiente të përshtatshme për Prokurorinë Speciale dhe Gjykatën e Lartë në Podgoricë, dhe t'i sigurojë e pajisë ato në mënyrën e duhur.

Gjatë konsultimeve me gjyqtarët, ata identifikuan se mungesa e sallave të gjyqit ishte një nga arsyt kryesore të paaftësisë për të përmbushur afatet e Kodit të Procedurës Penale.

Ekipi i Projektit gjithashtu konstatoi se mungesa e sallave të gjyqit po minonte efikasitetin e gjyqësorit në lidhje me çështjet KOK. Shumë shpesh, ekipi vëzhgoi se gjyqtarët detyroheshin të caktonin seancat shumë më vonë se afatet procedurale sepse ata nuk mund të gjenin salla të lira më herët. Vetëm dy salla gjyqi janë në dispozicion, dhe të dyja përdoren si nga Departamenti i Specializuar edhe Departamenti Penal i Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

Për më tepër, Prokuroria Speciale duhet gjithashtu të pajiset me ambiente të përshtatshme dhe të sigurt për të siguruar që prokurorët të jenë të sigurt kur hetojnë dhe ndjekin grupet e organizuara kriminale.

Ndërsa ndërtimi i ambienteve të reja do të kërkojë kohë, Projekti nxit Qeverinë të korrigjojë këto probleme sa më shpejt të jetë e mundur duke gjetur një zgjidhje të përkohshme por të menjëhershme për të adresuar nevojat e Prokurorisë Speciale dhe Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

Autoritetet kombëtare duhet të përkufizojnë dhe t'u japin përparësi çështjeve KOK të nivelit të lartë:

i. Ministria e Drejtësisë duhet të miratojë aktet nënligjore për të përkufizuar çështjet KOK për qëllime statistikore dhe politikëbërjeje. Për të njëjtat qëllime, ajo duhet të miratojë kritere shtesë për të dalluar çështjet korrupsionit dhe krimin të organizuar të nivelit të lartë nga çështjet “standarde” të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

ii. Në bazë të sistemit të kategorizimit, Prokuroria Speciale dhe Gjykata e Lartë në Podgoricë duhet të kenë parasysh:

- T'i japin përparësi ndjekjes dhe gjykimit të çështjeve KOK të nivelit të lartë, duke përfshirë miratimin e planeve të punës për trajtimin e këtyre çështjeve.
- Të projektojnë çështjet KOK të nivelit të lartë për të shpërndarë burime të përshtatshme te Prokuroria Speciale dhe Gjykata e Lartë, që janë më të përfshira në trajtimin e tyre.
- Të sigurojnë që kriteret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të reflektojnë në mënyrë të përshtatshme sfidat e veçanta të trajtimit të çështjeve KOK të nivelit të lartë.

Në Strategjinë për Ballkanin Perëndimor të vitit 2018, Komisioni Evropian theksoi se rruga drejt zgjerimit kërkon vendosjen në mënyrë urgjente të “një bilanci konkret dhe të vazhdueshëm të përballjes me korrupsionin, pastrimin e parave dhe krimin e organizuar”.¹²³

Parakushti për krijimin e këtij bilanci është vendosja e një sistemi kategorizimi të përshtatur mirë dhe të

besueshëm për të identifikuar çështjet KOK dhe çështjet KOK të nivelit të lartë.

Kategorizimi i çështjeve KOK dhe KOK të nivelit të lartë së paku do të lejojë institucionet e vendit të krijojnë statistika të konsoliduara për trajtimin e këtyre çështjeve, duke lehtësuar matjen e progresit ose regresit për krijimin e bilancit të lartpërmendur.

¹²³ [Balkans_BorchureA5_V7.indd \(europa.eu\)](#), faqe 5

Ligjet që përcaktojnë kompetencën lëndore të Prokurorisë Speciale dhe Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë nuk ofrojnë përkufizime të përshtatshme se çfarë duhet të konsiderohet si krim i organizuar ose korrupsion i nivelit të lartë.

Në fakt, kjo kompetencë mbulon çdo lloj çështjeje të krimit të organizuar, pavarësisht seriozitetit të tij, si dhe veprat e lidhura me korrupsionin të kryera nga çdo zyrtar publik, pavarësisht nga pozicioni i autorit dhe shuma e fitimit ose dëmit të paligjshëm.

Si rezultat, statistikave e bazuara në numrin e çështjeve të trajtuara nga organet e posaçme nuk reflektojnë numrin real të çështjeve KOK të nivelit të lartë të trajtuara në Malin e Zi. Për këto arsye, autoritetet kombëtare duhet të miratojnë kritere të posaçme për përcaktimin e këtyre çështjeve pavarësisht nga kuadri ligjor penal dhe veçanërisht për qëllimet politikëbërëse.

Kriteret në fjalë duhet të përfshijnë tiparet thelbësore të një çështjeje të

nivelit të lartë sa i përket seriozitetit dhe kompleksitetit, dhe njëkohësisht të jenë mjaftueshëm të qarta dhe të lehta për t'u zbatuar.¹²⁴

Ky sistem kategorizimi mund të përdoret për t'i dhënë përparësi ndjekjes dhe gjykimit të çështjeve KOK të nivelit të lartë dhe për të rishpërndarë burimet njerëzore dhe materiale aty ku janë më të nevojshme.

Mund të parashikohen objektiva të veçantë për trajtimin e këtyre llojeve çështjesh në planet vjetore të punës të Gjykatës së Lartë në Podgoricë dhe Prokurorisë Speciale.

Së fundi, kriteret e vlerësimit të performancës për gjyqtarët dhe prokurorët duhet të reflektojnë punën dhe sfidat e shtuara nga çështjet KOK të nivelit të lartë, duke marrë parasysh se këto çështje ushtrojnë më shumë presion te gjyqtarët, kërkojnë njohuri të specializuara dhe janë shpesh më të ndërlikuara dhe përfshijnë një numër të madh të pandehurish.

¹²⁴ Kriteret e miratuara nga gjyqësori në Bosnjë-Hercegovinë për këtë qëllim mund të përbëjnë një model të mirë nga Ballkani Perëndimor; shih UasXoWOPUpr7dDuta69ZNpWy9RHhOZvfFMN4glwl.pdf (usaidjaca.ba)

Të përforcohen kapacitetet e prokurorëve dhe gjyqtarëve për të trajtuar çështjet e pastrimit të parave në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në veçanti:

i. Gjykata Supreme dhe PSSH-ja duhet të krijojnë një grup pune për të hartuar udhëzime për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e veprave të pastrimit të parave. Këto udhëzime duhet të heqin çdo paqartësi në zbatimin e dispozitave, veçanërisht nëse pastrimi i parave mund të ndiqet si vepër individuale (d.m.th., pa ndjekur veprën paraprake), gjithashtu duke marrë parasysh qëndrimin e ardhshëm juridik të Gjykatës Supreme të sugjeruar në Rekomandimin 14 më poshtë.

ii. Qendra për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe të Prokurorisë, në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale dhe Departamentin e Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë, duhet të krijojnë një program të posaçëm për prokurorët e përfshirë në trajtimin e çështjeve të pastrimit të parave.

iii. Prokuroria Speciale, në bashkëpunim me Njësinë e Inteligjencës Financiare (NJIF), duhet të nxjerrin një regjistër të përditësuar të tipologjive të pastrimit të parave. Regjistri mund të gjurmojë tipologjitë e pastrimit të parave dhe raportet e çështjeve, duke ndihmuar për të kuptuar më mirë dhe dalluar aktivitetet e lidhura me pastrimin e parave. Ai mund të frymëzohet nga praktikat më të mira të vendosura nga Misioni i OSBE-së në Serbi. Në këtë aspekt mund të kërkohej gjithashtu ndihma ndërkombëtare.

iv. Autoritetet kombëtare mund të shfrytëzojnë anëtarësimin e tyre në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit. Për shembull, NJIF-i i Malit të Zi duhet të shfrytëzojë plotësisht anëtarësimin e tij në Grupin Egmont të Njërive të Inteligjencës Financiare (EGMONT) për një shkëmbim efektiv informacioni me NJIF-të e vendeve të tjera.

Gjithashtu, duhet të shfrytëzohet më shpesh krijimi i Skuadrave të Përbashkëta Hetimore (SPH), të mbështetura nga Eurojust-i dhe/ose Europol

Ekipi i Projektit vëzhgoi se shumica e çështjeve të monitoruara me akuza për pastrim parash ndiqeshin njëkohësisht me një vepër pararendëse. Gjatë konsultimeve, prokurorët konfirmuan se ata nuk ndiqnin individualisht veprat e pastrimit të parave, pasi ata duhet të dinin saktësisht çfarë veprë pararendëse e sillte fitimin. Ata gjithashtu ranë dakord se nuk kishte një konsensus për kuptimin e termit “aktivitet kriminal” në nenin 268 të Kodit Penal. Vlen të përmendet se, sipas standardeve ndërkombëtare përkatëse, veçanërisht rekomandimeve të Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF) dhe të Konventës së Varshavës, dënimi i mëparshëm ose i njëkohshëm për veprën penale pararendëse nuk duhet të jetë parakusht për një dënim për pastrim parash. Si rrjedhojë, për të provuar që prona përbën produkt të veprës penale, nuk është e nevojshme që prokurorët të përcaktojnë saktësisht se cila vepër penale solli përfitim të pronës.¹²⁵ Në të njëjtën mënyrë, Gjykata Supreme e Spanjës vendosi se nuk ishte e nevojshme të përcaktohen të gjitha elementet faktike të veprës penale

pararendëse në çështjet e pastrimit të parave, duke lejuar provimin përmes provave të tërthorta ose rrethanore.¹²⁶ U vendosën tri kritere për këto prova: rritje pasurie të pashpjeguara ose transaksione të pazakonta, mungesë aktiviteteve të ligjshme që shpjegojnë këto rritje dhe lidhje me aktivitet kriminal (të tilla si lidhja me hetime penale ose regjistra kontabël të pazakontë). Në mënyrë të ngjashme, Gjykata e Apelit e Amsterdemit krijoi një plan me disa hapa për të provuar pastrimin e parave nëse vepra pararendëse është e panjohur, e mbështetur nga një tipologji nga NJIF-ja që përmbante aktivitete treguese të pastrimit të parave.¹²⁷ Deri tani, Projekti identifikoi një çështje të vetme me akuza individualisht për pastrim parash – pa vepër penale pararendëse – për monitorim. Megjithatë një risi në kontekstin e praktikës gjyqësore malazeze, kërkesa për gjykim u pranua dhe do të ofrojë një mundësi për të marrë parasysh ndjekjen dhe gjykimin e kësaj veprë në Malin e Zi sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare dhe praktikave më të mira nga jashtë.

¹²⁵ GJEDNJ-ja vendosi në çështjen Zschüschen kundër Belgjikës (kërkesa [23572/0723572/0723572/07](https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=002-11638https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=002-11638https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=002-11638)), e disponueshme në <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=002-11638https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=002-11638https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=002-11638>) që dënimi për pastrim parash pa një vepër penale pararendëse të njohur është i vlefshëm sipas Konventës së Varshavës. Gjykata e konstatoi të drejtë që të dyshuarit janë të detyruar të japin shpjegime të besueshme për pasuritë e tyre dhe i qëndroi mendimet se barra e provës nuk zhvendosej tek i akuzuari, rrjedhimisht neni 6 i KEDNJ-së nuk shkelej.

¹²⁶ Gjykata Supreme e Spanjës, STS 1509/2016 - ECLI:ES:TS:2016:1509, 29.03.2016., available at [Consejo General del Poder Judicial: Buscador de contenidos](https://www.consejo-general-del-poder-judicial.es/buscar/contenidos).

¹²⁷ Gjykata e Apelit e Amsterdemit, ECLI:NL:GHAMS:2013:BY8481, 11.03. 2013, e disponueshme në [Rechtspraak.nl - Search in rulings](https://rechtspraak.nl/-/search-in-rulings) (uitspraken-rechtspraak.nl.translate.google).

Të përmirësohet cilësia e kërkesave për gjykim, në veçanti:

- i. PSSH-ja duhet të krijojë një grup pune për të hartuar udhëzime për cilësinë e kërkesave për gjykim. Udhëzimet duhet të jenë didaktike, të përmbajnë shembuj të mirë ose praktikat më të mira, dhe të ofrojnë një strukturë rekomanduese ose model për të orientuar prokurorët për paraqitjen e çështjeve të tyre në kërkesën për gjykim. Për më tepër, PSSH-ja duhet të krijojë një Databazë Kërkesash me kërkesa për gjykim të hartuara mirë për të shërbyer si shembuj për referencë të ardhshme, që duhet të përditësohet rregullisht.
- ii. Trupi Gjykses për Kontrollin e Kërkesës për Gjykim duhet të sigurojë që kërkesat për gjykim që nuk përputhen me kriteret ligjore të nevojshme të mos pranohen.
- iii. Qendra për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe të Prokurorisë duhet të fillojë një program trajnimi efektiv për hartimin juridik për prokurorët. Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë formës dhe arsyetimit të kërkesave për gjykim.
- iv. Këshilli i Prokurorisë duhet të rishikojë treguesin e performancës në lidhje me cilësinë e vendimeve të shkruara në sistemet e menaxhimit të performancës për prokurorët në mënyrë që të krijojë stimul shtesë për kërkesat cilësore për gjykim.

Ekipi i Projektit evidentoi mangësi të ndryshme me kërkesat për gjykim të shqyrtuara në të paktën 26 raste. Këto përfshinin ndër të tjera akuza të pambështetura, shpjegim të pamjaftueshëm të lidhjes ndërmjet provave dhe akuzave, arsyetim të mangët në lidhje me çdo element të veprës penale dhe mungesë

lexueshmërie dhe qartësie. Për më tepër, niveli i arsyetimit dhe stili i shkrimit ndryshonin në mënyrë të konsiderueshme nga rasti në rast, ndërsa arsyetimit shpesh i mungonte një parashtrim analitik i akuzave dhe përfundimi i prokurorit.

Gjatë seancave në gjykim në themel, gjykata shpesh kishte vështirësi për të përcaktuar disa nga faktet kyçe të çështjes, ndërsa prokuroria rregullisht nuk demonstronte si lidheshin këto fakte me akuzat e parashtruara në kërkesën për gjykim.

Përpjekjet për t'u thelluar në elemente të veçanta të veprës, veçanërisht në anën subjektive, gjithashtu rezultuan sfiduese në çështjet e korrupsionit. Për kërkesat për gjykim me akuza për krimin e organizuar, ekipi i Projektit vërejti në të paktën dhjetë kërkesa që prokurorët nuk arsyetonin se si i përmbushte kriteret e nenit 401/a të KPP-së një grup kriminal.

Disa nga gjyqtarët e konsultuar nga Projekti e pranuan këtë, dhe u shprehën se duhet t'i jepet vëmendje e veçantë cilësimit të veprës penale nga neni 401/a i KPP-së sepse mosprovimi i të gjitha elementeve të saj mund të çojë në pushimin e akuzave ose lirime. Në tri çështje me vendime lirimi të shkallës së parë, Projekti vëzhgoi mangësitë e renditura më lart, që mund të kenë kontribuar te rezultati.

Për këto arsye, udhëzimet për cilësinë e kërkesave për gjykim mund të ndihmojnë prokurorët të hartojnë kërkesa për gjykim më cilësore. Udhëzimet duhet të theksojnë rëndësinë e parashtrimit të arsyeve si element kyç i një kërkesë për gjykim dhe të këshillojnë se si të kryhet në mënyrën më të mirë.

Ato duhet gjithashtu të ndihmojnë kryesisht prokurorin në lidhjen e provave me akuza të veçanta në mënyrë që parashtrimi i akuzave të jetë sa më i saktë të jetë e mundur.¹²⁸

Për më tepër, trupi gjykues për kontrollin e kërkesës për gjykim duhet të jetë më efektiv në shqyrtimin gjyqësor. Gjatë periudhës së raportimit, trupi gjykues nuk vendosi për vlefshmërinë e provave të caktuara për disa raste në çështjet në monitorim, pavarësisht se mbrojtja u shpreh për pavlefshmërinë e tyre. Ky problem ishte veçanërisht i dukshëm në çështje ku kërkesa për gjykim bazohej gjerësisht në të dhëna të marra nga aplikacione mesazhesh të enkriptuara. Në disa çështje, një provë u deklarua e pavlefshme në një fazë të mëvonshme gjatë gjykimit, pavarësisht se mbrojtja kishte shprehur pavlefshmërinë e saj gjatë fazës së kontrollit të kërkesës për gjykim. Ky problem u ngrit gjithashtu nga prokurorët dhe avokatët e konsultuar nga ekipi i Projektit. Të dyja palët pretenduan se kishte rëndësi kritike që gjyqtarët të kontrollonin ligjshmërinë e provave gjatë fazës së kontrollit të kërkesës për gjykim për të shmangur pranimin e kërkesave të mangëta.

Për të qartësuar që kjo është detyra e trupit gjykues për kontrollin e kërkesës për gjykim, Gjkata Supreme duhet të nxjerrë një qëndrim siç propozohet në Rekomandimin 14.

¹²⁸ Shih një shembull këtu: <https://www.osce.org/files/f/documents/f/d/528222.pdf>, faqet 93-94

Kërkesat më cilësore për gjykim mund të arrihen gjithashtu duke ndryshuar kriteret për vlerësimin e cilësisë së punës së prokurorëve. Në këtë aspekt, ekipi i Projektit vëzhgoi se të gjithë treguesit ekzistues janë të një natyre sasiore, pra, prokurorët vlerësohen në bazë të përqindjes së kërkesave për gjykim të konfirmuara dhe vendimeve të dënimit.

Për të arritur një vlerësim më të rëndësishëm të punës së tyre, Këshilli i Prokurorisë duhet të hartojë kriterë objektive në bazë të së cilave do të vlerësojë cilësinë e arsyetimit në kërkesat për gjykim dhe aktet e tjera. Nevoja për këtë ndryshim u njoh gjithashtu nga prokurorët dhe anëtarët e Këshillit të Prokurorisë gjatë konsultimeve.

12

Rekomandim

Të përmirësohet cilësia e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, veçanërisht vendimeve dhe disponimeve që urdhërojnë dhe zgjatin paraburgimin:

i. Gjykata Supreme duhet të krijojë një grup pune për të hartuar udhëzime për cilësinë e vendimeve dhe disponimeve të tjera gjyqësore, veçanërisht për masat e lidhura me paraburgimin ose të tjera. Udhëzimet duhet të jenë didaktike, të përmbajnë shembuj të mirë ose praktikat më të mira, dhe të ofrojnë një strukturë të rekomanduar ose model për të orientuar gjyqtarët për paraqitjen e arsyetimit të tyre në vendimet/disponimet gjyqësore.

ii. Këshilli Gjyqësor duhet të rishikojë treguesin e performancës në lidhje me cilësinë e vendimeve gjyqësore në sistemet e menaxhimit të performancës për gjyqtarët, duke integruar këto udhëzime të reja në procesin e vlerësimit. Për më tepër, sigurimi i trajnimit të komisionit vlerësues për zbatimin e këtyre standardeve të reja është gjithashtu i rëndësishëm.

iii. Qendra për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe të Prokurorisë duhet të fillojë një program trajnimi efektiv për hartimin juridik për gjyqtarët. Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë formës dhe arsyetimit të vendimeve.

Projekti vëzhgoi arsyetim të pamjaftueshëm në vendimet gjyqësore në një numër çështjesh në monitorim. Në të paktën tri vendime të analizuara, gjyqtarët kryesisht transkriptonin provat e shkruara, deklaratat e dëshmitarëve ose mendimet e ekspertëve pa dhënë një parashtrim të përshtatshëm dhe analitik të provave.¹²⁹

Për më tepër, shpesh mbetej e paqartë pse gjykata kishte vendosur të mbështetej në prova të caktuara në vend të të tjerave. Gjithashtu, në të paktën katër vendime të shqyrtuara gjatë periudhës së raportimit, gjykata u përball me sfida në arsyetimin e anës subjektive si një nga elementet e detyrueshme të një vepre penale. Në të paktën 61 vendime të dhëna me MPF, gjykata u mbështet së tepërmi në rrethanat veçanërisht lehtësuese, siç deklaroheshin nga prokuroria, pa u angazhuar në reflektim kritik. Gjykatat pranuan MPF-të me sanksione të buta pa arsyetuar se pse i gjenin në përputhje me “interesin e drejtësisë”, siç kërkohet nga neni 302 (8) pika 5 i KPP-së.

Mangësitë e vëzhguara në arsyetimin e disponimeve nuk kufizoheshin te vendimet. Gjykatat gjithashtu përballeshin me sfida kur arsyetonin vendime në lidhje me urdhrin ose zgjatjen e paraburgimit, vendimet për liri me kusht dhe vendimet për gjykim në mungesë.

Vendimeve të lidhura me paraburgimin u mungonte shqyrtimi kritik i secilës prej bazave për paraburgimin, veçanërisht kur bëhej fjalë për zgjatjen e tij. Gjatë periudhës së raportimit, ekipi i Projektit vëzhgoi një rritje në vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi që konstatonin shkelje të së drejtës së lirisë së të pandehurve. Të paktën 12 vendime të këtij lloji u identifikuan në shtatë çështje.

Në tërësi, shkeljet u gjendën sepse vendimet për paraburgimin dhe refuzimin e lirisë me kusht nuk ishin arsyetuar në mënyrën e duhur. Në shumicën e rasteve, Gjykata Kushtetuese e konsideroi arsyetimin e pamjaftueshëm pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk përshkruanin rrethanat konkrete të rrezikut për arratisje nga të pandehurit. Gjithashtu, shkeljet u identifikuan pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kishin arsyetuar në mënyrën e duhur ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. Veçanërisht alarmues është fakti që Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të së drejtës së lirisë për të paktën pesë të pandehur, në katër çështje, më shumë se një herë.

Aktualisht, nuk ka standarde ose udhëzime të qarta për të vlerësuar se sa gjithëpërfshirës është argumentimi në vendimet gjyqësore. Si pasojë, Këshilli Gjyqësor duhet të zhvillojë tregues të besueshëm për të vlerësuar cilësinë e arsyetimit gjatë vlerësimit të performancës të gjyqtarëve.

¹²⁹ Neni 379 (7) i KPP-së kërkon që gjykata të tregojë qartë dhe në mënyrë shteruese se cilat fakte konsiderohen të provuara ose jo, dhe pse, me theks të veçantë te besueshmëria e provave kontradiktore.

Të përmirësohen kapacitetet gjyqësore duke përforcuar kapacitetet e këshilltarëve gjyqësorë. Në veçanti:

i. Qendra për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe të Prokurorisë duhet të zgjerojë programet e saj për këshilltarët gjyqësorë dhe të përfshijë trajnim të specializuar në rastet KOK për këshilltarët gjyqësorë që punojnë në Departamentin e Specializuar për të ndërtuar kapacitetet e tyre dhe për t'u dhënë gjyqtarëve ndihmë efektive.

ii. Gjykata e Lartë në Podgoricë duhet të mbledhë dhe të analizojë të dhëna për punën e çdo këshilltari gjyqësor. Gjithashtu, ajo duhet të rivlerësojë nevojat e saj organizative dhe të marrë parasysh kërkesat e lidhura me ngarkesën e punës për çdo gjyqtar. Në bazë të këtij vlerësimi, gjykata mund të përcaktojë numrin e kërkuar të këshilltarëve, duke përfshirë këtë informacion në planin e saj paraprak të punës.

Ekipi i Projektit mësoi gjatë konsultimeve se kishte një nevojë urgjente për të rritur numrin e këshilltarëve gjyqësorë në Departamentin e Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

Sipas vendimeve të publikuara të Gjykatës së Lartë në Podgoricë për rishpërndarjen e personelit, asnjë këshilltar gjyqësor nuk u transferua te Departamenti i saj i Specializuar në vitin 2023, pavarësisht se gjyqtarët gjatë konsultimeve pranuan se ngarkesa e punës e Departamentit ishte në nivelin më të lartë në atë periudhë.

Për të adresuar këtë problem, masat si emërimi dhe rishpërndarja e personelit gjyqësor në përputhje me nevojat e vlerësuara mund të jenë efektive. Duhet marrë gjithashtu hapa për të përforcuar ekspertizën e ndihmësve gjyqësorë, pasi vetëm një prej tyre mori trajnim të specializuar (KOK) në vitin 2022.¹³⁰

Gjithashtu, aftësia e gjyqtarëve për të organizuar dhe koordinuar punonjësit gjyqësorë është një nga kriteret në vlerësimin e tyre të performancës. Kjo aftësi vlerësohet në bazë të të dhënave të mbledhura nga sistemi për menaxhimin e çështjeve (PRIS),

¹³⁰ Raporti vjetor i Qendrës për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe të Prokurorisë për vitin 2022, faqe 15, i disponueshëm në: [Godisnji-izvjestaj-o-radu-Centra-za-obuku-u-sudstvu-i-drzavnom-tuzilastvu-za-2022.-godinu.pdf \(cosdt.me\)](#).

që gjurmon ngarkesën e punës së deleguar te këshilltarët. Ky vlerësim duhet të informojë menaxhimin e performancës së këshilltarëve duke përdorur të njëjtat të dhëna,

pasi kjo lejon marrjen e informacioneve më të përshtatshme nga gjyqtarët dhe një reflektim më të mirë të këtyre të dhënave në PRIS.

14

Rekomandim

Gjykata Supreme duhet të harmonizojë interpretimin e dispozitave penale ku përplasia e praktikave minon sigurinë juridike; siç është rasti për:

- i. Dispozitat për fushën e kontrollit gjyqësor të kërkesave për gjykim.
- ii. Dispozitat për gjykimet “në mungesë”.
- iii. Termin “aktivitet kriminal” në veprën penale të pastrimit të parave.
- iv. Termin dhe kriteret për “rrethanat veçanërisht lehtësuese” që lejojnë dënimet nën minimumin ligjor.

Sipas nenit 124 të Kushtetutës së Malit të Zi, Gjykata Supreme siguron zbatimin e njëzuar të ligjeve nga gjykatat.

Neni 26 i Ligjit për gjykatat parashikon që Gjykata Supreme nxjerr qëndrime për çështje ligjore problematike që kanë ardhur nga praktika gjyqësore, me ose pa kërkesë nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

Gjatë periudhës së raportimit, ekipi i Projektit vëzhgoi se disa norma juridike interpretoheshin dhe zbatoheshin në

mënyrë të parregullt nga prokurorët dhe gjyqtarët, duke çuar në pasiguri juridike.

Për shembull, ai konstatoi se gjyqtarët nuk kishin një konsensus për kushtet për gjykimet në mungesë. Ky problem ishte veçanërisht i dukshëm në çështjet ku ishte në pritje ekstradimi i personave të akuzuar, pasi gjyqtarët kishin qasje të ndryshme për të përcaktuar nëse kushtet për gjykim në mungesë ishin përmbushur në lidhje me këta persona të akuzuar.

Gjatë konsultimeve, gjyqtarët e pranuan sfidën dhe theksuan se qartësimi në këtë aspekt do të ishte i rëndësishëm dhe i nevojshëm. I njëjti problem vlen për pushimin e hetimeve kundër të pandehurve që janë arratisur nga vendi. Projekti vërejti se ndërsa disa prokurorë i pushonin hetimet kundër të pandehurve në arrati, të tjerët dorëzonin kërkesë duke propozuar gjykime në mungesë. Kjo qasje e parregullt u confirmua gjatë konsultimeve, ku disa prokurorë pranonin se nuk i kishin pushuar hetimet pavarësisht parashikimit të nenit 286 të KPP-së.

Ata theksuan se dispozita e mësipërme nuk ishte e qartë dhe mund të rrezikonte çështjen për shkak të afateve të parashkrimit.

Për arsyetimin për mungesën e konsensusit rreth dispozitave për fushën e kontrollit gjyqësor të kërkesave për gjykim, ju lutem konsultoni rekomandimin 11. Për arsyetimin për mungesën e konsensusit rreth termit “aktivitet kriminal”, ju lutem konsultoni rekomandimin 10 më lart. Për arsyetimin për mungesën e konsensusit rreth termave “rrethana veçanërisht lehtësuese”, ju lutem konsultoni rekomandimin 16.

15

Rekomandim

Të rishikohet koncepti dhe përdorimi i gjykimit me marrëveshje në çështjet KOK. Në veçanti:

- i. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të respektojnë udhëzimet e nxjerra nga Gjykata Supreme dhe PSSH-ja për përdorimin e MPF-ve.
- ii. Ministria e Drejtësisë duhet të analizojë dhe të shqyrtojë një instrument procedural që lehtëson bashkëpunimin ndërmjet prokurorëve dhe të pandehurve ose personave të dënuar. Kjo duhet të vendoset në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, për shembull Marrëveshjen për Dëshmi nga një Person i Dënuar në Serbi, për t’u dhënë prokurorëve një mjet të besueshëm për mbledhjen e provave nga të pandehurit.

Ekipi i Projektit vërejti se një avantazh i MPF-ve është të shpejtojë trajtimin gjyqësor të çështjeve KOK.

Nga ana tjetër, ai gjithashtu vëzhgoi raste në të cilat të pandehurve me role kyçe në grupet e organizuara kriminale u jepeshin dënime shumë të lehta me pranimin e MPF-ve, ndërsa të pandehurit e tjerë që luanin role të vogla në grupet kriminale e vazhdonin gjykimin dhe shpesh qëndronin në paraburgim për periudha të gjata kohore.

Kjo u njoh gjithashtu nga disa gjyqtarë gjatë konsultimeve, të cilët, në fakt, argumentuan kundër përfitimeve të efikasitetit. Efekti i sanksionimit të lehtë dhe shkalla shumë e ulët e konfiskimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë si rezultat i MPF-ve u theksuan si një

problematikë tjetër që lindte nga gjykimi me marrëveshje.

Për këto arsye, është pozitive që janë miratuar udhëzimet për përdorimin e kësaj praktike, dhe shpresohet që zbatimi i tyre do të çojë në përdorim më efektiv të MPF-ve.

Ekipi i Projektit gjithashtu merr parasysh që prokurorët do të përfitojnë nga një instrument procedural që do t'u lejojë të marrin informacione të dobishme për çështjen nga të pandehurit e tjerë ose personat e dënuar.

Prokurorët e konsultuar ranë dakord që krijimi i një mekanizmi të ngjashëm me Marrëveshjen për Dëshmi nga një Person i Dënuar është i dobishëm për identifikimin, provimin dhe parandalimin e çështjeve KOK.

16

Rekomandim

Të krijohet një politikë dhe praktikë frenuese më e konsoliduar për çështjet KOK. Për këtë qëllim:

- i. Gjykata Supreme duhet të miratojë udhëzime për praktikën e masës së dënimit dhe individualizimin e dënimeve, duke dhënë orientim se çfarë konsiderohet si e mesme standarde dënimi për veprat penale KOK dhe në çfarë rrethanash mund të lehtësohet ky dënim deri në minimum ose rëndohet deri në maksimumin ligjor të parashikuar në Kodin Penal.
- ii. Prokurorët e shtetit duhet të propozojnë gjithmonë llojin dhe masën e dënimit në komentet përfundimtare dhe të paraqitin arsyet që i kanë bërë të përcaktojnë këtë dënim të veçantë përpara gjykatës.

Ekipi i Projektit vëzhgoi prirjen e një praktike sanksionimi më të lehtë në Malin e Zi, që u konfirmua nga gjyqtarët dhe prokurorët gjatë konsultimeve. Ky përfundim në lidhje me politikën e sanksionimit të lehtë kryesisht vjen nga vendimet e bazuara në MPF. Megjithatë, meqenëse kjo shprehet në arsyetimin e këtyre vendimeve dhe u konfirmua nga gjyqtarët gjatë konsultimeve, politika e sanksionimit të lehtë në MPF drejtohet nga politika e përgjithshme e sanksionimit të lehtë në proceset penale të rregullta.

Projekti gjithashtu vërejtë se gjykatat priren ta theksojnë më shumë rëndësinë e rrethanave lehtësuese në dënim, duke zvogëluar ndikimin e rrethanave rënduese, pa dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të dyja rastet. Kjo u konfirmua edhe gjatë konsultimeve me përfaqësuesit e shoqërisë civile që monitoronin punën e gjyqësorit.

Udhëzimet e rekomanduara duhet të përfshijnë frenimin në sanksionet për çështjet KOK.¹³¹ Gjithashtu, udhëzimet duhet të mësojnë gjyqtarët që të japin arsyetim të veçantë si për rrethanat

lehtësuese edhe për ato rënduese,¹³² sidomos në rastet ku rrethanat janë veçanërisht lehtësuese. Për më tepër, qëndrimi juridik mund t'i orientojë gjyqtarët për masat përkatëse të sigurimit të vendosura kryesisht, krahas sanksioneve.

Prokurorët gjithashtu kanë rol të rëndësishëm për të luajtur në krijimin e praktikave të sanksionimit. Gjatë periudhës së raportimit, Projekti vëzhgoi se prokurorët rregullisht nuk merrnin përsipër të propozonin llojin dhe masën e veçantë të dënimit në komentet e tyre përfundimtare. Për më tepër, ata nuk shpjegonin rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cilat duhet të konsideronte gjykata kur përcaktonte masën e dënimit, që është detyra e tyre siç parashikohet në nenin 362 të KPP-së.¹³³

Në fakt, prokurorët ia linin gjykatës të çmonte masën e përshtatshme të dënimit, që mund të kontribuojë në politikën ekzistuese të sanksionimit të lehtë. Disa prokurorë të konsultuar pranuan që rrallëherë propozonin masën e dënimit dhe që kjo praktikë duhet të ndryshonte.

¹³¹ Shih Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, neni 11, dhe Legislative Guide for the Implementation of the Convention, paragrafët 304-310, të disponueshëm në:

https://www.unodc.org/documents/treaties/Legislative_Guide_2017/Legislative_Guide_E.pdf

¹³² Faktorët madhorë rëndues dhe lehtësues duhet të qartësohen në ligj ose praktikë ligjore. Sipas mundësisë, ligji ose praktika duhet të synojnë gjithashtu të përcaktojnë këta faktorë, të cilët nuk duhet të konsiderohen të vlefshëm për vepra të caktuara”, Këshilli i Evropës Rec. No (92) 17 në lidhje me koherencën në masën e dënimit, 1992, i disponueshëm në:

<https://rm.coe.int/16804d6ac8>

¹³³ Neni 362 (2) parashikon që prokurori në komentet përfundimtare propozon llojin dhe masën e dënimit.

Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë duhet të rivlerësojnë sistemin e menaxhimit të performancës për gjyqtarët dhe prokurorët. Objektivi duhet të jetë të sigurohet që Treguesit Kyçë të Performancës (TKP) të reflektojnë saktësisht thelbin e punës së prokurorisë ose gjyqësorit dhe të jenë të qartë gjatë vlerësimit. Në veçanti:

- i. Treguesit për vlerësimin e cilësisë së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të ndryshojnë për të përfshirë kritere cilësore, krahas treguesve sasiorë ekzistues.
- ii. Qartësia e procesit të vlerësimit duhet të shtohet duke përcaktuar qartë si duhet të vlerësohen kriteret dhe treguesit në praktikë.

Për të siguruar një përgjigje gjyqësore efektive në çështjet e ndërlikuara, vlerësimi i performancës dhe promovimi duhet të mbështeten në një qasje të bazuar në meritë dhe të kultivojnë krijimtarinë dhe shkathtësinë për të nxitur aktorët gjyqësorë që të bëjnë më të mirën. Sistemi i menaxhimit të performancës i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Malin e Zi më së shumti mbështetet në tregues pune sasiorë (statistikorë) (p.sh., përqindja e kërkesave për gjykim të pranuar për prokurorët, ose përqindja e vendimeve të konfirmuara për gjyqtarët). Nuk ka vlerësim cilësor të konsiderueshëm të përmbajtjes së këtyre vendimeve, pra, cilësia e arsyetimit të kërkesës për gjykim ose vendimit nuk shqyrtohet, siç shpjegohet në rekomandimet 11, 12 dhe 15.

Të gjithë bashkëbiseduesit ranë dakord për rëndësinë e nxjerrjes së treguesve specifikë cilësorë të performancës për të lehtësuar një proces vlerësimi më

efektiv dhe për të stimuluar gjyqtarët dhe prokurorët.

Nga ana tjetër, përshtatshmëria e kriterëve sasiorë në bazë të shkallës së vendimeve të ndryshuara për gjyqtarët, ose të apeleve të refuzuara për prokurorët, duhet të vlerësohet me kujdes me synim për të siguruar që ato nuk minojnë pavarësinë e brendshme të gjyqtarëve dhe rolin e prokurorisë në sigurimin e llogaridhënies për krimet.

Për më tepër, procesi i vlerësimit nuk duhet se është mjaftueshëm i qartë. Gjatë konsultimeve, anëtarët e Këshillave Gjyqësorë dhe të Prokurorisë, si dhe gjyqtarët dhe prokurorët, ishin të pasigurt për mënyrën e vlerësimit individual për çdo tregues.

Për të tejkaluar çdo paqartësi, si Këshilli Gjyqësor edhe ai i Prokurorisë duhet të hartojnë standarde konkrete për mënyrën e vlerësimit të çdo treguesi në praktikë.

Përdorimi i Mjeteve Gjyqësore

18

Rekomandim

Qeveria e Malit të Zi duhet të sigurojë qasjen në të dhënat e të gjithë regjistrave shtetërorë për PSSH-në.

Aktualisht, të dhënat e nevojshme për hetimet financiare efektive dhe ndjekjen e pastrimit të parave janë të fragmentuara në Malin e Zi, ku organe të ndryshme shtetërore kanë akses ekskluziv në databaza të caktuara.

Prokurorët kanë qasje të drejtpërdrejtë vetëm në disa databaza të institucioneve shtetërore. Edhe në këto raste, ata ndonjëherë përsëri duhet të dorëzojnë kërkesa formale për të marrë të dhënat në formën e provave, pavarësisht qasjes së drejtpërdrejtë. Konsultimet e ekipit të Projektit theksuan se prokurorët përballen me shumë sfida të lidhura dhe shpesh e kanë të pamundur të marrin ose analizojnë informacione të rëndësishme.

Megenëse databazat ekzistuese janë të shpërndara në platforma të ndryshme elektronike, dhe njësimi i të gjitha të dhënave në një databazë të vetme nuk duket se është i mundshëm

në kuadrin afatshkurtër, Qeveria e Malit të Zi duhet të sigurojë qasjen tek informacionet e nevojshme për të gjithë prokurorët e PSSH-së, si dhe për hetuesit e tyre financiarë.

Kjo qasje duhet të jetë e plotë, shteruese dhe e pakufizuar, duke lejuar një hetim dhe analizë gjithëpërfshirëse të të dhënave

Në kuadrin afatgjatë, Qeveria e Malit të Zi duhet të njësojë databazat ekzistuese në një sistem të vetëm. Gjatë konsultimeve, grupet e interesit informuan Projektin që janë ndërmarrë hapat fillestarë drejt përmbushjes së këtij objekti; megjithatë, prokurimi publik i këtyre shërbimeve nuk ka mundur të sjellë rezultate. Ndihma ndërkombëtare mund të jetë e nevojshme të kërkohe në këtë drejtim, pasi PSSH-së duhet t'i sigurohet qasja te databazat e njësuar.

Të përforcohen kapacitetet e prokurorëve për të kryer hetime financiare në çështjet KOK.

- i. Qendra për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe të Prokurorisë duhet të zhvillojë dhe ofrojë trajnim efektiv për prokurorët e specializuar për kryerjen e hetimeve financiare.
- ii. Këshilli i Prokurorisë duhet të hartojë një plan strategjik për t'u siguruar që Shërbimi i Prokurorisë, në veçanti në PSSH, të ketë në dispozicion një personel ekspertësh të aftë për të kryer hetime financiare të ndërlikuara.
- iii. Këshilli i Prokurorisë duhet të shqyrtojë përfshirjen e rezultateve të lidhura me konfiskimin e zgjeruar te kriteret për vlerësimin e prokurorëve.

Ekipi i Projektit analizoi të dhëna statistikore për hetimet financiare dhe rezultatet e tyre në çështjet në monitorim dhe konstatoi se hetimet financiare janë filluar në shumicën e rasteve. Megjithatë, rastet e ngrirjes ose sekuestrimit të pasurive ishin shumë të kufizuara, pavarësisht se dëmi ose fitimi në disa çështje të monitoruara shkonte në miliona euro.

Duke parë nga një anë shkallën e lartë të hetimeve financiare dhe nga ana tjetër numrin e ulët të çështjeve me pasuri të sekuestruara, ngrihen shqetësime në lidhje me kapacitetet e

prokurorëve për të filluar dhe kryer efektivisht hetime financiare, me synimin përfundimtar konfiskimin e zgjeruar.

Pas konsultimeve me prokurorët dhe hetuesit financiarë, ekipi i Projektit arriti në përfundimin që arsyeja e shkallës së ulët të konfiskimit të pasurive ishte cilësia e dobët e hetimeve financiare dhe numri tejet i kufizuar i hetuesve financiarë të kualifikuar në PSSH, ndërsa autorët e akuzuar shpesh duken shumë më të aftë në fshehjen e fitimeve të paligjshme.

Për shembull, prokurorët në mënyrë të përsëritur u shprehën se ekspertët financiarë të kualifikuar nuk mund të motivoheshin nga pagat aktuale për t'iu bashkuar shërbimit të prokurorisë ose për të ofruar shërbimet e tyre për një periudhë të gjatë.

Si rrjedhim, Këshilli i Prokurorisë duhet të shqyrtojë krijimin e kushteve më të favorshme dhe tërheqëse të punës për hetuesit financiarë.

Gjatë konsultimeve, prokurorët gjithashtu pranuan se trajnimi që kishin bërë për hetimet financiare dhe konfiskimin e pasurive kishte dobi të kufizuar për zbulimin e pronave të paligjshme dhe të fshehura mirë të kriminelëve.

Si pasojë, trajnimet e ardhshme duhet të marrin formën e ushtrimeve praktike dhe të përshtaten për të përfshirë zbatimin e praktikave më të mira në kontekstin malazez.

Për më tepër, PSSH-ja duhet të marrë parasysh organizimin e një grupi të brendshëm pune për të nxjerrë

mangësitë e hetimeve financiare dhe konfiskimit të pasurive dhe të zhvillojë një skemë të standardizuar për procesin e hetimeve financiare, konkretisht një udhëzues për çdo hap deri në konfiskim, duke filluar nga momenti i identifikimit të një pasurie gjatë hetimeve financiare.

Thellimi në të gjitha mënyrat dhe mjetet e mundshme për të identifikuar burimin e fundit (të paligjshëm) të pasurive (duke përfshirë analizimin e zinxhirit të konvertimeve dhe transfertave në drejtim të kundërt) do të kontribuojë në sigurimin e konfiskimeve efektive në të ardhmen. PSSH-ja duhet të fillojë të përdorë në mënyrë aktive rrjetet joformale ekzistuese për të bërë shkëmbime për hetimet financiare dhe rikuperimin e pasurive.

Projekti gjithashtu konsideron faktin që prokurorët do të nxiten më shumë për të ndjekur konfiskimin e zgjeruar nëse rezultatet e arritura do të merreshin parasysh gjatë vlerësimit të tyre. Disa anëtarë të konsultuar të Këshillit të Prokurorisë ranë dakord që ky ndryshim i kriterëve të vlerësimit mund të jetë i dobishëm.

IX. Maqedonia e Veriut

Hyrje

Maqedonia e Veriut ka arritur njëfarë progresi në hetimin dhe ndjekjen e çështjeve KOK. Ndryshimet ligjore të nevojshme për korrigjimin e problemeve praktike që lindin në proceset gjyqësore janë kritike për gjykimin efektiv të çështjeve KOK.

Misioni i OSBE-së në Shkup mbështet hartimin e ndryshimeve ligjore shumë të nevojshme në KPP nga Grupi i Punës i ngritur nga Ministria e Drejtësisë, të cilat duhet të ndihmojnë për trajtimin më të mirë të çështjeve KOK. Këto projektndryshime përputhen me gjetjet e Projektit dhe do të ndihmojnë për të zgjidhur disa probleme të diskutuara në rekomandimet më poshtë. Në mënyrë të ngjashme, zhvillimet e fundit pozitive në kuadrin rregullator të lidhur me rikuperimin e pasurive duhet të inkurajojnë të gjitha institucionet kompetente për të bërë përpjekje më serioze për të rritur numrin e konfiskimeve.

Megjithatë, besimi i ulët i publikut në gjyqësor vazhdon, ndër të tjera, për shkak të zvarritjeve të çështjeve gjyqësore, mungesës së llogaridhënies nga aktorët gjyqësorë dhe konfiskimet e kufizuara të produkteve të veprës penale.

Fushat shqetësuese kyçe janë probleme sistematike si kapacitetet dhe burimet e kufizuara, menaxhimi joefikas i

çështjeve, vonesat në emërimet ose promovimet gjyqësore, mangësitë në shkëmbimin ndërinstitutional të informacioneve dhe menaxhimi i papërshtatshëm i performancës.

Këto sfida ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në efektivitetin e përgjithshëm të gjyqësorit, ngadalësojnë ritmin e çështjeve KOK të nivelit të lartë dhe kontribuojnë në problemin e perceptimit të pavarësinë dhe paanshmërisë.

Për më tepër, shumica e këtyre problemeve mbivendosen dhe përforcojnë njëra-tjetrën. Për shembull, keqmenaxhimi i çështjeve çon në çështje gjyqësore të tejzgjatura dhe ngre dyshime për drejtësinë e procesit. Problemet e kapacitetit me prokurorët publikë – veçanërisht kërkesat për gjykim me cilësi të dobët, hetimet financiare të pamjaftueshme dhe shkalla e ulët e konfiskimeve – mund të ngrenë shqetësime për paanshmërinë. Gjithashtu, Prokuroria Publike Themelore për Ndjekjen e Çështjeve KOK (PPTH KOK) ka mungesa në burime njerëzore dhe financiare – veçanërisht për personelin administrativ dhe ekspertët financiarë – si dhe në lidhje me një softuer të integruar për menaxhimin e fluksit të çështjeve, duke penguar llogaridhënien në çështjet KOK të nivelit të lartë.

Ndërsa mungesa e efikasitetit – në veçanti kohëzgjatja e çështjeve gjyqësore – mbetet si problematikë, Projekti vërejti disa përmirësime, si seanca më të shpeshta dhe parashtrime provash dokumentare të përmirësuara nga të dyja palët. Gjithashtu, Gjykata Penale Themelore e Shkupit (GJPTH-ja e Shkupit) vazhdon të nxitë transparencën duke nxjerrë njoftime të rregullta në faqen e saj të internetit dhe duke ofruar qasje të lehtë tek informacionet e rëndësishme për çështjet KOK të nivelit të lartë.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gjykata Supreme) gjithashtu nxori një qëndrim juridik parimor që gjykatat duhet të publikojnë vendimet jopërfundimtare dhe disponimet, veçanërisht në çështjet me interes publik. Kjo nxitë GJPTH-në e Shkupit dhe Gjykatën e Apelit të Shkupit të fillonin anonimizimin dhe publikimin e vendimeve jopërfundimtare në çështjet KOK të nivelit të lartë.

Megjithatë, ndryshimet e fundit në KP çuan në mbylljen e shumë çështjeve KOK të nivelit të lartë, që përkeqësoi perceptimin e pandëshkueshmërisë nga shoqëria.

Si rrjedhim, të gjitha institucionet e përfshira në trajtimin e çështjeve KOK duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të siguruar llogaridhënien dhe administrimin efektiv të drejtësisë.

Progresi i mirëfilltë kërkon një angazhim afatgjatë nga grupet e interesit për të adresuar elementet joefikase sistemike që e bëjnë joefektiv trajtimin e çështjeve serioze KOK.

Në këto rrethana, Projekti propozon 12 rekomandime në lidhje me drejtësinë, efikasitetin, kapacitetin dhe konfiskimin, për të shërbyer si bazë për veprim të menjëhershëm dhe për të mbështetur politikën institucionale

Të rritet niveli i transparencës në gjyqësor, veçanërisht në administrimin e drejtësisë për çështjet KOK të nivelit të lartë:

- i. Ministria e Drejtësisë duhet të fillojë ndryshimet për të përshtatur Ligjin për menaxhimin e fluksit të çështjeve me KPP-në, në veçanti sa i përket mundësisë së publikimit të vendimeve gjyqësore jopërfundimtare.
- ii. Prokuroritë publike duhet të publikojnë kërkesat për gjykim të pranuar në çështjet KOK të nivelit të lartë me të gjitha të dhënat personale të anonimizuar.
- iii. Këshilli i Buxhetit Gjyqësor dhe Prokuroria Publike Shtetërore duhet të mbështetin zhvillimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe sistematike për anonimizimin e duhur të akteve gjyqësore.
- iv. Ministria e Drejtësisë dhe Gjykata Supreme, në koordinim me kryetarët e gjykatave, duhet të përmirësojnë kapacitetet teknike të sistemit të orareve të seancave gjyqësore për të siguruar përditësime në kohë dhe për të ofruar informacione të sakta për publikun.
- v. Kryetarët e gjykatave, në bashkëpunim me OSHC-të përkatëse dhe Këshillin e Medias Gjyqësore, duhet të publikojnë lajme të rregullta që përmbajnë informacione për çështjet me interes publik, si dhe artikuj tematikë dhe analitikë.
- vi. Kryetarët e gjykatave dhe të prokurorive publike duhet të sigurojnë shpërndarjen transparente dhe në kohë të informacioneve

duke mbajtur zyra funksionale për marrëdhëniet me publikun.

vii. Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë dhe Këshilli Gjyqësor i Medias duhet të vazhdojnë me zbatimin efektiv të trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarët, prokurorët dhe personelin gjyqësor se si të komunikojnë në mënyrë efektive me publikun në lidhje me çështjet e tyre.

Projekti vërejti pengesa që frenonin transparencën, veçanërisht në lidhje me publikimin e akteve gjyqësore, seancave dhe ndarjen e informacionit të bazuar në të dhëna.

Marrja e vendimeve me shkrim është sfiduese për shkak të dispozitave ligjore të mbivendosura. Në veçanti, sipas Ligjit për gjykatat dhe Ligjit për menaxhimin e fluksit të çështjeve, gjykatat ndalohen të ndajnë publikisht vendimet me shkrim nëse nuk janë përfundimtare. Kjo është në kundërshtim me KPP-në, që parashikon që të gjitha vendimet gjyqësore duhet të bëhen të disponueshme publikisht në formë elektronike ose të shtypur.¹³⁴

Mospërputhja ndërmjet dy ligjeve u adresua pjesërisht nga qëndrimi juridik parimor i Gjykatës Supreme nga dhjetori 2022, që lejon publikimin e vendimeve dhe disponimeve jopërfundimtare, veçanërisht në çështjet me interes publik.¹³⁵

Megjithatë, ai u referohet çështjeve me interes publik si një kategori që nuk parashikohet me ligj ose akte të tjera juridike të institucioneve gjyqësore. Kjo lejon gjykatat të interpretojnë dhe të zbatojnë vendimin sipas konceptimit të tyre të interesit publik, që nuk përputhet gjithmonë me interesin real të publikut.

Në lidhje me prokurorinë, është e rëndësishme të përmendet që ajo e informon rregullisht publikun për kërkesat për gjykim të dorëzuara në çështjet me interes publik duke publikuar një përmbledhje akuzash në faqen e saj të internetit. Megjithatë, ky informacion nuk është i mjaftueshëm për gazetarët, përfaqësuesit e OSHC-ve dhe ekspertët juridikë për të kryer një analizë shteruese, ose për t'i dhënë medias një bazë për raportim objektiv.

Duke marrë parasysh që prokuroria publike njeh rëndësinë e informimit të publikut duke ndarë të dhëna

¹³⁴ Neni 126 i KPP-së (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr.150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18).

¹³⁵ Sipas Ligjit për gjykatat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr.58/06, 62/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18 dhe 96/19), një nga kompetencat e Gjykatës Supreme është të përcaktojë, me miratim nga Seanca e saj e Përgjithshme, qëndrimet e përgjithshme dhe mendimet juridike për çështjet me rëndësi për sigurimin e zbatimit të njësuar të ligjeve nga gjykatat. Shih: [Начелен+став+-+објавување+на+неправосилни+одлуки.pdf \(vsrm.mk\)](#).

menjëherë pas dorëzimit të kërkesës për gjykim, Projekti rekomandon publikimin e tekstit të plotë të kërkesave të pranuar për gjykim në çështjet KOK të nivelit të lartë. Kjo masë synon të parandalojë keqinterpretimin dhe shpërdorimin e informacionit. Meqë seancat janë publike dhe kanë vëmendje mediatike të konsiderueshme, si dhe janë objekt monitorimi nga OSCH-të, nuk mund të argumentohet se kjo do të shkelte të drejtën e prezumimit të pafajësisë.

Gjykatat dhe prokuroritë publike gjithashtu përballen me vështirësi në trajtimin e akteve gjyqësore për t'i bërë ato drejtpërdrejt të disponueshme për shkak të burimeve njerëzore të pamjaftueshme të nevojshme për anonimizimin e tyre.

Kjo situatë lind nga kërkesat ligjore që synojnë mbrojtjen e të dhënave personale. Projekti mori kërkesa për gjykim pas kërkesave ndaj prokurorisë, por vetëm pas anonimizimit të tyre, që kërkoji kohë të konsiderueshme. Vlen të përmendet që GJPTH-ja e Shkupit mbështetej në një anonimizim pjesërisht të kontraktuar përmes një projekti të mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup në bashkëpunim me OSHC-në "Koalicioni Të Gjithë për Procese të Rregullta".

Për këto arsye, është e qartë që Këshilli i Buxhetit Gjyqësor dhe Prokuroria Publike – në përputhje me kompetencat e tyre – duhet të rivlerësojnë shpërndarjen e burimeve për personel

të përshtatshëm për anonimizimin në mënyrë të tillë që të sigurojë qëndrueshmërinë.

Oraret aktuale të seancave gjyqësore publikohen në një pjesë të dedikuar të faqeve të internetit të gjykatave. Megjithatë, informacioni përmban vetëm numrin e çështjes dhe kryetarin e trupit gjykues, që e bën të vështirë për publikun të mësojë rreth një çështjeje të caktuar pa njohur numrin e çështjes. Kjo mund të zgjidhet thjesht nëse në orarin e seancave tregohen emri i çdo të pandehuri, inicialet, dhe vepra ose veprat penale përkatëse. Për më tepër, Projekti vërejti se ndryshimet pasuese në orare nuk përditësoheshin.

Megjithëse të dyja çështjet kërkojnë rregullime të vogla teknike në sistemin informatik të gjykatës, ato do të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në transparencën e gjyqësorit.

Ministria e Drejtësisë dhe Gjykata Supreme janë përgjegjëse për të ofruar kushtet e nevojshme teknike për përmirësimin e sistemit të publikimit të orareve gjyqësore dhe për funksionalitetin e përgjithshëm të portalit gjyqësor. Për më tepër, ato duhet të sigurojnë që platforma që përdoret për publikimin e vendimeve të ketë kapacitetin e nevojshëm teknik për t'i akomoduar këto ndryshime.

Ndërsa GJPTH-ja e Shkupit publikon rregullisht informacionet e rëndësishme me përditësime për proceset gjyqësore me interes publik, Gjykata e Apelit e

Shkupit publikon një numër të kufizuar njoftimesh me përmbajtje të paqartë. Roli i kryetarëve të gjykatave është gjithashtu kritik në këtë aspekt dhe duhet të përforcohet më tej sipas Mendimit të KKGJE-së Nr. 19 (2016).¹³⁶

Për më tepër, rritja e bashkëpunimit me OSHC-të në lidhje me përgatitjen dhe publikimin e të dhënave analitike për çështjet me interes publik, duke përfshirë vendimet në këto çështje, do të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e besimit të gjykatat.

Kjo mund të bëhet pa burime të konsiderueshme, ndër të tjera përmes

publikimit të lajmeve periodike dhe raporteve dhe grafikëve analitikë, ndërsa Këshilli Gjyqësor i Medias mund të luajë një rol në promovimin e tyre.

Gjatë konsultimeve të Projektit, gjyqtarët theksuan nevojën për të zhvilluar më tej aftësitë e tyre rreth marrëdhënieve me publikun.

Megjithëse Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë ofron trajnim bazë në këtë fushë si pjesë e programit të rregullt të trajnimit, ka një mundësi të konsiderueshme për të thelluar më tej njohuritë për këto tema përmes bashkëpunimit me Këshillin Gjyqësor të Medias.

2

Rekomandim

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të mbrojnë gjyqtarët dhe prokurorët publikë nga të gjitha format e presionit politik dhe ndërhyrjet e tjera, duke mbrojtur pavarësinë e gjyqësorit por gjithashtu duke siguruar llogaridhënien e tij. Ata duhet të veprojnë kështu duke:

- i. Zhvilluar procedura standarde për monitorimin, raportimin dhe dënimin publik të çdo cenimi ose ndërhyrjeje të tentuar në pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.
- ii. Hartuar përfundime të vetëvlerësuarra për të përmirësuar drejtësinë dhe për të rritur transparencën në lidhje me zgjedhjet, promovimet dhe rezultatet e procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë. Gjithashtu, ajo duhet të publikojë vendime që japin arsyetim të detajuar.

¹³⁶ The CCJE (2016)2REV2 (coe.int) shprehet që "...në marrëdhëniet e tyre me median, kryetarët e gjykatave duhet të kenë parasysh që interesat e shoqërisë kërkojnë që medias t'i jepet informacioni i nevojshëm për të informuar publikun për funksionimin e sistemit të drejtësisë".

iii. Informuar në kohë të shpejtë publikun për seancat e ardhshme të Këshillit dhe të gjitha përfundimet dhe vendimet

Projekti ka vëzhguar shumë raste ku figurat e rëndësishme politike shprehnin publikisht pakënaqësinë dhe kritikojnë vendimet e gjykatave në çështje që përfshinin zyrtarë të nivelit të lartë, duke sinjalizuar ndërhyrje të mundshme politike; megjithatë, Këshilli Gjyqësor nuk i dënoi këto sulme verbale ndaj gjyqësorit duke nxjerrë deklarata zyrtare ose duke marrë ndonjë hap konkret për mbrojtjen e gjyqtarëve. Në bazë të Opinionit të KKGJE-së Nr. 24 (2021), “Këshilli duhet të kundërshtojë në mënyrë vendimtare çdo përpjekje për të sulmuar ose ushtruar presion mbi gjyqtarët individualë ose gjyqësorin në tërësi”.¹³⁷

Projekti vëzhgoi një rast ku një prokuror kritikoi publikisht Këshillin e Prokurorëve Publikë dhe theksoi nevojën për reformimin e tij. Si pasojë Këshilli i Prokurorëve Publikë i kërkoi Këshillit Etik të Prokurorëve Publikë të përcaktonte nëse kjo deklaratë

ishte shkelje e Kodit të Etikës së Prokurorëve Publikë.¹³⁸ Deri më sot, nuk mund të gjendet asnjë informacion i disponueshëm publikisht për rezultatin e nismës. OSHC-të që monitorojnë punën e Këshillave kritikuan si thelbin e kësaj nisme, edhe mungesën e transparencës në seancën e Këshillit të Prokurorëve Publikë gjatë së cilës u vendos nevoja për këtë kërkesë. Duke marrë përsipër rolin e ruajtjes së autonomisë së prokurorëve, Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të respektojë Opinionin Nr. 18 (2023) të miratuar së fundmi nga Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Publikë.¹³⁹

Kushtetuta dhe ligjet e tjera përkatëse garantojnë pavarësinë e Këshillave dhe i pozicionojnë ata si organet përgjegjëse për sigurimin e pavarësisë së gjyqtarëve dhe autonomisë së prokurorëve publikë, si dhe për ruajtjen e reputacionit të tyre dhe besimit të publikut.¹⁴⁰

¹³⁷ 1680a47604 (coe.int)

¹³⁸ Në korrik 2021, Këshilli i Prokurorëve Publikë miratoi një Kod të ri Etike për Prokurorët Publikë, që përfshinte në nen sipas të cilit prokurorët publikë nuk komentojnë në publik vendimet e Këshillit të Prokurorëve Publikë. Shih: [etichki-kodeks-na-javnite-obviniteli-2021.pdf](https://jorm.gov.mk/etichki-kodeks-na-javnite-obviniteli-2021.pdf) (jorm.gov.mk).

Ky nen u ndryshua në nëntor 2023 dhe tani parashikon që prokurorët publikë duhet të sigurohen që të mos cenojnë reputacionin e prokurorisë publike dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në paraqitjet e tyre publike. Shih:

[Етички-кодекс-за-изменување-и-дополнување-на-Етичкиот-кодекс-на-јавните-обвинители-на-Република-Северна-Македонија-1.doc](https://live.com/etichki-kodeks-na-javnite-obviniteli-na-Republika-Severna-Makedonija-1.doc) (live.com)

¹³⁹ 1680ad1b36 (coe.int)

¹⁴⁰ Neni 104 i Kushtetutës, neni 2, 36 (1) i.16 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 102/19), Kodi i Etikës i Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, Programi për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2024, neni 2 i Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 150/07, 100/11 dhe 42/20).

Megjithatë, këshillat aktualisht nuk kanë procedura të standardizuara se si të përmbushin këtë objektiv, pasi duket se legjislacioni kryesisht thekson rolin e tyre në sanksionimin e sjelljeve të papërshtatshme. Projekti vërejti se Këshilli Gjyqësor ndërmori disa veprime individuale për të adresuar efikasitetin e proceseve por nuk miratoi një qasje sistemike në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të vazhdueshme. Gjatë konsultimeve të Projektit dhe forumeve të diskutimit, gjyqtarët dhe prokurorët publikë shprehën hapur pakënaqësinë e tyre me punën e Këshillave. Ata gjithashtu theksuan nevojën për procedura më transparente për zgjedhjet dhe promovimet, duke përfshirë shpjegime më të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për vendimet. Duke rivlerësuar praktikën e tyre të votimit, këshillat mund të përpiqen të sigurojnë trajtimin e barabartë të të gjithë kandidatëve, si dhe zbatimin transparent të sistemit të bazuar në meritë. Në lidhje me rezultatet e procedurave disiplinore, shkelja dhe arsyetimi i shkurtuar i vendimeve duhet të bëhen gjithmonë publike pa rrezikuar ndërhyrjen në të drejtat e privatësisë.

Siç u vërejt në “Vlerësimin e Riskut të Korrupsionit në Sistemin Gjyqësor në Maqedoninë e Veriut”, të publikuar me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, “pothuajse tri të katërtat e gjyqtarëve nuk besojnë se

“Këshilli Gjyqësor mbron me sukses pavarësinë gjyqësore, pasi ata nuk besojnë se promovimi i gjyqtarëve kryhet sipas kriterëve objektive, të matshme dhe të drejta.” Më mënyrë të ngjashme, më shumë se gjysma e prokurorëve publikë “nuk besojnë se Këshilli i Prokurorëve Publikë merr vendime në mënyrë autonome dhe të pavarur, pasi ata nuk besojnë se promovimi i prokurorëve publikë kryhet sipas kriterëve ligjore ekzistuesë”.¹⁴¹ Megjithatë, si një hap pozitiv, Këshilli Gjyqësor ka vërejtur gjithashtu disa prej këtyre mangësive dhe ka parashikuar në Planin Strategjik për periudhën 2023-2024 aktivitete që do të çojnë në mbrojtje të shtuar për reputacionet e gjyqtarëve dhe rritje të transparencës.¹⁴² I njëjti element është reflektuar në Programin dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Vlerësimin e Korrupsionit në Sistemin Gjyqësor për periudhën 2022-2025¹⁴³ dhe në Planin e Punës të Këshillit Gjyqësor për vitin 2024, në të cilin mbrojtja e gjyqtarëve nga ndikimi i paligjshëm është një nga përparësitë.¹⁴⁴ Përmirësimi i procesit të zgjedhjeve, emërimeve dhe proceseve disiplinore, si dhe rritja e transparencës është një pjesë kritike e Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve nga Misioni i BE-së për Shqyrtimin nga Kolegjet të Këshillit Gjyqësor, i miratuar në mars 2024.¹⁴⁵ Niveli i zbatimit të këtyre dokumenteve mbetet për t'u parë.

¹⁴¹ osce.org/files/f/documents/9/d/545929_0.pdf,p.38.

¹⁴² [Y2023-SDN-\(GD\)0455.pdf \(sud.mk\)](#).

¹⁴³ [Програма и акционен план за превенција и следење на корупцијата во судството 2022 - 2025 \(sud.mk\)](#).

¹⁴⁴ [Y2024-SDN-\(GD\)2600.pdf \(sud.mk\)](#).

¹⁴⁵ [Y2024-SDN-\(GD\)0545.pdf \(sud.mk\)](#).

Të përmirësohen standardet e drejtësisë për gjykimin e çështjeve KOK për të theksuar paanshmërinë gjyqësore në përputhje me barazinë e armëve.

- i. Gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave duhet të respektojnë plotësisht përgjegjësinë e tyre jo vetëm të qëndrojnë të paanshëm por edhe të duken të paanshëm gjatë gjithë proceseve gjyqësore dhe të zbatojnë standardet më të larta në vendimet që marrin dhe proceset përmes së cilave arrihen këto vendime.
- ii. Krerët e dhomave penale të gjykatave duhet të lehtësojnë diskutime të rregullta dhe të ndajnë praktikat më të mira me gjyqtarët.
- iii. Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë duhet të sigurojë që problemet e drejtësisë të jenë qendrore në kurrikulën e trajnimit, dhe të paraqesë rezultatet e arritura në mënyrë të matshme.

Në shumë raste, Projekti vërejti probleme në lidhje me drejtësinë, pasi sjellja e disa gjyqtarëve ngrinte shqetësime për paanshmërinë dhe angazhimin e tyre ndaj parimit të barazisë së armëve.

Për shembull, në të paktën dy çështje – dhe në disa raste – Projekti vëzhgoi siç vijon: gjyqtarët dytësorë, pjesëtarë të trupit gjykues, largoheshin nga salla e gjyqit gjatë një seance pa vendosur një pushim për seancën, gjyqtarët merrnin përsipër marrjen në pyetje të dëshmitarit nga palët, shprehnin padurim ose kritiknin personin që jepte dëshmi.

Kjo sjellje duhet të adresohet dhe të

korrigjohet për të ruajtur besimin e publikut te paanshmëria gjyqësore. Në radhë të parë, gjyqtarët duhet të respektojnë gjithmonë përgjegjësinë e tyre jo vetëm për të vepruar në mënyrë të paanshme por edhe për t'u dukur të paanshëm.

Në lidhje me të drejtën për gjykim publik, Projekti vërejti në disa raste që gjyqtarët nuk i njoftonin publikisht vendimet, por thjesht urdhëronin të pandehurit që do të njoftoheshin për vendimin e tyre me shkrim në kohën e duhur. Njoftimi publik i vendimeve është veçanërisht i rëndësishëm në çështje ku arsyetimi me shkrim i vendimeve nuk është publikisht i disponueshëm në kohën e duhur.

Në lidhje me barazinë e armëve, Projekti vëzhgoi në disa raste që gjyqtarët kufizonin të drejtat e palëve. Në veçanti, ata kufizonin aftësinë e palëve për të kundërshtuar provat kundër tyre; për të sfiduar dëshmitarët duke iu referuar deklaratave të mëparshme gjatë hetimit, ose para se të rifillonte seanca; dhe të parashtronin provat e tyre, që në disa raste refuzoheshin pa justifikim të mjaftueshëm.

Duhet të theksohet se problemet e vëzhguara fillimisht nga Projekti në lidhje me ndarjen e provave nga prokuroria me mbrojtjen aktualisht po vërehen shumë rrallë në çështjet gjyqësore KOK. Projekti vëren se ky problem do të zgjidhej edhe më mirë nëpërmjet ndryshimeve të planifikuara në KPP, pasi ato parashikojnë

ndarjen e detyrueshme dhe të shpejtë të provave nga prokuroria.

Kryetarët e gjykatave dhe krerët e dhomave penale mund të luajnë një rol kritik në organizimin e mbledhjeve, lehtësimin e komunikimit në radhët e gjyqtarëve dhe inkurajimin e tyre për të qenë kritikë ndaj vetes dhe për të ndarë praktikat më të mira për përmirësimin e imazhit të përgjithshëm të gjykatave.

Për më tepër, Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë duhet të adresojë këto probleme në lidhje me drejtësinë si në trajnime fillestare edhe ato të vazhdueshme. Ajo duhet të kryejë gjithashtu një vlerësim të bazuar në të dhëna të rezultateve të arritura, të raportojë për to dhe t'i reflektojë ato në aktivitetet e ardhshme.

Efikasiteti

4

Rekomandim

Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria Publike e Shtetit duhet të dallojnë dhe kategorizojnë çështjet KOK të nivelit të lartë me synim rritjen e efikasitetit në trajtimin e tyre. Ata duhet të veprojnë kështu duke:

- i. Miratuar metodologji për të dalluar çështjet KOK nga njëra-tjetra për qëllime statistikore dhe politikëbërëse, në koordinim me gjykatat dhe prokuroritë publike.
- ii. Për të njëjtat qëllime, duke miratuar kriteret shtesë për të dalluar dhe kategorizuar çështjet KOK të nivelit të lartë nga ato "standarde".

- iii. Gjurmuar trajtimin efikas të çështjeve KOK të nivelit të lartë, duke përfshirë miratimin e planeve të punës dhe metodologjive për trajtimin e këtyre çështjeve nga prokuroritë publike dhe gjykatat.
- iv. Projektuar çështjet KOK të nivelit të lartë për të shpërndarë burime të përshtatshme te prokuroritë dhe gjykatat e përfshira në trajtimin e tyre.
- v. Siguruar që kriteret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të reflektojnë në mënyrë të përshtatshme sfidat e veçanta në trajtimin e çështjeve KOK të nivelit të lartë.

Për të vendosur një bilanc të konsoliduar në adresimin e çështjeve KOK, është thelbësore të krijohet një sistem i posaçëm dhe i besueshëm dallimi dhe kategorizimi. Ky sistem do të ndihmojë për identifikimin si të çështjeve KOK dhe të atyre KOK të nivelit të lartë. Duke bërë këtë, institucionet e vendit mund të gjenerojnë statistika të besueshme për trajtimin e çështjeve, duke lehtësuar matjen e progresit ose hapave prapa në vijimësi.

Vlen të përmendet që, në nëntor 2023, Projekti mori informacion nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me një Metodologji për një Sistem të Dobishëm Statistikor për Monitorimin e Politikave Antikorrupsion, të miratuar nga Qeveria në vitin 2013. Sipas Ministrisë, Metodologjia është e integruar në Sistemin AKstats, që mbledh dhe trajton të dhënat statistikore për parandalimin dhe goditjen e korrupsionit dhe pastrimit të parave. AKstats ka qenë funksional që prej prillit të vitit 2019.

Kriteret për përcaktimin e çështjeve të korrupsionit të nivelit të lartë u zhvilluan nga një Grup Pune për parashtrimin dhe përditësimin e Metodologjisë së lartpërmendur dhe ato u pranuan nga Prokuroria Publike e Shtetit në vitin 2015, siç theksohet nga Ministria.

Duke marrë parasysh më sipër, Projekti beson se kjo shërben si një bazë e qëndrueshme që Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria Publike e Shtetit të zhvillojnë në bashkëpunim kriteret e veta të sinkronizuara për identifikimin dhe kategorizimin e çështjeve KOK për qëllimet e tyre. Për më tepër, këto kriteret, si dhe analiza e të dhënave statistikore, mund të shërbejnë si mjete të vlefshme për zhvillimin e politikave, metodologjive dhe strategjive të qëndrueshme, si dhe për dhënien e përparësisë në trajtimin e çështjeve dhe planifikimin e punës. Ato gjithashtu mund të ndihmojnë në shpërndarjen efikase të burimeve të nevojshme.

Një sistem i përshtatshëm kategorizimi për qëllime statistikore dhe politikëbërëse, nëse projektohet siç duhet, mund të jetë një mjet themelor në formimin dhe zbatimin e masave kyçe që synojnë përmirësimin e përgjigjes gjyqësore ndaj çështjeve KOK, veçanërisht në lidhje me çështjet e nivelit të lartë.

Përveç krijimit të të dhënave sasiore të besueshme për trajtimin e këtyre çështjeve, ky sistem mund të përdoret për t'i dhënë përparësi ndjekjes dhe gjykimit të çështjeve KOK të nivelit të lartë nga prokuroritë publike dhe gjykatat përkatësisht; konkretisht, mund të parashikohen objektiva të veçantë në lidhje me trajtimin e këtyre çështjeve në planet vjetore të punës të gjykatave dhe prokurorive publike.

Për më tepër, projektimi i çështjeve aktuale dhe të ardhshme të nivelit të lartë në prokuroritë publike dhe gjykatat e ndryshme në sistemin e vendit mund të përdoret për të rishpërndarë burimet njerëzore dhe materiale aty ku janë më të nevojshme.

Së fundi, kriteret e vlerësimit të performancës për gjyqtarët dhe prokurorët publikë duhet të reflektojnë punën dhe sfidat e shtuara që paraqesin çështjet KOK, veçanërisht ato të nivelit të lartë. Shpërblimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë që punojnë me këto çështje me pikë vlerësimi shtesë mund të jetë një mjet efektiv në nxitjen e një përgjigjeje gjyqësore më efikase dhe profesionale ndaj çështjeve KOK.

5

Rekomandim

Gjyqtarët në Dhomën për Çështjet KOK në Gjykatën Penale Themelore të Shkupit duhet të miratojnë dhe zhvillojnë më tej standardet dhe teknikat për menaxhimin e çështjeve gjyqësore të ndërlikuara, në bazë të praktikave të mira, për të përmirësuar efikasitetin e çështjeve gjyqësore. Ata duhet të veprojnë kështu duke:

- i. Pasur një qasje strategjike ndaj çdo çështjeje të veçantë duke krijuar një orar për seancat, duke marrë parasysh numrin e të pandehurve, volumin e provave, mandatin e gjyqtarëve dhe oraret e anëtarëve të trupit gjykues dhe të palëve.
- ii. Ftuar palët të konsolidojnë listat e provave dhe të bien dakord mbi faktet e pakundërshtuara, si dhe të kërkojnë parashtrim efektiv të provave materiale.

Rekomandim

iii. Planifikuar seanca të njëpasnjëshme çdo ditë dhe, nëse kjo nuk është e mundur për arsye teknike ose të tjera, të caktojnë të paktën një seancë në javë.

iv. Deleguar – sipas rastit – thirrjen e dëshmitarëve të palët duke mbajtur mekanizmat e kontrollit për të siguruar praninë e dëshmitarëve.

v. Kërkuar që palët të informojnë gjykatën për mungesat për arsye shëndetësore në kohën e duhur, dhe të vlerësojnë vazhdimisht vlefshmërinë e të gjithë dokumentacionit mjekësor të dorëzuar.

Elementi më i zakonshëm në shumicën e çështjeve të monitoruara ishte kohëzgjatja e përgjithshme e procesit – nga 50 çështje, 18 prej tyre janë përfunduar. Megjithatë, tetë prej tyre u mbyllën për shkak të mbarimit të afatit

të parashkrimit si rezultat i ndryshimeve më të fundit në KP.

Kohëzgjatja e gjykimit në shkallën e parë është mesatarisht 2 vjet, ku gjykimi më i gjatë ka zgjatur 2127 ditë dhe ai më i shkurtër nëntë ditë.

Kohëzgjatja mesatare e proceseve deri në vendimin e shkallës së parë




Figura 26 - Kohëzgjatja mesatare e proceseve deri në vendimin e shkallës së parë

Në disa çështje ku vendimi i shkallës së parë u mor brenda një afati të arsyeshëm, gjyqtarët përdorën teknika të menaxhimit të seancave gjyqësore që kontribuuan në trajtimin në kohë të çështjes. Për shembull, në fillim të çështjes, gjyqtarët caktuan një numër të konsiderueshëm çështjesh paraprakisht, duke marrë gjithashtu parasysh përplasjet e angazhimeve të palëve dhe anëtarëve të trupit gjykues.

Në veçanti, në një çështje korrupsioni të nivelit të lartë me shumë të pandehur, gjykimi në shkallë të parë përfundoi për më pak se një vit pasi seancat caktoheshin rregullisht, të paktën një herë në javë. Duke parë qasjen aktuale proaktive të gjyqtarëve në Dhomën për Çështjet KOK për të caktuar seanca më të shpeshta, si dhe gatishmërinë e tyre për të zbatuar praktika më efikase për menaxhimin e seancave gjyqësore, Projekti rekomandon caktimin e seancave ditore, sipas mundësisë, ose të paktën një seance në javë.¹⁴⁶ Respektimi i të ashtuquajturit parim përqendrimi të seancës kryesore në çështjet KOK mund të kontribuojë në dhënien e efikase të drejtësisë dhe si pasojë rritjen e besimit të publikut të drejtësisë.

Për më tepër, Projekti vëzhgoi se vendi dhe dinamika e seancave varej nga volumi i provave dokumentare dhe numri i dëshmitarëve të propozuar.

Të dyja palët ndonjëherë parashtronin prova shkresore të përsëritura ose propozonin disa dëshmitarë për të dëshmuar për të njëjtat rrethana. Megjithatë, rishqyrtimi dhe konsolidimi i listave të provave të të dyja palëve u vëzhgua në çështjet ku gjykimet rifillonin ose në fillimin e një rigjykimi; kjo praktikë duhet dhe mund të miratohet që në fillim të çdo gjykimi për të kursyer kohë dhe burime.¹⁴⁷

Një praktikë tjetër e mirë e përdorur nga gjyqtarët ishte delegimi i thirrjes së dëshmitarëve të pala që i propozonte ata, me pranimin e palëve. Pavarësisht se nuk parashikohej me ligj, kjo kontribuonte në mënyrë të konsiderueshme në shmangien e vonesave për shkak të mungesës së dëshmitarëve.

Projekti vërejti se arsyeja më e shpeshtë për shtyrjen e seancave ishte mungesa e të pandehurit, kryesisht për shkak të arsyeve shëndetësore. Praktika të mira vëzhgoheshin kur gjyqtarët urdhëronin kontrollin e raporteve mjekësore të nxjerra nga mjekët dhe paralajmëronin palët që ishin të detyruara të informonin gjykatën për pamundësinë e tyre për të ndjekur seancën sapo të ndodhte shkak i mungesës. Në këtë mënyrë, gjykata kishte mundësinë të informonte palët e tjera dhe të caktonte një datë të re seance në vend të shtyrjes së saj, duke shmangur vonesat dhe kostot e panevojshme

¹⁴⁶ Baza ligjore për këtë shprehet qartësisht në nenin 359 (1) të KPP-së (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18), që parashikon që seanca kryesore mbahet pa ndërprerje, dhe nëse seanca kryesore nuk është e mundur të përfundojë me një herë të vetme, kryetari i trupit gjykues e shtyn seancën në ditën tjetër të punës.

¹⁴⁷ Neni 358 (2) KPP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18) detyron kryetarin e trupit gjykues të eliminojë çdo gjë që mund të zvarritë procesin ose që nuk i shërben qëllimit të qartësisë të çështjeve.

Arsyet e shtyrjeve




Figura 27 - Arsyet e shtyrjeve

Projekti vërejtí vonesa të shkaktuara nga rifillimi i gjykimeve për shkak të ndryshimit në përbërjen e trupit gjykues. Konkretisht, mbrojtja (sh)përdoroi të drejtën e saj procedurale për të kërkuar riparashtrimin e të gjitha provave të paraqitura më parë.¹⁴⁸

Projektndryshimet aktuale në KPP do të zgjidhin këtë problem duke lejuar anëtarët e trupit të ri gjykues të njihen me dosjen e çështjes në vend të

përsëritjes së të gjithë procedurës nga fillimi.

Në të ardhmen, ndryshimet në KPP që parashikojnë një afat për shqyrtimin e kërkesës për gjykim do të adresojnë problemet e efikasitetit të shkaktuara nga procedurat e gjata për shqyrtimin e kërkesave për gjykim, të cilat, në 13 nga 50 çështjet e monitoruara, zgjatnin më shumë se 90 ditë, në tri çështje më shumë se 180 ditë, ndërsa për një çështje pothuajse një vit.

¹⁴⁸ Sipas nenit 371 (2) KPP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18), seanca kryesore rifillon nëse gjyqtari individual ose përbërja e trupit gjykues ka ndryshuar. Me pëlqimin e palëve, trupi gjykues mund të vendosë të mos rimerren në pyetje dëshmitarë ose ekspertë të caktuar, por të lexohen deklaratat e tyre që janë regjistruar gjatë seancës kryesore të mëparshme.

Sistemi gjyqësor duhet të intensifikojë përpjekjet për të trajtuar dhe përfunduar në mënyrë efikase çështjet KOK të nivelit të lartë në fazën e apelit.

- i. Këshilli Gjyqësor duhet të sigurojë një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh dhe plotësimin në kohë të të gjitha pozicioneve vakante të ardhshme në Gjykatën e Apelit të Shkupit.
- ii. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Shkupit duhet të zbatojnë rregullisht dispozitat e KPP-së që rregullojnë mbajtjen e seancave ose pushimin e një vendimi dhe të vendosin për themelin, veçanërisht kur shkeljet janë probleme që mund të zgjidhen pa urdhëruar një rigjykim.
- iii. Kryetari i Gjykatës së Apelit të Shkupit, në koordinim me Kreun e Dhomës Penale në këtë gjykatë, duhet të lehtësojë diskutimin ndërmjet gjyqtarëve të shkallës së dytë dhe të parë për sfidat që hasen në të dyja shkallët, në çështjet ku urdhërohen rigjykimet.

Për të lehtësuar trajtimin e çështjeve të nivelit të lartë, Këshilli Gjyqësor duhet të sigurojë që pozicionet boshe në Gjykatën e Apelit të Shkupit të plotësohen sa më shpejt të jetë e mundur, sipas sistemit të brendshëm në gjykatë, veçanërisht duke pasur parasysh ngarkesën aktuale të punës. Zgjedhja e fundit të gjyqtarëve ishte në nëntor 2023, pas hapjes së një procesi rekrutimi për katër gjyqtarë të së drejtës penale (40% të totalit) në korrik 2021.

Në bazë të përllogaritjeve të parashikueshme si dalja në pension, institucioni duhet të përpiket të fillojë procedurën e zgjedhjes edhe para se pozicionet të bëhen vakante në mënyrë që të parandalohen vakancat e tejzgjatura.¹⁴⁹

Sipas gjetjeve të monitorimit të çështjeve gjyqësore nga Projekti, Gjykatës së Apelit të Shkupit i duheshin mesatarisht 101 ditë nga marrja e propozimit të Prokurorisë së Lartë Publike për të caktuar një seancë publike.¹⁵⁰

¹⁴⁹ Neni 105 i Kushtetutës; neni 36 dhe 46 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 102/19).

¹⁵⁰ Të dhënat vijnë nga vendimet e Gjykatës së Apelit të Shkupit që janë publikuar në faqen zyrtare, në çështjet e monitoruara ku është mbajtur një seancë publike

Në pesë raste, koha zgjati më shumë se 150 ditë. Mesatarisht, vendimi i shkallës së dytë jepej 60 ditë pas mbajtjes së seancës publike. Megjithatë, në çështjet e nivelit të lartë, vendimi i shkallës së dytë jepej mesatarisht 101 ditë pas seancës publike, ndërsa dy prej çështjeve zgjatën më shumë se 210 ditë deri në dhënien e vendimit.

Aktualisht, 12 çështje janë në rishikim në apel, nga të cilat pesë janë rigjytime. Që prej fillimit të Projektit, Gjykata e Apelit e Shkupit ka vendosur për 17 çështje të monitoruara, 11 prej së cilave të nivelit të lartë. Në tri nga këto çështje të nivelit të lartë u dha vendim kundërshtues për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit si rezultat i ndryshimeve në KP, ndërsa në tri çështje të tjera Gjykata e Apelit pushoi vendimet e shkallës së parë për pjesët e

lidhura me sanksionet penale.

Në pesë çështjet e mbetura, vendimi i shkallës së parë u pushua dhe u urdhërua rigjykim. Në shumicën e çështjeve të dërguara për rigjykim, Gjykata e Apelit u referohej vendimeve të paqarta dhe kontradiktore, ose vendimeve që nuk përmbanin arsye për faktet vendimtare ose provat e paraqitura si baza për një rigjykim.¹⁵¹

Është e rëndësishme të vërehet se rigjykimet kontribuojnë në zvarritjen e proceseve, dhe mund të çojnë në skadimin e afateve të parashkrimit. Ato gjithashtu shoqërohen nga shumë probleme të tjera të mundshme, si krijimi i pasigurisë për të pandehurit, viktimat, madje edhe dëshmitarët, minimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, dhe rregulli kundër dënimit të dyfishtë.

Kohëzgjatja mesatare e proceseve deri në vendimin e formës së prerë




Figura 28 - Kohëzgjatja mesatare e proceseve deri në vendimin e formës së prerë

¹⁵¹ Neni 415 (1) pika 11 KPP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18)

Si pasojë, Projekti rekomandon që Gjykata e Apelit të shmangë interpretimet e ngushta të dispozitave që i lejon të mbajë seanca dhe të marrë vendime për themelin. Në fakt, ajo duhet t'i shfrytëzojë plotësisht këto dispozita në përputhje me ligjin.¹⁵²

Vlen të përmendet se, që nga fillimi i Projektit, nuk është mbajtur asnjë seancë në asnjë nga çështjet e monitoruara në fazën e apelit.

Si pasojë, Kryetari i Gjykatës së Apelit, në marrëveshje me Kreun e Dhomës Penale në këtë gjykatë – brenda kompetencës së vet – duhet të lehtësojë diskutimet ndërmjet gjyqtarëve për të siguruar që çështjet e nivelit të lartë të trajtohen brenda një afati të arsyeshëm dhe të arrijnë vendimin e formës së prerë sa më shpejt të jetë e mundur.

7

Rekomandim

Të përdoren proceset e vendimmarrjes në bazë të të dhënave për të siguruar shpërndarjen efikase të burimeve për trajtimin e çështjeve KOK:

- i. Kryetarët e gjykatave dhe krerët e prokurorive publike duhet të përdorin në mënyrë proaktive raportet vjetore zyrtare të institucioneve për të kryer vlerësime të vazhdueshme nevojash dhe për të bërë thirrje për burime shtesë në bazë të të dhënave që përmbajnë ato.
- ii. Kryetarët e gjykatave dhe Këshilli Gjyqësor duhet të lehtësojnë transferimet e përkohshme të gjyqtarëve sipas nevojave të veçanta të gjykatave ose dhomave të caktuara, dhe të diskutojnë për mundësinë e emërimit të gjyqtarëve të posaçëm që vendosin vetëm në fazën e rishikimit të kërkesës për gjykim.
- iii. Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të mbushë rregullisht pozicionet boshe në Prokurorinë Publike Themelore për çështjet KOK.
- iv. Pushteti ekzekutiv duhet të respektojë shpërndarjen e parashikuar buxhetore për sistemin gjyqësor dhe të mundësojë punësimin e personelit administrativ shtesë për të mbështetur punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.

¹⁵² Neni 424 (1) i KPP-së (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18).

Në bazë të monitorimit të çështjeve gjyqësore nga Projekti dhe konsultimeve si me gjyqtarët edhe me prokurorët publikë, ka mungesa serioze në burime njerëzore në gjykata dhe PPTH KOK.

Megjithëse numri i përgjithshëm i gjyqtarëve është në përputhje me standardet evropiane,¹⁵³ ngarkesa e punës në Dhomën e Çështjeve KOK në GJPTH-në e Shkupit tregon se numri i çështjeve në këtë dhomë në krahasim me numrin e çështjeve të trajtuara çdo vit është joproporcional. Kjo u konfirmua gjatë konsultimeve me gjyqtarët, që thanë se numri i çështjeve të përfunduara nga ata ishte më shumë se dyfishi i numrit orientues të parashikuar të çështjeve. Projekti vëzhgoi se gjyqtarët nga dhomat e tjera të GJPTH-së së Shkupit me më pak ngarkesë herë pas here caktoheshin si gjyqtarë të dytë profesionalë në trupat gjykues të çështjeve KOK të nivelit të lartë. Projekti e vlerëson këtë praktikë, pasi rishpërndarja sistematike dhe e bazuar në të dhëna e gjyqtarëve do të lejojë procese gjyqësore më efikase.

Një zgjidhje e mundshme për përmirësimin e efikasitetit duke rishpërndarë burimet mund të jetë emërimi i gjyqtarëve të posaçëm për të vendosur vetëm në fazën e shqyrtimit të kërkesës për gjykim, bashkë me një sistem të përshtatshëm pikëzimi për t'i vlerësuar ata në mënyrën e duhur. Kjo do të përforcojë këtë fazë të

rëndësishme të procedurës penale, që aktualisht nuk është mjaftueshëm funksionale, siç pranohet nga gjyqtarët si dhe Këshilli Gjyqësor. Për arritjen e kësaj, Këshilli Gjyqësor, në koordinim me kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët penalë nga të gjitha shkallët, mund të kryejnë një analizë për identifikimin e mangësive në fazën e shqyrtimit të kërkesës për gjykim Rezultatet nga kjo analizë duhet të japin zgjidhje praktike për problemet në procesin penal të shkaktuar nga zvarritjet ose vendimet me cilësi të dobët në fazën e shqyrtimit të kërkesës për gjykim.

Së fundi, Këshilli Gjyqësor duhet të mbështetë transferimin e kërkuar të përkohshëm të gjyqtarëve nga gjykatat më pak të ngarkuara tek ato me ngarkesë pune më të madhe, njëkohësisht duke analizuar arsyet e ngarkesës së dosjeve të prapambetura. Si pasojë, në bazë të kësaj analize, ai duhet të ofrojë një zgjidhje sistematike më të qëndrueshme. Vlen të përmendet se ky problem u përfshi në Strategjinë Kombëtare për Burime Njerëzore në Rrjetin Gjyqësor.¹⁵⁴

Në mënyrë të ngjashme, Strategjia e Burimeve Njerëzore për Rrjetin e Prokurorisë vëren se rrjeti aktual i prokurorive publike duhet të riprojektohet sipas vlerësimit dhe kriterëve të matshme, si dhe në përputhje me riprojektimin e rrjetit gjyqësor.¹⁵⁵ Sipas Raportit Vjetor të Prokurorisë Publike të Shtetit, numri

¹⁵³ Shih: Raportin e Vlerësimit të CEPEJ për sistemet gjyqësore evropiane 2022 Cikli i vlerësimit (të dhënat e 2020): [1680a86279 \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/domestic/CEPEJ/CEPEJ_2022/Cycle_2022/2022_Cycle_2022.pdf).

¹⁵⁴ [Konecen+narativen+del+Strategija+za+covecki+resursi+sud+mreza+za+objava+3.pdf \(vsrm.mk\)](https://www.vsr.gov.mk/documents/Konecen+narativen+del+Strategija+za+covecki+resursi+sud+mreza+za+objava+3.pdf)

¹⁵⁵ [strategija-na-chovechki-resursi-za-javnoobvinitelskata-mreza.pdf \(jorm.gov.mk\)](https://www.jorm.gov.mk/documents/strategija-na-chovechki-resursi-za-javnoobvinitelskata-mreza.pdf).

total i prokurorëve në PPTH-në KOK gjatë vitit 2022 ishte 11 nga 18 të parashikuar nga sistemimi, ndërsa një e treta e pozicioneve të parashikuara në vend nuk janë mbushur.¹⁵⁶ Në korrik 2023, Këshilli i Prokurorëve Publikë nxori një deklaratë për të përcaktuar numrin e prokurorëve në të gjitha prokuroritë publike, të cilat e vendosin përsëri numrin e prokurorëve në PPTH KOK në 18. Prokurorët në PPTH KOK zgjidhen me mandat katërvjeçar, dhe zvarritjet në zgjedhjen ose rizgjedhjen e tyre kanë ndikim në trajtimin e çështjeve KOK, veçanërisht duke parë që hetimet në këto çështje janë të ndërlikuara dhe proceset gjyqësore zgjatin në kohë. Në shumë raste, Projekti vëzhgoi se seancat shtyreshin ose ricaktoheshin pasi mandati i prokurorit kryesor skadonte dhe procedura për zgjedhjen nuk përmbyllej në kohë.

Prokuroria Publike e Shtetit dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të vendosin një praktikë rivlerësimi të vazhdueshëm të numrit të prokurorëve në bazë të vlerësimeve të nevojave të ngarkesës së punës për të gjitha prokuroritë publike. Kjo do të rritë ndjekjen efektive të çështjeve KOK dhe do të përshpejtonte ritmin e gjyqimit, veçanërisht pasi Projekti ka vëzhguar rregullisht vështirësi në caktimin e seancave për shkak të përplasjeve të angazhimeve të prokurorëve në krye të çështjes. Gjatë

konsultimeve të Projektit, si gjyqtarëte dhe prokurorët iu referuan nevojës për personel administrativ shtesë si parakusht për përfundimin e suksesshëm dhe në kohë të çështjeve. Ky problem u ngrit në Raportin Vjetor të Këshillit Gjyqësor për Punën e Gjykatave për vitin 2022¹⁵⁷ dhe në Raportin Vjetor të lartpërmendur nga Prokuroria e Shtetit për vitin 2022.

Megjithatë, këto raporte nuk përmbajnë analizë të veçantë të pasojave reale të numrave të pamjaftueshëm të personelit për punën e institucioneve. Për më tepër, nevoja për burime njerëzore shtesë në sistemin e drejtësisë u theksua në Strategjinë Kombëtare për Reformën në Sektorin Gjyqësor për periudhën 2017–2022.¹⁵⁸ Sipas Strategjisë së Zhvillimit të Sektorit të Drejtësisë 2024–2028,¹⁵⁹ një nga arsyet kryesore për realizimin e paplotë të Strategjisë së mëparshme ishte mungesa e mbështetjes financiare për masat e lidhura me burimet njerëzore në gjyqësor dhe modernizimin e tij. Kjo erdhi pasi caktimi i të paktën 0,8% të PBB-së për pushtetin gjyqësor nuk u respektua, ndërkohë që vlera reale ishte ndërmjet 0,26% dhe 0,3%. Në mënyrë të ngjashme, Prokuroria Publike e Shtetit raportoi se buxheti i miratuar në vitin 2022 ishte gjysma e normës së parashikuar 0,4% nga Buxheti i Shtetit.

Nga ana tjetër, duhet të theksohet se për qëllimet e zgjidhjeve afatgjata të

¹⁵⁶ [izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelsta 2022 2 mail-2-3.pdf \(jorm.gov.mk\)](#).

¹⁵⁷ [Годишен+извештај+за+работата+на+судовите+во+2022+година.pdf \(sud.mk\)](#).

¹⁵⁸ [16808c4384 \(coe.int\)](#).

¹⁵⁹ [Предлог Развојна Секторска Стратегија за Правосудство 2024 - 2027.pdf \(pravda.gov.mk\)](#).

bazuara në të dhëna të besueshme, siç rrekomandohet këtu, departamentet e

analitikës në institucionet gjyqësore duhet të përforcohen.

Kapaciteti

8

Rekomandim

Të përforcohet kapaciteti i prokurorëve publikë për të përgatitur kërkesat për gjykim dhe performancën e tyre në gjykatë:

i. Prokuroria Publike e Shtetit duhet të sigurojë miratimin dhe zbatimin efektiv të udhëzimeve për hartimin e kërkesave për gjykim që janë aktualisht në fazën e miratimit.

ii. Kreu i Prokurorisë Publike Themelore për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit duhet:

- Të rrisë frekuencën e mbledhjeve me prokurorët publikë për të adresuar temat me rëndësi për cilësinë e punës së tyre, duke përfshirë performancën në gjykatë.
- Të krijojë mekanizma të brendshëm për përmirësimin e kërkesave për gjykim në çështjet KOK të nivelit të lartë me interes publik para përfundimit të tyre.
- Të sigurojë që vlerësimi i cilësisë së kërkesave për gjykim si tregues cilësor në vlerësimin e performancës së prokurorëve të kryhet në mënyrën e duhur dhe të japë komente konstruktive.

iii. Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë duhet të vlerësojë nevojat e trajnimit të prokurorëve që merren me çështjet KOK dhe të rishikojë kurrikulën sipas rastit për performancën.

Analiza gjithëpërfshirëse e akteve të disponueshme gjyqësore nga Projekti, sipas Metodologjisë së tij, tregoi kërkesa për gjykim me cilësi të dobët, që si gjyqtarët dhe prokurorët publikë e pranuan gjatë forumeve të diskutimit të Projektit.

Problemet më të shpeshta të vërejtura ishin mungesa e qartësisë,

përkufizimet e paqarta të rolit dhe përgjegjësisë penale të të pandehurve, mospërputhja e përshkrimit faktik të veprës me dispozitat përkatëse, arsyetimi i dobët i elementeve të veprës penale dhe provat mbështetëse të pashpjeguara mjaftueshëm, të cilat nuk reflektonin qartësisht veprimet dhe fajin e çdo të pandehuri.

Në Vlerësimin e Riskut të Korrupsionit në Gjyqësor të publikuar nga OSBE-ja në vitin 2023, gjyqtarët identifikuan cilësinë e dobët të kërkesave për gjykim si risk i konsiderueshëm korrupsioni.¹⁶⁰ Kjo nënvizon faktin që mangësitë në cilësinë e akteve gjyqësore mund të mos rezultojnë gjithmonë vetëm nga probleme kapaciteti, dhe mund të përfaqësojnë shenja ndërhyrjeje.

Projekti gjithashtu vlerëson se udhëzimet do të ndihmojnë prokurorët të bëjnë kërkesa për gjykim të qarta, gjithëpërfshirëse dhe bindëse. Misioni i OSBE-së në Shkup, në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë Publike të Shtetit, mbështeti një grup pune për hartimin e udhëzimeve që, ndër të tjera, do të përfshijë një sërë udhëzimesh praktike me modele që do të ndihmojnë prokurorët për të përmirësuar aftësitë e hartimit.

Kur të miratohen dhe të zbatohen përfundimisht, udhëzimet dhe modelet mund të zgjerohen në të ardhmen për të mbështetur përpjekjet për të krijuar një databazë praktikash të mira në kohën e duhur.

Për më tepër, mbledhjet e brendshme ndërmjet prokurorëve në të cilat mund të adresohen temat me rëndësi në lidhje me cilësinë e punës do të ndihmojnë për të promovuar një kulturë vetëreflektimi dhe mësimi. Gjatë këtyre mbledhjeve, kryetari duhet të inkurajojë një shkëmbim të hapur

dhe vetëkritik të përvojës dhe diskutimeve profesionale për të përmirësuar punën dhe imazhin e përgjithshëm të prokurorisë.

Në këtë drejtim, krerët e Prokurorive Publike mund të përdorin kompetencat e tyre drejtuese për të rishikuar punën e prokurorëve dhe për të ofruar mbështetje shtesë sipas nevojës. Ky rishikim mund të bëhet që në fazën e hetimit dhe gjatë përgatitjes së kërkesës për gjykim. Pavarësisht kësaj, rishikimi duhet të sigurojë ekuilibrin e duhur ndërmjet autonomisë së prokurorit dhe autoritetit të eprorit për të vlerësuar performancën e detyrës së prokurorit. Mekanizmi duhet të mbështetet në udhëzime të veçanta që përcaktojnë qartë procesin e kontrollit të cilësisë për hartimin e kërkesave për gjykim. Ky rishikim do të lehtësojë gjithashtu procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve për eprorët, pasi cilësia e kërkesave për gjykim dhe akteve të tjera është një nga parametrat më të rëndësishëm të vlerësimit.

Projekti gjithashtu vërejti një problematikë në lidhje me performancën e prokurorëve në gjykatë. Prokurorët shpesh ishin të pasuksesshëm në qartësimin se si prova të caktuara kontribuonin në të provuarin e akuzave. Një nga problemet kryesore në këtë aspekt ishte parashtrimi i provave materiale nga prokuroria, që shpesh dukeshin joproporcionale, të gjata dhe të ngatërruara për publikun.

¹⁶⁰ 545929_0.pdf(osce.org).

Kjo mund të tregojë një mungesë strategjie të qartë të prokurorisë për çështjen dhe të dëmtojë teorinë e tyre për çështjen. Përmirësimi i parashtrimit të provave shkresore do të çojë në procese më efikase dhe efektive. Si rrjedhim, Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë duhet të kryejë vlerësim të nevojave të trajnimit,

të rivlerësojë dhe të përshtatë kurrikulën, dhe të përqendrohet në anën praktike të trajnimit për ndërtim kapaciteti për prokurorët. Ajo gjithashtu mund të përgatitë një anketim për nevojat e trajnimit të prokurorëve publikë që merren me çështjet KOK dhe të përshtatë kurrikulën në mënyrën e duhur.

9

Rekomandim

Të përmirësohen kapacitetet e gjyqtarëve të të gjitha shkallëve në hartimin e disponimeve dhe vendimeve gjyqësore, veçanërisht për të arritur një arsyetim juridik më të qartë dhe më gjithëpërfshirës.

- i. Kryetari i Gjykatës Supreme dhe kryetarët e gjykatave të apelit duhet të adresojnë problemin se si të përmirësohet cilësia e disponimeve dhe vendimeve gjatë mbledhjeve të punës.
- ii. Gjykata Supreme duhet të nxjerrë seri me shembuj të mirë disponimesh dhe vendimesh nga gjykatat e të gjitha shkallëve.
- iii. Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë duhet të sigurohet që trajnimi i vazhdueshëm të reflektojë në mënyrë të përshtatshme nevojën për të përmirësuar aftësitë e hartimit juridik për gjyqtarët e të gjitha shkallëve që punojnë në çështjet KOK.

Në bazë të analizës së vazhdueshme të të gjitha disponimeve gjyqësore, Projekti vërejti se ato ishin të përsëritura, të gjata në mënyrë të panevojshme, dhe të vështira për t'u kuptuar, veçanërisht vendimet e shkallës së parë. Krahas paqartësisë vendimet shpesh shpjegojnë prova që

përmbanin fakte të parëndësishme, por njëkohësisht jepnin shpjegime shumë të përgjithshme për rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Për më tepër, analiza tregoi se disa vendime nuk identifikonin dhe mbështetnin në mënyrë të qartë, të saktë dhe të plotë të gjitha problemet faktike, ose nuk adresonin të gjitha

problemet ligjore dhe procedurale të ngritura në mënyrën e duhur. Në shumë raste, gjykata nuk jepte shpjegim të mjaftueshëm për disa prova kontradiktore, ose nuk përcaktonte pse prova të caktuara nuk konsideroheshin posaçërisht. Kjo shpesh shërbente si bazë për pushimin e vendimit të shkallës së parë dhe urdhërimin e rigjyimit, duke kontribuar në zvarritjen e proceseve.

Gjatë konsultimeve të Projektit, gjyqtarët pranuan plotësisht nevojën për të përmirësuar mënyrën e hartimit të vendimeve por nxorën në pah se në disa raste kishte pasur përpjekje për të hartuar vendime më të shkurtra dhe të qarta. Disa nga këto vendime ishin pushuar më vonë nga gjykatat e larta për shkak të pamjaftueshmërisë së pretenduar të arsytimit ligjor.

Duke i dhënë përparësi përmirësimit të disponimeve dhe vendimeve gjatë mbledhjeve të punës ndërmjet Gjykatës Supreme dhe gjykatave të apelit, dhe në bazë të përfundimeve të nxjerra në këto mbledhje, gjyqtarët e shkallës së parë do të marrin komente të vlefshme nga gjykatat e larta.

Kjo do t'i lejojë ata të adresonin problemin në mënyrë më sistematike. Nga ana tjetër, nxjerrja e serive të shembujve të mirë të disponimeve dhe vendimeve nga gjykatat e të gjitha shkallëve do të aftësojë gjyqtarët për të përmirësuar aftësitë e hartimit dhe për të miratuar praktika të reja.

Së fundi, Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë duhet të marrë një qasje proaktive për adresimin e nevojës për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve të përfshirë në çështjet KOK.

Ky trajnim duhet të synojë përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të vendimeve të tyre. Për më tepër, Akademia duhet të sigurojë pjesëmarrjen e gjyqtarëve nga të gjitha shkallët. Duke u dhënë atyre një mundësi për diskutim vetëkritik, dhe duke kërkuar një ndryshim të praktikës së vendimeve të zgjatura dhe të përsëritura, Akademia mund të kontribuojë në sjelljen e standardeve të reja dhe përmirësimin e vendimeve.

Të racionalizohet procesi i mbajtjes së procesverbalit nga seancat në gjykatat e shkallës së parë duke përmirësuar cilësinë e regjistrimit në sallën e gjyqit dhe duke siguruar trajnimin e vazhdueshëm për nëpunësit gjyqësorë:

- i. Qendra TIK në Gjykatën Supreme dhe Këshilli për TIK-un në gjyqësor duhet të bashkëpunojnë për përmirësimin e cilësisë dhe besueshmërisë së sistemeve të regjistrimit audio dhe video në sallën e gjyqit.
- ii. Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë duhet të organizojnë trajnime të vazhdueshme për nëpunësit gjyqësorë për mbajtjen efektive të procesverbalit, rëndësinë e shënimeve të sakta dhe si të lehtësohet më mirë rrjedha e informacionit gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve.

Në të gjitha çështjet e monitoruara, gjyqtarët urdhëruan nëpunësit gjyqësorë të mbanin procesverbal në kompjuter, shpesh të shoqëruar me regjistrim audio ose video të seancës.¹⁶¹

Në dukje një problem teknik, kjo praktikë shpesh çon në tjetërsimin e përmbajtjes së dëshmisë dhe pasaktësi në procesverbalet e shkruara. Ky nuk është vetëm një problem kapaciteti; ai gjithashtu dëmton integritetin e procesit pasi shpesh shkakton vështirësi gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve duke çrregulluar rrjedhën e natyrshme të informacionit.

Për ta tejkaluar këtë pengesë, Qendra TIK në Gjykatën Supreme

dhe Këshilli për TIK-un në gjyqësor duhet të sigurojnë mirëfunksionimin e sistemeve të regjistrimit në të gjitha sallat e gjyqit dhe disponueshmërinë e regjistrimeve cilësore dhe praktike. Alternativa e mundshme teknikisht e konvertimit të audios në tekst të shkruar është një tjetër zgjidhje e shkëlqyer në këtë drejtim.

Në të njëjtën kohë, trajnimi i detyrueshëm dhe i vazhdueshëm i nëpunësve gjyqësorë do të rritë standardet e tyre profesionale dhe do të siguronte saktësi më të madhe të procesverbaleve të shkruara të përdorura nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës.

¹⁶¹ Megjithëse KPP-ja parashikon regjistrimin audio ose audioviziv të procesit, funksionimi i pajisjeve është i dyshimtë dhe gjyqtarët mbështeten te procesverbalet e shkruara veçanërisht kur përgatitin vendimet me shkrim.

Këshilli Gjyqësor dhe Prokurori Publik i Shtetit, në koordinim të ngushtë me Këshillin për Prokurorët Publikë, duhet të përmirësojnë cilësinë e proceseve të vlerësimit të performancës, ndër të tjera duke:

- i. Rishikuar vazhdimisht metodat e përdorura për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- ii. Mbledhur mendimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve për proceset e vlerësimit.

Në dhjetor 2020, pas miratimit të Ligjit të ri për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për Prokurorinë Publike, Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria Publike e Shtetit miratuan aktet e brendshme për vlerësimin e performancës së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë përkatësisht, duke përfshirë kritere të detajuara cilësore dhe sasiore.¹⁶²

Megjithëse rezultatet e vlerësimit të rregullt katërvjeçar në bazë të akteve të brendshme dhe/ose metodologjive të miratuara së fundmi nuk janë ende të disponueshme, disa gjyqtarë dhe prokurorë publikë janë vlerësuar tashmë në bazë të metodologjive të reja si pjesë e vlerësimit të jashtëzakonshëm të parashikuar për promovimin e tyre.

Megjithatë, shenjat e para nga vlerësimet e jashtëzakonshme nuk kanë qenë inkurajuese; në bazë të konsultimeve me shumë gjyqtarë dhe prokurorë publikë, vlerësimet po zhvillohen kryesisht pa ndonjë vlerësim objektiv të kriterëve cilësore. Kjo ka sjellë që gjyqtarët dhe prokurorët publikë në vlerësim të marrin pikët më të larta të mundshme.

Kjo është shqetësuese, pasi sinjalizon që edhe me kritere formale sasiore dhe cilësore, vlerësuesit duken se nuk kanë një kulturë profesionalizmi.

¹⁶² Sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 102/19) dhe Ligjit për Prokurorinë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 42/20), vlerësimi i performancës si i gjyqtarëve dhe i prokurorëve bazohet në tërësinë e rezultateve nga kriteret cilësore (60 për qind të notës) dhe kriterëve sasiore (40 për qind të notës).

Projekti rekomandon që Këshilli Gjyqësor dhe Prokurori Publik i Shtetit, në koordinim të ngushtë me Këshillin e Prokurorëve Publikë, duhet të bëjnë një rishikim të vazhdueshëm të metodave të vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe të mbledhin komentet e tyre për këtë çështje. Një zgjidhje e mundshme për vetëvlerësimin objektiv të Këshillave, si e procesit dhe e metodave të vlerësimit, është kryerja e një ankete anonime të gjyqtarët dhe prokurorët

publikë për arritjet e tyre nga procedurat e vlerësimit, duke përfshirë gjithashtu vlerësuesit. Rezultatet nga kjo anketë do të lejojnë këshillat të marrin informacione më të plota dhe të dobishme, në vend që të mbështeten vetëm në kundërshtimet individuale të ngritura në proceset e vlerësimit. Duke përcaktuar dobësitë dhe mangësitë në rregullore dhe zbatimin e tyre praktik, këshillat do të arrijnë të kryejnë zgjedhje dhe promovime të bazuara në meritë.

Përdorimi i mjeteve ligjore të posaçme

12

Rekomandim

Të merren masa të menjëhershme në kuadrin ligjor ekzistues për të rritur shkallën e konfiskimeve:

- i. Prokurorët publikë duhet të urdhërojnë rregullisht hetimet financiare dhe të kërkojnë sekuestre të përkohshme të pasurive, në mënyrë që të sigurojnë konfiskimin efektiv, në të gjitha çështjet ku ka përfitim të paligjshëm pronash dhe/ose dëm financiar në Buxhetin e Shtetit.
- ii. Gjyqtarët duhet të sigurojnë që pjesa ekzekutive e vendimeve të vendosë një lidhje të përshtatshme ndërmjet masës së konfiskimit dhe vetë dënimit; në veçanti, ata duhet të japin një përshkrim të qartë dhe të detajuar të pasurive që duhet të konfiskohen.
- iii. Akademia për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë duhet të përfshijë vazhdimisht trajnime për hetimet financiare në kurrikulën e saj dhe të paraqesë rezultatet e arritura në mënyrë të matshme
- iv. Ministria e Drejtësisë, Gjykata Supreme dhe Prokuroria Publike e Shtetit duhet të koordinojnë në mënyrë proaktive ndërveprimin e institucioneve kompetente për qëllime konfiskimi.

v. Pushteti ekzekutiv duhet të:

- Lehtësojë mbledhje të rregullta ndërmjet të gjitha grupeve të interesit të përfshira në procedurat e konfiskimit, veçanërisht gjykatat, prokuroritë, Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara, Agjencia për Kadastrën e Pasurive të Paluajtshme dhe Avokati i Shtetit.
- Shpërndajë burime për punësimin e personelit të ekspertëve që do të punojnë krahas prokurorëve në hetimet financiare.
- Sigurojë mirëfunksionimin e databazës dhe sistemit elektronik të përdorur nga Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara, dhe të mbështetë përditësimet e nevojshme.
- Vlerësojë kapacitetin e Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Luftën kundër Krimin të Organizuar dhe të bëjë propozime për përmirësime të mundshme.

Që prej fillimit të Projektit, sekuestrimet e pasurive në numër të kufizuar kanë qenë veçanërisht shqetësuese, sidomos pasi trajtimi i çështjeve të korrupsionit nuk mund të konsiderohet efektiv pa konfiskimin e fitimeve të paligjshme të pronave dhe/ose dëmshpërblimin për dëmin financiar në Buxhetin e Shtetit.

Projekti vërejti një numër shumë të ulët propozimesh për konfiskim dhe pak ose aspak shenja që është kryer një hetim financiar.

Prokuroria propozoi konfiskim vetëm në shtatë kërkesa për gjykim nga 34 çështjet e monitoruara nga Projekti, në të cilat kishte pasur prona të përfituara nga veprat penale (të pretenduara).

Në pesë çështje të tjera të këtij grupi çështjesh, prokuroria e propozoi këtë masë në kërkesën për gjykim të ndryshuar dhe/ose në argumentet mbyllëse.

Harta e konfiskimeve




Figura 29 - Gjurmimi i konfiskimeve

Projekti vërejti paqartësi në përcaktimin e shumës së saktë të dëmit real (që zakonisht prekte Buxhetin e Shtetit) të shkaktuar nga autorët. Për më tepër, ka pengesa ligjore në ekzekutimin e masave të konfiskimit për të realizuar dëmshpërblimin e duhur.

Të gjitha këto më sipër tregojnë një mungesë hetimesh financiare efektive për të siguruar sekuestrimin e përkohshëm të pasurive dhe konfiskimin pasues të fitimeve të paligjshme pas vendimit të formës së prerë. Gjatë konsultimeve, u konfirmua se prokurorët nuk shfrytëzonin në mënyrën e duhur dispozitat ligjore përkatëse të KP-së dhe KPP-së. Ky problem rëndohet më tej nga mungesat e personelit të ekspertëve të aftë për të mbështetur punën e prokurorëve në këtë fazë të procesit.

Kjo gjendje ngarkon gjyqtarët me barrë më të rëndë gjatë hartimit të vendimeve dhe vendosjes së një lidhjeje të qartë

ndërmjet produkteve të veprës penale dhe akuzave penale. Në veçanti, në çështjet me shumë të pandehur, gjyqtarët përmendën vështirësi në përcaktimin e vlerës së saktë të pasurive që duhet të konfiskoheshin për shkak të përshkrimeve të dobëta të kërkesat për gjykim.

Si pasojë, hetimet financiare dhe konfiskimi duhet të mbeten një nga përparësitë kyçe në kurrikulën e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë. Disa probleme do të zgjidhen me ndryshimet e propozuara në KPP. Për shembull, parashikohet një propozim për konfiskimin si element i detyrueshëm i kërkesës për gjykim në çështjet ku është përfituar pronë në mënyrë të paligjshme. Gjithashtu, ndryshimet kërkojnë një përshkrim të detajuar të pronës së konfiskuar në vendimin e dënimit. Për më tepër, ato parashikojnë udhëzime të veçanta për sekuestrimin e

përkohshëm të pasurive për qëllimet e konfiskimit. Ndërkohë, Projekti e konsideron kuadrin ligjor përkatës të mjaftueshëm për të siguruar sekuestrimin efektiv të pasurive. Megjithatë, kjo do të kërkojë angazhim më të madh për gjurmimin e pasurive të paligjshme nga prokurorët dhe që komponentit financiar të hetimit t'i jepet rëndësia e duhur. Nga ana tjetër, një pengesë në këtë aspekt është fakti se prokurorët publikë rrallëherë i marrin të dhënat e nevojshme në kohën e duhur. Në fakt, ata shpesh detyrohen të shfrytëzojnë njohjet personale në institucionet e tjera ose kanale të tjera joformale komunikimi në vend të korrespondencës zyrtare.

Për më tepër, roli i Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë Publike të Shtetit është thelbësor në lehtësimin e ndërveprimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë në procedurën e konfiskimit. Vendosja e një modeli ndërveprimi për të gjitha grupet e interesit në sistemin gjyqësor është parashikuar si aktivitet edhe në Strategjinë e Zhvillimit të Sektorit të Drejtësisë 2024–2028 të miratuar së fundmi. Në të njëjtën kohë, ndryshimet e lartpërmendura në shkëmbimin e të dhënave mund të zgjidhen duke organizuar mbledhje mujore ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve kompetente,

veçanërisht të gjykatave, prokurorive publike, Agjencisë për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara dhe të Agjencisë për Kadastrën e Pasurive të Paluajtshme.

Një organ tjetër i dobishëm për shkëmbimin e të dhënave dhe bashkëpunimin ndërinstitutional është Qendra Kombëtare e Koordinimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar në Ministrinë e Brendshme. Duke përmirësuar kapacitetet dhe duke lehtësuar ndarjen e informacionit në kohë reale, të gjitha grupet përkatëse të interesit do të pajisen më mirë për të shpejtuar procesin e mbledhjes së të dhënave të lidhura me flukse të mundshme financiare të paligjshme. Kjo do të sigurojë që këto aktivitete të adresoheshin në mënyrë të shpejtë dhe efektive.

Për më tepër, gjurmimi i pasurive të paligjshme në mënyrë të përhershme, gjatë gjithë procedurës penale dhe pas vendimit të formës së prerë, është kritik për konfiskimin efektiv. Një databazë dhe sistem elektronik i përshtatshëm në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara që do të mund të sinjalizojë çdo ndryshim të mundshëm në pasuritë e zotëruara nga individë ose individët objekt konfiskimi do të lejojë sekuestrimin e shpejtë dhe të suksesshëm të pasurive.



A series of horizontal dotted lines spanning the width of the page, providing a guide for handwriting practice. There are 20 lines in total, evenly spaced from the top to the bottom of the page.



A series of horizontal dotted lines spanning the width of the page, providing a guide for handwriting practice. There are 20 lines in total, evenly spaced from the top to the bottom of the page.



REGIONAL TRIAL MONITORING PROJECT
COMBATting ORGANIZED CRIME AND CORRUPTION
IN THE WESTERN BALKANS



Organization for Security and
Co-operation in Europe



Funded by
the European Union